LIGJ
Nr. 132/2021

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE, MALIT TË ZI, PËRFAQËSUAR NGA ZYRA E INTEGRIMIT EVROPIAN, DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR PROGRAMIN E VEPRIMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II, MALI I ZI–SHQIPËRI, 2014–2020, ALOKIMET PËR VITIN 2020

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, Malit të Zi, përfaqësuar nga Zyra e Integrimit Evropian, dhe Komisionit Evropian për Programin e Veprimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Mali i Zi–Shqipëri, 2014–2020, alokimet për vitin 2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13404 datë 24.12.2021 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJA E FINANCIMIT
KUSHTET E VEÇANTA

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "Komisioni" ose "pala" e cila vepron në emër të Bashkimit Evropian, në vijim i referuar si "Bashkimi", nga njëra anë, dhe Mali i Zi i përfaqësuar nga Qeveria e Malit të Zi – Zyra e Integrimit Evropian dhe Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, që në vijim referohen bashkërisht si "përfituesit e IPA II" ose veçmas si "përfituesja e IPA II" ose "pala", nga ana tjetër, dhe bashkërisht të referuara si "Palët",
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Programi i Veprimit

1. Bashkimi bie dakord të financojë dhe përfituesit e IPA II bien dakord të pranojnë financimin për alokimet e vitit 2020 të Programit të Veprimit në vijim, siç përshkruhet në

shtojcën I: Programi i Veprimit të Bashkëpunimi Ndërkufitar Mali i Zi për vitet 2018–2020. (Numri i angazhimit (CRIS): 2020 / 041-471).

Ky Program Veprimi financohet nga buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor në vijim: Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)[1].

2. Kostoja totale e llogaritur për fondet e vitit 2020 për këtë Program të Veprimit është 1,800,000 euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit në këtë Program të Veprimit është 1,530,000 euro.

Nuk kërkohet kontribut financiar nga përfituesit e vendeve IPA II.

Neni 2

Periudha e ekzekutimit dhe periudha e zbatimit operacional

1. Siç përcaktohet në nenin 1(1) të shtojcës II, periudha e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 12 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Siç përcaktohet në nenin 1(2) të shtojcës II, periudha e zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje Financimi është caktuar 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

Neni 3

Adresat dhe komunikimi

I gjithë komunikimi në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi duhet të jenë në formë të shkruar, duke iu referuar shprehimisht Programit të Veprimit, siç identifikohet në nenin 1(1) dhe do të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komisionin
Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtoria D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit dhe Fqinjësinë, Komisioni Europian
15, Rue de la Loi, B – 1049 Bruksel, Belgjikë E-mail: NEAR-D1@ec.europa.eu

Për përfituesit e IPA II

Për Malin e Zi:
Z. Zorka Kordić
Krye-Negociator dhe Koordinator Kombëtar i IPA-së
Qeveria e Malit të Zi
Zyra e Integrimit Evropian
Bulevar Revolucije 15
81000, Podgoricë, Mali i Zi
E-mail: aleksandar.drlievic@,gsv.gov.me

Për Republikën e Shqipërisë::
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial
Bulevardi "Gjergj Fishta", nr. 6
Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@mfa.gov.al

[1] Rregullorja nr. 231/2014 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, që krijon një Instrument për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II), OJ L 77, 15.3.2014, f. 11.

Neni 4
Pikat e kontaktit të OLAF-it

Pika e kontaktit të përfituesit të IPA II që ka kompetencat e duhura për të bashkëpunuar drejtpërdrejt me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), në mënyrë që të lehtësojë aktivitetet operacionale të OLAF-it do të jenë:

Për Malin e Zi:
AFCOS pikë kontakti/zyra e AFCOS
Znj. Nataša Kovačević
Ministria e Financave e Malit të Zi
Stanka Dragojevića 2, 81000, Podgoricë, Mali i Zi
Natasa.kovacevic@mif.gov.me

Për Shqipërinë:
Z. Bejko Late
Drejtor i Sektorit të Inspektimit Financiar
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë, Republika e Shqipërisë
Bejko.late@financa.gov.al

Neni 5
Marrëveshjet Kuadër

Programi i Veprimit do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Malit të Zi mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit për Malin e Zi nën Instrumentin e Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 4 qershor 2015 dhe në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi marrëveshjet për zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit në Shqipëri nën Instrumentin e asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II), e cila ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015 (e referuar në vijim si "Marrëveshja/et kuadër").

Kjo Marrëveshje Financimi plotëson dispozitat e Marrëveshjeve Kuadër të lartpërmendura. Në rast konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Financimi dhe nga ana tjetër, dispozitave të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 6
Shtojcat

1. Kjo Marrëveshje Financimi përbëhet nga:
a) këto Kushte të Veçanta;
b) Shtojca I: Programi i Veprimit CBC Mali i Zi – Republika e Shqipërisë për vitet 2018–2020;
c) Shtojca IA: Programi IPA II BNK 2014–2020 ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë;
d) Shtojca II: Kushtet e përgjithshme;
e) Shtojca III: Model i Raportit Vjetor BNK për zbatimin e asistencës IPA II, në përputhje me nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër;
f) Shtojca IIIA: Modeli i Raportit Vjetor për zbatimin e asistencës IPA II, në përputhje me nenin 58 dhe 59(1) të Marrëveshjes Kuadër;
g) Shtojca IV: Modeli i Raportit Financiar, sipas nenit 59(2) të Marrëveshjes Kuadër;
h) Shtojca V: Specifikimet minimale të sistemit të kontabilitetit me bazë akruale.
2. Në rast të një konflikti, nga njëra anë e dispozitave të shtojcave dhe nga ana tjetër e dispozitave të këtyre kushteve të veçanta, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast të një

konflikti, nga njëra anë, të dispozitave të shtojcës I dhe shtojcës IA dhe e dispozitave të shtojcës II, nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi. Në rast konflikti ndërmjet dispozitave të shtojcës I, nga njëra anë, dhe dispozitave të shtojcës IA, nga ana tjetër, këto të fundit do të kenë përparësi.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Financimi hyn në fuqi në datën kur Komisioni merr njoftim nga vendi i fundit përfitues i IPA II, i cili konfirmon përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi. Komisioni duhet të informojë përfituesit IPA II për datën e marrjes së këtij njoftimi. Nëse Komisioni nuk merr njoftim deri më 31 dhjetor 2020, Marrëveshja e Financimit nuk hyn në fuqi.

Kjo Marrëveshje është hartuar në tri kopje origjinale në gjuhën angleze, nga të cilat një do t'i dorëzohet Komisionit dhe dy të tjerat përfituesve IPA II.

Për përfituesin IPA II:

Për Malin e Zi:
Z. Zorka Kordić
Krye-Negociator
dhe Koordinatori Kombëtar i IPA-së
Qeveria e Malit të Zi
Zyra e Integrimit Evropian

Podgoricë, data 26 korrik 2021

Për Shqipërinë:
Z. Zef Mazi

Koordinatori Kombëtar i IPA-së
Tiranë, datë 2.12.2021

Për Komisionin:

Znj. Genoveva Ruiz Calavera
Drejtore D, Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Zgjerimit dhe Fqinjësinë
Komisioni Evropian

Bruksel, data 22 qershor 2020

SHTOJCA I
PROGRAMI SHUMËVJEÇAR I PUNËS
KY DOKUMENT PËRBËN PROGRAMIN SHUMËVJEÇAR TË PUNËS NË KUPTIMIN E NENIT 110 (2) TË RREGULLORES (BE, EURATOM) 2018/1046

1. IDENTIFIKIMI

Përfituesit	Mali i Zi, Republika e Shqipërisë
Referencat e angazhimit të CRIS/ ABAC Kontributi i Unionit Linja e buxhetit	2018/ 041-468 euro 1,700,000 22.020401 2019/ 041-470 euro 1,700,000 22.020401 2020/ 041-175 euro 1,530,000 22.020401
Mënyra e menaxhimit **Strukturat përgjegjëse**	Menaxhimi i tërthortë nga Mali i Zi Struktura operuese përgjegjëse për zbatimin e projekteve është: Zyra e Integrimit Evropian Autoriteti Kontraktues është Drejtoria për Financimin dhe Kontraktimin e Ndihmës së BE-së (CFCU) në Ministrinë e Financave Struktura Operuese partnere në Republikën e Shqipërisë është: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Data përfundimtare për miratimin e Marrëveshjes/ve	Për angazhimin buxhetor të vitit 2018, maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2019 Për angazhimin buxhetor të vitit 2019,

Financiare me vendet përfituese të IPA II (trepalëshe)	maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2020 Për angazhimin buxhetor të vitit 2020, maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2021
Data përfundimtare për mbylljen e kontratave të granteve, duke përfshirë përfundimin e marrëveshjeve të kontributit/delegimit	3 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit, me përjashtim të rasteve të renditura në nenin 189(2) të Rregullores Financiare
Data përfundimtare për zbatimin e projekteve	6 vjet pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes së Financimit (datë në të cilën ky program duhet të jetë mbyllur dhe të jetë përfunduar angazhimi i fondeve) pas pranimit të shpenzimeve	12 vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Financimit

2. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË VEPRIMIT

2.1 PËRMBLEDHJA E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR 2014–2020

Programi i BNK-së (Bashkëpunimi Ndërkufitar) Mali i Zi – Republika e Shqipërisë 2014–2020 është miratuar me vendimin zbatues të Komisionit C(2014) 9352 të datës 10 dhjetor 2014.[2] Programi i miratuar 2014–2020 përbën strategjinë e bashkëpunimit të BNK për rajonin kufitar, duke përcaktuar ndër të tjera edhe listën e zonave gjeografike të pranueshme, kontekstin e zonës, prioritetet tematike të programit dhe alokimet buxhetore indikative për periudhën 7-vjeçare.

Programi BNK Mal i Zi – Republika e Shqipërisë 2014–2020 shërben, gjithashtu, si referencë për miratimin e programeve të veprimit BNK. Programi i veprimit BNK 2018–2020 synon sigurimin e asistencës për bashkëpunim ndërkufitar në fushat tematike, të parashikuar në programin 2014–2020 (siç tregohet në seksionin 2.2).

Më 6 shkurt 2018, Komisioni Evropian miratoi Komunikatën me temë "Një perspektivë e besueshme e zgjerimit për angazhim të zgjeruar të BE-së me Ballkanin Perëndimor"[3]. Kjo komunikatë synon të avancojë më tej reformën në Ballkanin Perëndimor dhe të sigurojë një angazhim të dukshëm për zgjerimin e BE-së për të mbështetur më mirë përgatitjet e tyre në rrugën evropiane. Komunikata përcakton orientimet e reja strategjike, veçanërisht, në lidhje me zbatimin e gjashtë iniciativave kryesore.

Në veçanti, bashkëpunimi ndërkufitar është një mjet kyç për nxitjen e pajtimit dhe trajtimin e trashëgimisë së të kaluarës në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me iniciativën kyçe 6 (mbështetje për pajtimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë) dhe për zhvillimin e qëndrueshëm lokal, në përputhje me iniciativën kyçe 3 (mbështetje e zhvillimit socio-ekonomik).

Lista e zonave gjeografike të pranueshme

Në Malin e Zi zonat e lejueshme janë: Andrijevica, Berane, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë, Podgoricë, Cetinje, Danilovgrad, Budva, Bar dhe Ulqin. Në Republikën e Shqipërisë zonat e lejueshme janë: Shkodra, Lezha dhe Bashkia e Tropojës.

Bashkëpunimi ndërkufitar (BNK) në kontekstin e zonës përfituese

Zona e Programit është e ndryshme, por ka disa karakteristika të përbashkëta të lidhura për shembull me natyrën, pozitën gjeografike, tendencat demografike, ekonominë dhe kapitalin njerëzor që mund të gjenerojnë sinergji dhe të jenë një mundësi e mirë për zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave të BNK-së.

[2] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/albania/ipa/2015/2014_-_2020_ipa_cbc_montenegro_albania_action.pdf

[3] https://ec.europa.eu/commission/sites/beta-political/files/communication-credible-enlargement-perspective-ëestern-balkans_en.pdf

Gjithashtu, Programi duhet të ndërtohet mbi karakteristikat dhe veprimet e sakta, të përcaktuara në kuadër të Strategjisë së BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) COM (2014) 357, në të cilën marrin pjesë të dyja vendet përfituese.

Analiza e situatës së bërë për përgatitjen e programit tregoi disa sfida dhe mundësi kryesore për t'u trajtuar dhe mbështetur përmes bashkëpunimit ndërkufitar.

-Karakteristika ekonomike të të dyja vendeve tregojnë tendenca të ngjashme: të dyja vendet janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mesatare-të larta nga Banka Botërore. Struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dyja anët e kufirit.

-Konkurrueshmëria është e ulët në të dyja anët e kufirit. Produktivitet më i lartë, investime të mëtejshme në njohuritë teknike dhe përdorimi i teknologjive të inovacionit dhe digjitale janë një parakusht për t'u bërë më konkurruese në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

-Forcimi i rrjeteve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe lidhjeve të shërbimit (përfshirë digjitalizimin dhe zgjerimin e aksesit), që ekziston në zonat kufitare, është një potencial që përdoret pak. Mbi 97% e NVM të regjistruara kanë më pak se katër persona të punësuar. Niveli i bashkëpunimit ndërkufitar është minimal.

-Të dyja anët e zonës së programit po bëhen gjithnjë e më tërheqëse për investitorët e huaj, por kushtet nga të dyja anët duhet të përmirësohen dhe, veçanërisht, ato të infrastrukturës për të bërë biznes.

-Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në zonën e programit, por e nënvlerësuar. Papunësia mbetet një problem madhor për popullatën e zonës së programit, veçanërisht për grupet sensitive sociale, siç janë të rinjtë, popullsia rurale, si dhe gratë.

-Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshme të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit, e cila mbështetet kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve janë vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

-Infrastruktura e dobët është një sfidë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës së programit. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës publike mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe rritjen e përgjithshme të mirëqenies në zonën e programit.

-Zona e programit ka potencial të lartë turistik. Megjithatë, këto mundësi turistike shfrytëzohen kryesisht në anën malazeze, ndërsa turizmi në anën shqiptare ka zhvillim të dobët, pavarësisht potencialit të madh. Gjithashtu, trashëgimia e pasur historike-kulturore-artistike në zonën kufitare duhet të ruhet.

-Përmirësimi i cilësisë së sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një sfidë dhe prioritet për zonën e programit, veçanërisht në zonat rurale.

-Sektori i shëndetësisë është i dobët dhe i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Gjithashtu, mungesa e një kuadri të duhur ligjor në anën shqiptare të kufirit për sigurim shëndetësor në zonat rurale është ende pengesë në zhvillimin e saj.

-Ekziston nevoja për inkurajimin e *rrjeteve rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC).*

-Hulumtimi, zhvillimi dhe depërtimi i Teknologjisë Informative dhe Komunikacionit (TIK) është në disproporcion të lartë midis vendeve dhe, në veçanti, në nivel lokal në zonën e programit.

-Qeveritë lokale dhe rajonale janë përgjithësisht të dobëta financiarisht dhe nuk mund ta nxisin zhvillimin lokal.

Përmbledhje e përvojave të kaluara dhe atyre në vazhdim të BNK-së, duke përfshirë mësimet e nxjerra

Në zhvillimin e këtij programi janë marrë parasysh rekomandimet kryesore nga vlerësimet e përkohshme dhe auditimet e programeve të BNK-së në periudhën 2007–2013. Kështu, programet e BNK 2014–2020 janë më të fokusuara për sa i përket numrit të prioriteteve tematike të trajtuara dhe shtrirjes gjeografike, e cila do të ndihmojë për të arritur rezultate më të mira dhe ndikim më të lartë. Përveç kësaj, zbatimi i programeve të BNK-së është thjeshtuar kryesisht duke pasur një autoritet të vetëm kontraktues dhe një paketë të vetme financiare për programin.

Mësimet kryesore u identifikuan edhe nga vlerësimi përfundimtar i Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA) Programet BNK 2007–2013, që u realizua midis viteve 2016 dhe 2017. Mësimet e nxjerra dhe rekomandimet u diskutuan me palët e interesuara të BNK-së në Ballkanin Perëndimor dhe masat për ndjekje u identifikuan për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, si për programet BNK 2014–2020 në vijim, ashtu edhe për programet e ardhshme BNK 2021–2027. Rekomandimet kryesore, në lidhje me të gjitha programet BNK në nivelin e Ballkanit Perëndimor, përfshijnë:

- Objektivi kryesor për të promovuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë duhet të reflektohet qartë në projektet e BNK-së.
- Thirrjet për propozime duhet të përqendrohen më shumë në pak çështje prioritare, që kanë interes të lartë ndërkufitar.
- Logjika e veprimit të programeve dhe sistemet e raportimit dhe monitorimit duhet të përmirësohen, pasi nuk janë të strukturuara për të vendosur një bazë të qartë për matjen e rezultateve në nivelin rajonal.
- Ekziston nevoja për të vazhduar me aktivitetet për rritjen e kapaciteteve për strukturat operuese dhe sekretariatet e përbashkëta teknike/antenat.
- Ekziston nevoja për përmirësimin e sinergjive me politika dhe donatorë të tjerë, kapitalizimin dhe shkëmbimin e përvojave me instrumentet e tjera të BNK-së (si p.sh. INTERREG (Programi i Bashkëpunimit Ndërrajonal) dhe Programet BNK nën Instrumentin Evropian të Fqinjësisë (ENI).

Për sa i përket këtij programi, bashkëpunimi i ngushtë midis dy vendeve përfituese gjatë secilit hap të zbatimit të programit ka qenë thelbësor dhe do të duhet të sigurohet edhe në periudhën 2018-2020.

Duke ndjekur përvojën e fituar në periudhën prej vitit 2007 deri 2013, Komiteti i Përbashkët i Monitorimit (KPM) u kthye në organin vendimmarrës të programit ndërkufitar, për të mbikëqyrur efektivitetin dhe cilësinë e zbatimit të programit. Roli i KPM-së i referohet programimit të përgjithshëm dhe monitorimit të programit të BNK-së, ndërsa përzgjedhja e projekteve do të jetë nën përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues.

Përvoja e viteve të mëparshme ka treguar që nga njëra anë numri i aplikantëve të interesuar është në rritje të vazhdueshme, duke arritur kështu një larmi të gjerë të palëve të interesuara si edhe njësive të vogla - dhe nga ana tjetër që pjesëmarrësit ende kërkojnë mbështetje intensive për ndërtimin e kapaciteteve, në mënyrë që aplikantët e mundshëm të ardhshëm të mund të përfshijnë më mirë elemente të praktikës më të mirë dhe veçori të tjera në veprimet e tyre. Më tej, programet e mëparshme promovuan krijimin e partneriteteve ndërkufitare, bashkëpunimi afatgjatë i të cilave duhet të inkurajohet me qëllim nxitjen e zhvillimit lokal. Projektet e bashkëpunimit ndërkufitar kanë treguar se janë një instrument i fuqishëm për proceset e zhvillimit lokal, duke bashkuar njerëzit dhe institucionet, duke trajtuar nevoja tepër konkrete dhe lokale të zhvillimit.

Strukturat përgjegjëse në nivel kombëtar për zbatimin e këtij programi bashkëpunimi ndërkufitar nën modalitetin e menaxhimit të tërthortë kanë fituar përvojë gjatë ekzekutimit të katër viteve të para të periudhës aktuale financiare nga viti 2014 deri në 2020. Pritet që ky proces të vijojë me rritjen e eficiencës në menaxhimin e thirrjeve përkatëse për projektpropozime dhe kontratave të granteve nën menaxhim të tërthortët. Gjithashtu, kjo mënyrë e tërthortë e menaxhimit nën drejtimin e Malit të Zi dhe në partneritet të ngushtë me Republikën e Shqipërisë krijon një stimul të fuqishëm për forcimin e bashkëpunimit dhe besimit rajonal.

2.2 PËRSHKRIMI DHE ZBATIMI I PROJEKTEVE

Veprimi 1	Projektet e Bashkëpunimit Ndërkufitar	4,930,000 euro

Ndihma e parashikuar për Malin e Zi dhe Republikën e Shqipërisë do të ndjekë kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga masat kufizuese të miratuara në bazë të nenit 215 TFEU[4].

1. Përshkrimi i veprimit, objektivi, rezultatet e pritshme

Përshkrimi i veprimit: Projektet e Bashkëpunimit Ndërkufitar në rajonin kufitar, në fushën e punësimit, lëvizshmërisë për punë dhe përfshirjes sociale e kulturore, mjedisit, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe zbutjes, parandalimit të rrezikut dhe menaxhimit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Objektivi: Zhvillimi socio-ekonomik dhe forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë në zonën ndërkufitare përmes zbatimit të projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar që synojnë:

a) promovimin e punësimit, lëvizjen e fuqisë punëtore dhe përfshirjen sociale dhe kulturore përtej kufijve, midis të tjerash: integrimin e tregjeve ndërkufitare të punës, duke përfshirë edhe lëvizshmërinë ndërkufitare; iniciativa të përbashkëta të punësimit lokal; informacion dhe shërbime këshilluese dhe trajnime të përbashkëta (duke përfshirë projekte që trajtojnë mungesën e literaturës digjitale); barazinë gjinore; mundësi të barabarta; integrimin e komuniteteve të emigrantëve dhe grupeve të cenueshme; investimin në shërbimin e punësimit publik dhe mbështetjen e investimeve në shëndetin publik dhe shërbimet sociale;

b) mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen, parandalimin dhe menaxhimin e riskut përmes, ndër të tjera: veprimeve të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit; promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, eficiencën e burimeve, përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe ndryshim drejt një ekonomie me karbon të ulët, të qëndrueshme dhe të sigurt; promovimin e investimeve për rreziqet specifike, duke siguruar aftësinë e përballimit të katastrofave dhe zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të fatkeqësive dhe gatishmërisë për emergjenca;

c) inkurajimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore, ndër të tjera përmes: mbështetjes për shkëmbimet sociale dhe kulturore; promovimi i turizmit të qëndrueshëm dhe valorizimi i trashëgimisë kulturore të zonës, duke përfshirë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, krijimin e rrjeteve dhe partneriteteve ndërmjet pushtetit vendor dhe palëve të interesuara lokale për të promovuar faqet e përbashkëta turistike; ruajtjen e trashëgimisë kulturore; rritjen e shkëmbimeve kulturore, vlerave historike dhe diversitetit kulturor.

Kur është e mundur, veprimet që lidhen me objektivat e lartpërmendur, siç janë zhvilluar në Planin e Veprimit të strategjisë makrorajonale të Adriatikut dhe Jonit, ku marrin pjesë të dyja vendet, duhet të merren parasysh.

Rezultatet e pritshme:

a) cilësia e shërbimeve dhe produkteve të turizmit është përmirësuar;

b) bashkëpunimi në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore është rritur;

c) ndërgjegjësimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve mjedisore në liqen dhe zonat alpine ka avancuar;

d) qasja në tregun e punës është përmirësuar, veçanërisht për grupet e cenueshme.

Objektivat dhe rezultatet e pritshme do të arrihen gjatë periudhës së zbatimit të këtij programi, nga viti 2014 deri në vitin 2020. Programi i Veprimit BNK 2018–2020 do të kontribuojë në arritjen e objektivave të përgjithshëm dhe rezultatet e pritshme të përcaktuara në programin BNK 2014–2020. Për detaje të mëtejshme shihni seksionin 3.2 të programit BNK 2014-2020 (aneksi 2 i vendimit zbatues të Komisionit C (2014) 9352 të datës 10 dhjetor 2014).[5]

2. Supozimet dhe kushtet

Si kusht i nevojshëm për menaxhimin efektiv të programit, vendet pjesëmarrëse do të ngrenë një Komitet të Përbashkët Monitorues dhe do të sigurojnë zyrat dhe stafin e duhur për

[4] https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/8442/consolidated-list-sanctions_en

[5] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/albania/ipa/2015/2014_-_2020_ipa_cbc_montenegro_albania_action.pdf

Sekretariatin e Përbashkët Teknik (që do të ngrihet me një vendim të veçantë financimi) dhe antenën në funksion, në rast se kjo e fundit do të ngrihet.

Nën menaxhimin e tërthortë, vendet pjesëmarrëse duhet të nënshkruajnë një marrëveshje dypalëshe për të gjithë kohëzgjatjen e programit, e cila përcakton përgjegjësitë e tyre përkatëse për zbatimin e programit. Kjo marrëveshje bilaterale lidhet midis dy vendeve pjesëmarrëse dhe mbetet e vlefshme për të gjithë kohen e zbatimit të programit.

Deri më tani, përfituesit janë pajtuar me supozimet dhe kushtet e mësipërme, duke përfshirë krijimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik në Podgoricë dhe Zyrën e Antenës në Shkodër. Këto struktura financohen plotësisht nga Masa Mbështetëse për Asistencë Teknike për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet përfituesve të IPA II, në kuadër të Instrumentit për Asistencë e Paraaderimit (IPA II) për vitin 2014 C(2014)37629[6].

Mbështetja e mëtejshme financiare do të programohet nga Komisioni Evropian për vazhdimin e ofrimit të mbështetjes për Sekretariatin e Përbashkët Teknik dhe Zyrën e Antenës nga viti 2020 e në vazhdim.

Mosrespektimi i kërkesave të lartpërmendura mund të çojë në kthimin mbrapsht të fondeve, në kuadër të këtij programi dhe/ose rialokimin e fondeve të ardhshme.

3. Modalitetet e zbatimit

3. a) Menaxhimi i tërthortë me Malin e Zi

Përshkrimi i shkurtër i detyrave të besuara

Strukturat operuese të Malit të Zi dhe Republikës së Shqipërisë kanë përgatitur bashkërisht programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014–2020 dhe kanë rënë dakord mbi masat e nevojshme për menaxhimin dhe zbatimin e programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi për monitorimin e zbatimit.

Struktura operuese e Malit të Zi duhet të organizojë procedurat e prokurimit dhe të dhënies së grantit për prioritetet tematike të përzgjedhura të programit. Për sa u përket thirrjeve për propozime, detyrat e besuara përfshijnë hartimin e udhëzimeve për aplikantët, shpalljen e thirrjeve, përzgjedhjen e përfituesve të granteve dhe nënshkrimin e kontratave të granteve. Detyrat e besuara përfshijnë edhe aktivitete të lidhura me menaxhimin financiar dhe zbatimin e programit, si monitorimi, vlerësimi, pagesat, kthimi i fondeve, verifikimi i shpenzimeve, duke siguruar auditim të brendshëm, raportim të parregullsive dhe krijimin e masave të duhura kundër mashtrimit.

Elementet thelbësore të veprimit

Granti – Thirrja për projektpropozim/e: 4,930,000 euro

a) Kriteret thelbësore të pranueshmërisë:

Lista e aktiviteteve të pranueshme është përcaktuar në nenin 3.2, të shtojës 2, të vendimit zbatues të komisionit C(2014) 9352, datë 10 dhjetor 2014. Lista e mëposhtme është një përmbledhje që tregon aktivitetet/projektet kryesore të pranueshme:

inkurajimi i sipërmarrjes dhe i konkurrueshmërisë në sektorin e turizmit; iniciativa për trajnime të përbashkëta profesionale, që kanë synim aftësitë të lidhura me një ofertë turistike konkurruese dhe nevojat e tregut; aktivitetet për të promovuar potencialin kulturor dhe natyror turistik të zonës së programit; aktivitete të përbashkëta për të nxitur, por edhe përtërirë vlerat kulturore dhe trashëgiminë natyrore përmes festivaleve, panaireve, konkurseve; projekte të konceptuara për të parandaluar dhe menaxhuar fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet mjedisore të shkaktuara nga njeriu, të cilat ndikojnë në zonën e programit; projekte që synojnë krijimin e mundësive të punësimit dhe aftësive për grupet e disavantazhuara të shoqërisë; partneriteti pushtet vendor – OSHC në përfshirjen sociale.

Gjithashtu, në kontekstin e zbatimit të programit, përparësi mund t'u jepet projekteve që lidhen me Strategjinë Makrorajonale të BE-së për Adriatikun dhe Jonin COM (2014) 357, ku marrin pjesë të dyja vendet.

[6] http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/3/2014/EN/3-2014-9421-EN-F1-1-ANNEX-1.PDF

Përfituesit duhet të jenë persona juridikë dhe të vendosur në një vend përfitues të IPA II që merr pjesë në programin BNK.

Përfitues potencialë mund të jenë autoritetet vendore, institucionet e qeverisjes vendore, shoqatat e bashkive, agjencitë e zhvillimit, organizatat mbështetëse të biznesit lokal, faktorët ekonomikë, si NVM-të, organizatat turistike dhe kulturore, OJQ-të, dhe organet publike dhe private në mbështetje të fuqisë punëtore, institucionet e formimit profesional dhe teknik, organet dhe organizatat për mbrojtjen e natyrës, organet publike përgjegjëse për menaxhimin e ujit, shërbimet e emergjencës/zjarrit, shkollat, kolegjet, universitetet dhe qendrat kërkimore, duke përfshirë edhe institucionet e trajnimit profesional dhe teknik.

Institucione të tjera mund të shtohen nëse janë në përputhje me programin:

b) Kriteret kyçe të përzgjedhjes janë kapaciteti financiar dhe operacional i aplikuesit;

c) Kriteret thelbësore të dhënies së grantit janë rëndësia, efektiviteti, fizibilitetit, qëndrueshmëria dhe kosto-efektiviteti i projektit;

d) Shkalla maksimale e bashkëfinancimit të BE-së në kuadër të thirrjeve është 85% e kostos së pranueshme të projektit;

e) Shuma indikative e thirrjes/ve: 4.930.000 euro.

Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të shpallin më shumë se një thirrje për projektpropozime. Çdo thirrje për projektpropozime do të ketë të njëjtët objektiva, rezultate dhe kushte thelbësore të pranueshmërisë, përzgjedhjes dhe akordimit, siç përshkruhet më sipër. Çdo kontratë granti do të financohet nga një angazhim buxhetor. Strukturat përgjegjëse mund të vendosin të bashkojnë alokimet e viteve 2018, 2019 dhe 2020 me alokimet pasuese.

f) Data indikative për shpalljen e thirrjes/ve për projektpropozime:

Q2 2020 për angazhimin buxhetor të viteve 2018, 2019 dhe 2020 të shpallet në një thirrje për projektpropozime.

3. BUXHETI

2018				2019				2020				
	Kontributi i Unionit*	**Bashkëfinancimi i përfituesit/ve të Granteve****	**Totali i shpenzimeve**		**Kontributi i Unionit**	**Bashkëfinancimi i përfituesit/ve të granteve**	**Totali i shpenzimeve**		**Kontributi i Unionit**	**Bashkëfinancimi i përfituesit/ve të granteve**	**Totali i shpenzimeve**	**Vendimi i përgjithshëm i financimit**
Projektet BNK	1,700,000	300,000	2,000,000	Projektet BNK	1,700,000	300,000	2,000,000	Projektet BNK	1,530,000	270,000	1,800,000	4,930,000
në %	85	15	100		85	15	100		85	15	100	
TOTALI 2018	**1,700,000**	**300,000**	**2,000,000**	**TOTALI 2019**	**1,700,000**	**300,000**	**2,000,000**	**TOTALI 2020**	**1,530,000**	**270,000**	**1,800,000**	**4,930,000**

Kontributi i Unionit është llogaritur në raport me shpenzimet e pranueshme, që janë bazuar në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkëfinancimit të Unionit në nivel të çdo prioriteti tematik nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

** Bashkëfinancimi i prioriteteve tematike do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një nivel minimal prej 15% të kostos totale të pranueshme të projektit.

4. MARRËVESHJET E MONITORIMIT TË PERFORMANCËS

Si pjesë e kuadrit të matjes së performancës së tij, Komisioni do të monitorojë dhe do të vlerësojë progresin drejt arritjes së objektivave specifikë të përcaktuar në Rregulloren e IPA II, në bazë të treguesve të paracaktuar qartë, të matshëm dhe transparentë. Raportet e progresit të përmendura në nenin 4 të rregullores së IPA II do të merren si pikë referimi në vlerësimin e rezultateve të asistencës IPA II.

Komisioni do të mbledhë të dhënat të performancës (treguesit e procesit, treguesit e rezultate dhe produkteve) nga të gjitha burimet, të cilat do të mblidhen dhe analizohen në aspektin e ndjekjes së progresit kundrejt objektivave dhe synimeve të përcaktuar për secilin nga veprimet e këtij programi, si dhe dokumenteve strategjike indikative.

Koordinatorët kombëtarë të IPA-së do të mbledhin informacion mbi perfomancën e projekteve dhe programit (treguesit e procesit, treguesit e rezultate dhe produkteve) dhe do të koordinojnë mbledhjen dhe paraqitjen e treguesve që vijnë nga burimet kombëtare.

Progresi i përgjithshëm do të monitorohet nëpërmjet mënyrave të mëposhtme: a) Sistemi i monitorimit të orientuar drejt rezultateve (ROM); b) Vetëmonitorimi i përfituesit të IPA II; c) Vetëmonitorimi i kryer nga delegacionet e BE-së; d) Monitorimi i përbashkët nga Drejtoria e Përgjithshme për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit (DG-NEAR) dhe përfituesit e IPA II, ku përputhshmëria, koherenca, efektiviteti, efikasiteti dhe koordinimi për zbatimin e asistencës financiare do të monitorohet rregullisht nga një Komiteti i Monitorimit të IPA II, i mbështetur nga Komiteti Përbashkët i Monitorimit, i cili do të sigurojë një proces monitorimi në nivel programi.

Progresi i përgjithshëm do të jetë objekt i vlerësimit, i cili do të kryhet pas zbatimit të aktiviteteve.

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARAANËTARËSIMIT 2014–2020
PROGRAMI IPA BNK
MAL I ZI–SHQIPËRI

TABELA E PËRMBAJTJES

INSTRUMENTI I NDIHMËS SË PARAANËTARËSIMIT
2014–2020
Përmbledhje
Seksioni 1: Përmbledhje e Programit
1.1 Përmbledhje e Programit
1.2 Përgatitja e Programit dhe përfshirja e partnerëve
Seksioni 2: Zona e Programit
2.1 Analiza e situatës
Gjeografia
Demografia
Varfëria
Ekonomia
Sektori privat
Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
Turizmi
Infrastruktura
Sociale
Tregu i punës
Arsimi
Shëndetësia
Kultura

Shoqëria civile
Mjedisi dhe natyra
2.2 Gjetjet kryesore
Seksioni 3: Strategjia e Programit
3.1 Arsyetim – Arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes
3.2 Përshkrimi i prioriteteve të programit
3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura
Seksioni 4: Plani financiar
Seksioni 5: Dispozitat zbatuese
1. HYRJE
2. ANALIZA PESTLE
2.1 Reformat politike dhe procesi i integrimit në BE
Konteksti ekonomik i vendit
2.2 KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË ZONËS SË PROGRAMIT
2.2.1 Sektori privat
2.2.2 Tregu i punës
2.2.3 Bujqësia dhe zhvillimi rural
2.2.4 Turizmi
2.3 SOCIALE
2.3.1 Demografia
Dendësia
Minoritetet
Varfëria
2.3.2 Arsimi
2.3.3 Shëndetësia
2.3.4 Kultura
2.3.5 Shoqëria civile
2.4 INFRASTRUKTURA
2.5 MJEDISI
2.6 MARRËVESHJET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE
3.7. KONKLUZIONE
4. ANALIZA SWOT

Përmbledhje

Titulli i programit	**Programi BNK Mal i Zi – Shqipëri 2014–2020**

Zona e programit	Mal i Zi: Andrijevica, Beranë, Petnjica, Plavë, Gucia, Rozhajë, Podgoricë, Cetinjë, Danilovgrad, Budva, Tivar dhe Ulqin Shqipëri: Rajoni i Shkodrës Rajoni i Lezhës * Rrethi i Tropojës
Objektivi i përgjithshëm i programit	Të promovojë/forcojë marrëdhënie të mira fqinjësore dhe zhvillimin social-ekonomik të rajoneve kufitare, nëpërmjet vlerësimit të potencialeve të tyre turistike, zhvillimit ekonomik ekologjikisht të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, me respektin për trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe natyrore.
Prioritetet tematike të programit	PT1: Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore; PT2: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut; PT3: Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit; PT4: Asistenca teknike.
Objektivat specifikë të Programit	Konkurrenca e sektorit të turizmit rritet nga vlerësimi ekonomik i trashëgimisë kulturore dhe natyrore Avancimi i mbrojtjes së burimeve mjedisore tek liqeni dhe zonat alpine Nxitja e punësimit dhe përfshirjes sociale Garantimi i zbatimi efektiv, efikas, transparent dhe në kohë i programit, si dhe rritja e ndërgjegjësimit
Alokimi financiar 2014–2020	11,900,000.00 euro

Metoda e zbatimit	Menaxhim indirekt (në bazë të besimit te detyrat e zbatimit të buxhetit)
Autoriteti Kontraktues	**Mal i Zi**: Ministria e Financave Njësia Qendrore e Financave dhe Kontraktimit (CFCU) Jola Piletica bb, 81 000 Podgoricë Tel: + 382 (0) 20 230 630 Faks: + 382 (0) 20 230 657

Autoritetet përkatëse nga pjesëmarrësit, përfitues të IPA II [strukturat operative]	**Mal i Zi**: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integrimit Europian Stanka Dragojevića 2 81000 Podgoricë Tel: (+382 20) 224 439 Faks:(+382 20) - 224 449 **Shqipëri:** Ministria e Integrimit Evropian Rr. "Papa Gjon Pali II", Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 22 286 45 Faks: + 355 4 22 562 67
SPT/Antena	SPT do të jetë e vendosur në Podgoricë, Mali i Zi. Antena do të jetë e vendosur në Shkodër, Shqipëri.

* Kudo që është përmendur termi "Qarku i Tropojës" në tekst, ai i referohet ndarjes territoriale të mëparshme në Shqipëri, e cila përfshin Bashkinë Bajram Curri, Komunën Margegaj, Komunën Tropojë, Komunën Bujan, Komunën Bytyç, Komunën Fierzë, Komunën Lekbibaj, dhe Komunën Lugajë.

Seksioni 1: Përmbledhje e Programit

Programi për bashkëpunim ndërkufitar mes Malit të Zi (MZ) dhe Shqipërisë (AL) do të zbatohet në kuadrin e Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA II). IPA II mbështet bashkëpunimin ndërkufitar, me qëllim promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, nxitjen e integrimit në Bashkimin Evropian dhe promovimin e zhvillimit social ekonomik. Dispozitat ligjore për zbatimin e tij janë të përcaktuara në pjesët e mëposhtme të legjislacionit:

- Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2014, për themelimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II);

- Rregullorja (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014, që përcakton rregullat dhe procedurat e përbashkëta për zbatimin e instrumenteve te Bashkimit Evropian për financimin e veprimit të jashtëm;

- Rregullorja Zbatuese e Komisionit të BE-së nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014, mbi rregullat specifike për zbatimin e rregullores IPA II.

1.1 Përmbledhje e Programit

Programi mbulon një territor prej 11,970 km^2 me një popullsi prej rreth 749.257 banorë. Territori në Mal të Zi që përbën 52.1% të sipërfaqes së programit, mbulon 12 komuna të shtrira në tri rajone gjeografike. Pjesa shqiptare është e përbërë nga tri njësi administrative, rajonet e Lezhës dhe Shkodrës dhe rrethi i Tropojës, duke zënë 47.9% të sipërfaqes së programit. Gjatësia e vijës kufitare është 244 km, nga të cilat 38 km janë kufi ujor. Gjithsej, zona e programit ka 23 komuna dhe një total prej 1,144 vendbanimeve - qytete dhe fshatra. Zona e programit karakterizohet nga një profil i ndryshëm gjeografik dhe klimatik. Ajo paraqet kontraste të mprehta, pasi në të alternohen malet, kodrat, lumenjtë, liqenet dhe bregu i detit shumë afër me njëri-tjetrin. Zona e programit ka disa parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe peizazhe që pasqyrojnë biodiversitetin e pasur dhe dallimet mjedisore. Popullsia që jeton në zonën e programit llogaritet të përbëjë rreth 61% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, dhe 13.5% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Popullsia në zonën e programit është e balancuar, e përbërë nga popullsi e Malit të Zi rreth 50.63%, dhe popullsi shqiptare me rreth 49.37%. Përbërja e popullsisë në zonën e programit tregon se 50% e popullsisë i takon segmentit moshor 15–49 vjeç.

Gjetjet kryesore

Gjetjet kryesore të analizës, të pasqyruara në përgatitjen e dokumentit, janë përmbledhur më poshtë:

Zona e programit **përmban pabarazi rajonale** në aspektin e zhvillimeve social-ekonomike dhe struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërkohë që rajonet shqiptare mbështeten në bujqësi, shërbime, tregje me shumicë dhe pakicë, rajonet malazeze

shfaqin një industri më të zhvilluar, si dhe niveli i turizmit është shumë më i zhvilluar. Të dyja rajonet janë nën potencialin e tyre të zhvillimit, pasi ata ende duhet të gjejnë mënyra dhe mundësi për të përfituar nga avantazhet e tyre krahasuese.

Konkurrenca e biznesit është e ulët në të dyja anët e kufirit. Struktura e operatorëve ekonomikë në zonën e programit është e dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Produktiviteti më i lartë dhe investimet e mëtejshme në ekspertizën dhe përdorimin e teknologjive të inovacionit, janë një parakusht për t'u bërë më konkurrues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) në të dyja anët operojnë në sektorin e shërbimeve. Forcimi i mekanizmave mbështetës të biznesit mbetet një sfidë.

Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në të dyja vendet, por vazhdon të jetë e pashfrytëzuar, me **produktivitet dhe konkurrencë të ulët**. Në përgjithësi, ekonomia rurale është e fragmentuar, në një shkallë më të lartë në zonën shqiptare të programit. Por, pronarët e vegjël bujqësorë përballen me vështirësinë për të hyrë në tregjet e vendit dhe ato rajonale. Përmirësimi i aksesit në treg dhe forcimi i sistemit ushqimor dhe organeve përkatës të inspektimit do të jenë të rëndësishëm për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë.

Turizmi është një potencial i madh për të dyja vendet, por është i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Mali i Zi është tashmë një destinacion turistik i admiruar, ndërsa Shqipëria ka ende punë për t'u bërë i tillë, pasi sektori i turizmit në pjesën shqiptare të zonës së programit është zhvilluar pak, pavarësisht potencialit të madh që ekziston. Sinergji të dukshme, me mundësi që të mbështeten nga bashkëpunimi ndërkufitar (programi BNK), mund të ndërtohen midis rajoneve në Shqipëri dhe zonave bregdetare në Mal të Zi. Ekziston një **trashëgimi e pasur historike-kulturore** në zonën kufitare, e cila duhet të ruhet. Vleftësimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe kulturore mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës, por edhe si një pasuri për zhvillimin ekonomik të saj.

Papunësia është relativisht e lartë si në Mal të Zi ashtu edhe Shqipëri, dhe vazhdon të jetë një problem i madh ekonomik. Papunësia mbetet një problem i mprehtë, veçanërisht për grupet e ndjeshme sociale, siç janë të rinjtë, gratë dhe popullsia rurale. Varfëria është bërë një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërkohë që ripërtëritja e potencialit urban tashmë të përdorur është bërë e domosdoshme për të udhëhequr rritjen ekonomike. Niveli i pabarabartë **arsimor** është i pranishëm në zonën e programit, me një rritje të analfabetizmit në zonat e thella. Të rinjtë me arsim të lartë kanë tendencë për t'u larguar drejt rajoneve që ofrojnë më shumë mundësi apo jashtë vendit. Sistemi i arsimit të mesëm është më pak tërheqës dhe i aksesueshëm, veçanërisht për popullsinë e re në zonat rurale të programit. Depërtimi i **kërkimit shkencor dhe zhvillimit** dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është në një nivel të ulët në Shqipëri, ndërsa në Mal të Zi ndjek trendin e rritjes së vazhdueshme dhe aktualisht është në nivel të mjaftueshëm. Në zonën e programit investimet janë të pamjaftueshme, si dhe mungojnë aktiviteteve mbështetëse në nivel qeveritar, rajonal ose lokal për kërkimin shkencor dhe zhvillimin. Në përgjithësi, shërbimet **shëndetësore** në zonën e programit janë duke u përmirësuar, por duhet të bëhet akoma më shumë për të siguruar akses universal në shërbime të tilla edhe nga familjet e varfra.

Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshme të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit që mbështetet kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja dhe ruajtja mjedisore e tyre është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, i kontrollit të ndotjes, dhe përmirësimi i menaxhimit të tokave janë ndër prioritetet kryesore për t'u adresuar. Vleftësimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës.

Fushat kryesore të ndërhyrjeve

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi ndërkufitar është të promovojë/forcojë marrëdhënie të mira fqinjësore dhe zhvillimin social-ekonomik të rajoneve kufitare, nëpërmjet

vlerësimit të potencialeve të tyre turistike, zhvillimit ekonomik ekologjikisht të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, me respektin për trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe natyrore.

Bazuar në analizën e situatës, analizën e faktorëve politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, ligjorë, dhe mjedisorë (PESTLE), dhe analizën e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve (SWOT), prioritetet e mëposhtme tematike dhe objektivat specifikë janë cilësuar si të rëndësishëm për t'u mbështetur nëpërmjet iniciativave të bashkëpunimit ndërkufitar (BNK):

1. Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore:

Konkurrenca e sektorit të turizmit rritet nga vlerësimi ekonomik i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

2. Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe e lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut:

Mbrojtja e burimeve mjedisore te liqeni dhe zonat alpine, çohet më tej.

3. Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit:

Punësimi dhe përfshirja sociale nxitet

Përveç tri prioriteteve tematike të përmendura më lart, programet do të përfshijnë një prioritet specifik, asistencë teknike, i cili ndër të tjera, synon sigurimin e menaxhimit dhe administrimit efektiv të programit ndërkufitar.

1.2 Përgatitja e programit dhe përfshirja e partnerëve

Programi IPA BNK 2014–2020 midis Malit të Zi dhe Shqipërisë është rezultat i një pune të përbashkët programuese, e realizuar nga përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse, duke përfshirë palët e interesuara nga institucionet qendrore, institucionet e nivelit lokal të zonës së programit, Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë , sipërmarrësit, dhe organizatat lokale. Një task forcë e përbashkët është krijuar për të përgatitur dhe zbatuar dokumentin e programit nën udhëheqjen e Strukturave Operative (SO). Kështu, programi menaxhohet nga Strukturat Operative – për Malin e Zi në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Integrimit Evropian, dhe për Shqipërinë, në Ministrinë e Integrimit Evropian.

Procesi i programimit ka filluar në fillim të muajit korrik të vitit 2013 dhe vazhdoi deri në fund të muajit maj 2014. Programi është hartuar nëpërmjet një procesi konsultimi, duke përfshirë palët e interesuara lokale dhe përfituesit potencialë nga të dyja anët e kufirit. Pyetësorë janë hartuar nga CBIB+ dhe shpërndarë nga SO me mbështetjen e SPT, tek institucionet në nivel qendror dhe lokal dhe Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), për të mbështetur analizat PESTLE dhe SWOT për programin dhe për të siguruar një nga treguesit për identifikimin e prioriteteve të përbashkëta për zonën ndërkufitare. Nga 140 pyetësorë të dërguar (70 në Shqipëri dhe 70 në Mal të Zi), 91 u kthyen të plotësuar. Shkalla e përgjithshme e përgjigjeve në anketë ishte rreth 65%. Gjithashtu, janë zhvilluar edhe intervista – 34 në Shqipëri dhe 9 në Mal të Zi. Drafti i parë i Dokumentit të Programit u dorëzua te Komisioni më datë 15 nëntor 2013.

Gjatë muajit dhjetor 2013, janë mbajtur dy takime prezantuese me përfaqësuesit e pushtetit vendor, në kuadër të procesit të konsultimit publik nga pala shqiptare, në Shkodër dhe Lezhë, me 15 pjesëmarrës. Nga ana tjetër, konsultimet publike janë mbajtur në tetor 2013, në Bijelo Polje me rreth 15 pjesëmarrës të pranishëm.

Gjatë periudhës mars–prill 2014, një proces i dytë konsultimi publik me një rreth më të gjerë u organizua nga OS shqiptar në koordinim me Projektin e Ndërtimit të Institucioneve Ndërkufitare (CBIB +) për të prezantuar tek organizatat e shoqërisë civile, universitetet, aktivistët qytetarë, draftdokumentin e dytë të programit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi në rajonet e pranueshme nga Shqipëria. Aktorët e shoqërisë civile dhe përfaqësues të pushtetit vendor mbështetën fuqimisht prioritetet tematike të përzgjedhura për këtë program dhe, gjithashtu, dhanë detaje për sa i përket nevojave që lidhen me rajonet e tyre përkatëse, të cilat janë pasqyruar në mënyrën e duhur në dokumentin e programit.

Përveç kësaj, për të koordinuar procesin në nivel kombëtar, një takim konsultativ u organizua edhe me përfaqësues nga ministritë e linjës në Shqipëri, mbi prioritetet tematike dhe aktivitetet e propozuara në program.

Tabela në vijim përmbledh procesin e përgatitjes së këtij programi.

Tabela 1. Takimet dhe konsultimet

Koha dhe vendi	Aktivitetet dhe qëllimi
20–21 qershor 2013, Becici, Budva, në Mal të Zi	Takim programues për 2014-20 për Ballkanin Perëndimor
9 korrik 2013, Podgoricë	Hapat e programimit dhe kërkesat për analizat SWOT dhe PESTLE me SO të Malit të Zi
Gusht – mes shtatori 2013	Shpërndarja e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave
16 shtator 2013, Tiranë	Takimi i parë me ekipin dhe koordinimin e CBIB+ për përgatitjen e Programit IPA BNK 2014–2020.
25 shtator 2013, Podgoricë	Trajnim i CBIB+ mbi zhvillimin dhe formulimin e Strategjisë (SO, DEU, SPT/A)
27 shtator 2013, Tiranë	Trajnim i CBIB+ mbi zhvillimin dhe formulimin e Strategjisë (SO, DEU, SPT/A)
2 tetor 2013, Podgoricë	Takim me strukturën operative të Malit të Zi - Koordinimi për realizimin e programit IPA BNK 2014–2020, marrëveshja për kalendarin e programit
8 tetor 2013, Podgoricë	Takim me autoritetet e ndryshme të Malit të Zi (ministritë e linjës) – diskutim mbi gjendjen dhe perspektivat zhvillimore strategjike
14 tetor 2013, Tiranë	Takim me strukturën operative të Shqipërisë - Koordinimi për realizimin e programit IPA BNK 2014–2020, marrëveshja për kalendarin e programit, diskutim mbi gjendjen dhe perspektivat zhvillimore strategjike
17 shtator–24 tetor 2013, Tiranë, Podgoricë	Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, përgatitja e PESTLE, finalizimi i Analizës së Situatës dhe Analizës SWOT
25 tetor 2013, Tiranë	Takimi i Task Forcës së Parë të Përbashkët, prezantimi i Analizës së Situatës dhe Analizës SWOT
30 tetor 2013, Bijelo Polje, Mal i Zi	Takim konsultativ publik me më shumë se 15 pjesëmarrës nga zona e programit
15 nëntor 2013	Dorëzimi i draftit të parë të Dokumentit të Programit te DG ELARG.
21–22 nëntor 2013 , Beograd, Serbi	Forumi Rajonal Konsultativ BNK
12 dhjetor 2013 , Tiranë, Shqipëri	Takim teknik i procesit të programimit midis SO, Komisionit, Delegacionit të BE dhe CBIB +; U bë diskutimi mbi strategjitë programore për tri programet. U dhanë disa sugjerime nga KE-ja, në lidhje me formulimin e objektivave, indikatorëve dhe zonave përfituese
19 dhjetor 2013, Konsultimi Publik Paraprak, Lezhë, Shkodër, Shqipëri	U prezantua dokumenti i programit, si dhe procesi i programimit dhe arsyetimi për zgjedhjen e strategjisë së ndërhyrjes, me 15 përfaqësues nga qeverisja lokale. Strategjia e ndërhyrjes dhe prioritetet tematike të përzgjedhura rezultuan të jenë në përputhje me pikëpamjen e tyre ndaj nevojave të BNK
Janar 2014	Rishikimi i Dokumentit të Programit bazuar në rekomandimet e Komisionit

7 shkurt 2014	Dorëzimi tek Komisioni i draftit të dytë të dokumentit të programit.
27 mars 2014, rajoni lezhë, AL Takim konsultues me publikun e gjerë, shoqërinë civile dhe aktorët lokalë, me 27 pjesëmarrës	Procesi i programimit së bashku me prioritetet e programit u prezantuan tek 27 organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të qeverisjes vendore në qarkun e Lezhës, duke u ndjekur nga diskutime aktive me rekomandime dhe sugjerime nga pjesëmarrësit. Prioritetet rezultuan të jenë në përputhje me pikëpamjen e tyre ndaj nevojave të BNK.
28 mars 2014, rajoni Shkodër, AL, Takim konsultues me publikun e gjerë, shoqërinë civile dhe aktorët lokal	Procesi i programimit së bashku me prioritetet e programit u prezantuan te më shumë se 32 organizata të shoqërisë civile dhe përfaqësues të qeverisjes vendore në qarkun e Shkodrës, duke u ndjekur nga diskutime aktive me rekomandime dhe sugjerime nga pjesëmarrësit. Prioritetet rezultuan të jenë në përputhje me pikëpamjen e tyre ndaj nevojave të BNK.
30 mars 2014	Komisioni komenton mbi draftin e dytë të dokumentit
16 prill 2014, Tiranë, AL, Takim konsultues me ministritë e linjës	Procesi i programimit dhe prioritetet e programit për të 3 kufijtë, AL- KSV, MZ-AL, MK-AL u prezantuan në ministritë e linjës që mbulojnë prioritetet dhe aktivitetet në dokumente. Qëllimi ishte konsultimi me programet aktuale kombëtare në fushat përkatëse të veprimit dhe shmangia e mbivendosjeve, përfshirë sinergjitë e mundshme. Draftdokumentet rezultuan të jenë në përputhje edhe me strategjitë kombëtare dhe u konceptuan nga pjesëmarrësit si shumë të rëndësishme për zhvillimin e rajoneve
17 prill–1 maj 2014	Reflektimi mbi komentet e marra nga Komisioni dhe nga takimet e konsultimeve publike
30 maj 2014	Dorëzimi i versionin përfundimtar të dokumentit të Programit te Komisioni

Seksioni 2: Zona e Programit[1]

2.1 Analiza e situatës

Zona e programit për Programin Ndërkufitar midis Malit të Zi dhe Shqipërisë mbulon një territor prej 11,970 km^2 me një popullsi prej rreth 749.257 banorë. Territori në Mal të Zi përbën 52.1% kundrejt 47.9% në Shqipëri. Vija kufitare është 244 km, nga të cilat 38 km janë kufij ujor. Ka tri pika funksionale të kalimit kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi përgjatë kësaj vije kufitare. Zona e Programi në Mal të Zi mbulon komunat: Andrijevica, Berane, Plavë, Guci[2], Petnjica[3] dhe Rozaje; Podgorica, kryeqyteti i Malit të Zi dhe Cetinjë, Danilovgrad, Budva, Tivar dhe Ulqin. Zona e Programit në Shqipëri përfshin rajonet e Shkodrës dhe të Lezhës, dhe rrethin e Tropojës[4]. Në përgjithësi, zona e programit përfshin 23 komuna dhe një total prej 1,144 vendbanimeve – qytete dhe fshatra.

[1] Ky seksion jep një përmbledhje të të dhënave kryesore nga analiza e situatës, analiza SWOT dhe PESTLE. Versioni i plotë i analizës është shtojcë në dokumentin e programit.

[2] Gucia është një bashki e re, e paraqitur si një ndarje administrative e Komunës së Plavës; ajo është në fazat e hershme të organizimit.

[3] Petnjica është një bashki e re, e paraqitur si një ndarje administrative e Komunës së Beranes; ajo është në fazat e hershme të organizimit; Edhe Gucia është një komunë e themeluar rishtazi.

[4] Rrethi i Tropojës ka 1 bashki, atë të Bajram Currit, dhe 7 komuna - Bujan, Bytyç, Fierzë, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj dhe Tropoja



Gjeografia

Zona e programit përmban disa parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe peizazhe që pasqyrojnë biodiversitet të pasur dhe dallimet mjedisore. Territori në Mal të Zi është i karakterizuar nga një profil gjeografik dhe klimatik i ndryshëm, i mbushur me vargje malore, fusha, lugina, lumenj, laguna dhe liqene. Pjesa kontinentale ose veriore e rajonit është një zonë malore. Majat malore arrijnë deri në 2.500 m lartësi, dhe territori përshkohet nga lumenj, si lumi Lim, Morava dhe Tara, duke formuar kanione dhe lugina mbresëlënëse. Territori në Shqipëri paraqet kontraste të mprehta, pasi alternon male, kodra, lumenj, liqene dhe bregdet, shumë afër me njëri-tjetrin. Në këtë zonë ka lumenj të shumtë që kalojnë nëpër territor, të cilët shpesh shkaktojnë përmbytje gjatë stinëve me reshje. Zona shtrihet nga malet e larta (Alpet Shqiptare) në pjesën veriore të saj në kufi me Malin e Zi, deri në bregdet (Velipojë dhe Shëngjin), në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë. Maja më e lartë është Jezerca me 2,694 m lartësi, në rajonin e Shkodrës, dhe ajo më e ulëta (-6 m) ndodhet në rajonin e Lezhës. Zona e Programit ka klimë mesdhetare në zonën e saj bregdetare, me verë dhe vjeshtë të nxehtë dhe të thatë, dhe klimë kontinentale në zonën veriore malore të Shkodrës dhe Tropojës, me dimër relativisht të ftohtë dhe me reshje dëbore të rënda në brendësi. Elemente të tilla gjeografike me kontrast të lartë pasurojë mjedisin, florën dhe faunën e zonës së programit. Burimet e saj natyrore janë stimuluese për zhvillimin e turizmit dhe agrobiznesit, si stimujt kryesorë ekonomikë për të rritur mundësitë për mirëqenien dhe prosperitetin e banorëve në zonën e programit.

Demografia

Popullsia që jeton në zonën e programit llogaritet të përbëjë rreth 61% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, dhe 13.2% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Popullsia në zonën e programit është e balancuar, e përbërë nga popullsi e Malit të Zi prej rreth 379,366 banorësh, duke zënë 50.63% të popullsisë totale në zonën e programit, dhe popullsi shqiptare prej rreth 369,891 banorësh, duke zënë 49.37% të popullsisë totale në zonë. Në pjesën malazeze dendësia e popullsisë me 65.7 banorë/km^2 është më e lartë se mesatarja kombëtare prej 45 banorë/km^2, ndërsa në Shqipëri është 59 banorë/km^2, më e ulët në krahasim me mesataren kombëtare prej 97 banorë/km^2. Zona e programit ka një normë natyrore rritje prej 1.87%, që është nën mesataren kombëtare prej 2.2%; Shkalla e vdekshmërisë qëndron në 9.4% e barabartë me mesataren kombëtare. Zona e programit në Mal të Zi ka një popullsi kryesisht urbane, duke

zënë rreth 52% të popullsisë së saj, e cila është më e ulët, në krahasim me 62% që jetojnë në zonat urbane në nivel kombëtar. Rreth 49% e popullsisë në zonën e programit është e përqendruar në Podgoricë. Në Shqipëri numri i përgjithshëm i popullsisë që jeton në zonën e programit është 369,891[1] banorë, ose rreth 13.2% e popullsisë së përgjithshme të vendit. Rajoni i Shkodrës është rajoni i gjashtë më i madh i vendit me një popullsi prej 215,347 banorësh, ose rreth 7.6% e popullsisë së përgjithshme, e ndjekur nga Lezha e cila renditet e dhjeta mes rajoneve të vendit, që numëron një total prej 134,027 banorësh apo 4.7% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Rrethi i Tropojës regjistron një popullsi totale prej 20,517 banorësh, e cila përbën 0.07% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Popullsia është kryesisht rurale, me një mesatare prej 53.2%. Këtë mesatare e përcakton rajoni i Shkodrës, pasi popullsia rurale është 55.6% e 119,794 banorëve të tij. Në të kundërt, rajoni i Lezhës ka një dominim të popullsisë urbane, me rreth 53.8% të popullsisë. Rrethi i Tropojës ka një popullsi kryesisht rurale, e cila përbën rreth 74% të popullsisë së tij. Përbërja e popullsisë në zonën e programimit të të dyja vendeve tregon se 50% e popullsisë i takon segmentit moshor 15–49 vjeç.

Varfëria

Vulnerabiliteti i popullsisë së **Malit të Zi** është rritur kohët e fundit, pasi numri i personave nën vijën e varfërisë ka pësuar një rritje nga 6.6% e popullsisë, deri në rreth 9.3% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, në vitin 2011. Rritja e shkallës së varfërisë është shumë më e theksuar në zonat rurale, mesatarisht 18.4%, ndryshe nga zonat urbane ku arrinte mesatarisht 4.4% në vitin 2011. Pabarazia është rritur në Mal të Zi, pasi koeficienti Gini u rrit nga 24.3% në vitin 2010, në 25.9% në vitin 2011[2]. Vulnerabiliteti i popullsisë së **Shqipërisë** u rrit në vitin 2012; numri i regjistruar i personave nën vijën e varfërisë u rrit me 8.4%. Varfëria ekstreme ka arritur në 2.2% në vitin 2012, kundrejt 1.2% të regjistruar në vitin 2008. Rajonet në zonën e programit janë më të varfër në krahasim me mesataren kombëtare të shkallës së varfërisë prej 14.3%. Qarku i Lezhës regjistron një normë varfërie 17.5%, ndërsa qarku i Shkodrës është pak më mirë, me një normë varfërie 15.7%. Rrethi i Tropojës i përket rajonit më të varfër të Shqipërisë, Kukësit, me një normë varfërie 21.8%. Varfëria është bërë një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërsa ripërtëritja e potencialit urban tashmë të ezauruar, është bërë e domosdoshme për të sjellë rritjen ekonomike.

Ekonomia

Zona e programit përmban të gjitha pabarazitë rajonale të hasura në **Mal të Zi**, në aspektin e zhvillimeve social-ekonomike. Ashtu si në nivel kombëtar, ajo është e dominuar nga Podgorica, e cila është motori ekonomik i vendit. Çdo bashki e zonës së programit është nën mesataren kombëtare, me Bashkinë e Plavës në krye, e cila është më pak e zhvilluara në vend. Ndryshe nga Budva, e cila ka indeksin më të lartë të zhvillimit në Mal të Zi me 362.4, dy bashkitë e tjera bregdetare të zonës së programit Tivari dhe Ulqini, janë nën mesataren kombëtare.

Edhe në **Shqipëri**, pabarazitë rajonale janë shumë të dukshme. Zhvillimi social-ekonomik i vendit anon rëndë në favor të rajonit qendror. Shkodra është rajoni më i zhvilluar në zonën e programit të Shqipërisë. Kontributi i Qarkut të Shkodrës në GDP arriti në 555 milionë euro në vitin 2011[3], e barabartë me 6.1% të GDP totale të shtetit, duke u radhitur e shtata ndër 12 qarqet e Shqipërisë. Kontribuuesi kryesor në aktivitetin ekonomik të rajonit është bujqësia, e cila përbën rreth 26% të kontributit të GDP- së, e pasuar nga tregtia, hotelet, transporti dhe komunikacioni me 23%, sektori financiar dhe ai i pasurive të patundshme me 19%, industria me 11%, dhe ndërtimi me 8%. GDP e rajonit të Lezhës për vitin 2011 arrin 3.7% të GDP-së së vendit[4]. Kontribuuesit kryesorë në GDP-në e rajonit të Lezhës janë tregtia, hotelet, transporti dhe komunikacioni me 26%, sektori i bujqësisë me 25%, sektorët financiarë dhe të pasurive të patundshme me 19%, ndërtimi me 10%, ndërkohë që industria është kontribuuesi më i vogël me

[1] INSTAT Census 2011.
2 Banka Botërore, fotografim i programit të Shtetit.
3 INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013.
[4] INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013.


8%. Kontributi i rajonit të Kukësit në GDP-në e Shqipërisë, ku Tropoja përbën rreth 24% të popullsisë, është më i ulëti në vend, me vetëm 2.4%; sektorët më të rëndësishëm janë bujqësia, e cila është përgjegjëse për 34%, dhe tregtia, hotelet dhe turizmi me 20%.

Sektori privat

Struktura e operatorëve ekonomikë në zonën e programimit është e dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). NVM-të në Mal të Zi përbëjnë 98.6% të numrit të përgjithshëm të operatorëve ekonomikë, ndërsa në Shqipëri ato përbëjnë 95.4% të totalit. Shumica e NVM-ve në të dyja anët e kufirit operojnë në sektorin e shërbimeve. Shumica e operatorëve ekonomik të **Malit të Zi** janë të përqendruar në zonën e programit, duke përbërë 67.3% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në nivel kombëtar. Rreth 49.2% e këtyre NVM-ve janë të vendosura në Podgoricë, duke treguar kështu pabarazitë e zhvillimit rajonal.

Grafiku 1. NVM-të sipas sektorëve kryesorë ekonomikë në zonën e programit

Mal i Zi Shqipëri



Në **Shqipëri,** zona e programit regjistron një total prej 10,174 ndërmarrjesh[1] në fund të vitit 2012, ose rreth 9.7% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të vendit. Ajo ka një shkallë lindje[2] prej 13%, më e lartë në krahasim me mesataren kombëtare prej 12.2%, ndikuar kryesisht nga Shkodra, e cila me 14.4% tregon një zhvillim relativisht më të lartë të aktivitetit ekonomik, në të kundërt me rajonin e Lezhës dhe rrethin e Tropojës me 10.8%. Struktura e ndërmarrjeve është e dominuar nga ndërmarrjet shumë të vogla, me 1–4 persona të punësuar, të cilat përbëjnë 85.7% të totalit të ndërmarrjeve në fushën e programit. Përveç madhësisë së vogël të ndërmarrjeve, një faktor i rëndësishëm, i cili është një pengesë për zhvillimin ekonomik në zonën e programit në të dyja anët e kufirit, është mungesa e njohurive teknologjike dhe aftësive të punës. Kjo mbetet një sfidë kryesore, pasi kërkesave të tregut për shërbime dhe produkte të cilësisë së lartë, nuk mund t'iu përgjigjen aftësitë joadekuate të punës. Një tjetër sfidë kryesore është aksesi i ulët i NVM-ve në financim; politikat tepër të kujdesshme të kreditimit të miratuara nga institucionet financiare në të dyja vendet, janë një pengesë serioze në rritjen e ndërmarrjeve në fushën e programit.

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

Pjesa Malazeze e zonës së programit është më e pasur në burime bujqësore dhe ka më shumë potencial në këtë sektor në krahasim me pjesën e Shqipërisë. Megjithatë, sektori i bujqësisë dhe zhvillimi i tij është po aq i rëndësishëm për të gjithë zonën e programit, veçanërisht për shkak të pjesës së madhe të popullsisë që jeton në zonën rurale, ku bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik. Një tipar i përbashkët në zonën e programit është produktiviteti dhe konkurrenca e

[1] INSTAT, Regjistri Statistikor i Biznesit të Ndërmarrjeve 2012.

[2] Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara për një vit të caktuar e shprehur në % mbi numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve.

ulët në fushën e bujqësisë. Ai vjen si pasojë e: fermave të vogla të cilat kanë prodhim dhe fitim të kufizuar; prodhimit kryesisht për të mbuluar nevojat e jetesës, sesa për shitje direkte në tregjet e gjelbra; nivelit të ulët të finalizimit të produkteve bujqësore dhe industrisë ushqimore të pazhvilluar.

Zona e programit mbulon rreth 38% të totalit të tokës bujqësore të **Malit të Zi.** Punësimi në bujqësi është raportuar të jetë rreth 2.5% e totalit të të punësuarve[1], Podgorica është rajoni kryesor fushor në Mal të Zi - vetëm ajo zë rreth 31.5% të tokës bujqësore në zonën e programit. Ajo ofron kushte optimale për prodhim të larmishëm: perime, prodhimin e drithërave, blegtori, fruta dhe verë. Vera, e cila është produkti kryesor Malazez i orientuar drejt eksportit, prodhohet në Podgoricë - rreth 80% e prodhimit të përgjithshëm të verës në vend.

Zona e programit në **Shqipëri** mbulon rreth 13.3% të totalit të tokës bujqësore të vendit[2]. Shumica e territorit të saj është e dominuar nga pyjet, kullotat (85.2%), ndërsa pjesa e tokës në shfrytëzim për qëllime bujqësore është vetëm 14.8% ose 92,748 ha. Terreni është kryesisht malor dhe i thyer, i cili kufizon në mënyrë të konsiderueshme zonat ku potenciali bujqësor mund të mbajë disa domethënie krahasuese. Zona të tilla janë të vendosura kryesisht në rrethinat e liqenit të Shkodrës, ku terreni dhe kushtet klimatike janë të favorshme për bujqësinë e perimeve. Qarku i Lezhës ka një traditë për blegtorinë e derrave, pasi ajo ka 91.7% të inventarit total të shtetit, ndërsa bujqësia në rrethin e Tropojës është e orientuar kryesisht drejt prodhimit të thekrës. Bujqësia në zonën e programit është një aktivitet familjar, i orientuar drejt nevojave për jetesë, me toka shumë të fragmentuara - madhësia e fermës është 1.1 ha në Shkodër; 0.89 ha në Lezhë, dhe 0.60 ha në Tropojë, madhësi të cilat janë sa gjysma e mesatares Shqiptare, prej 1.20 ha.

Turizmi

Rëndësia e turizmit është e ndryshme për ekonomitë e Malit të Zi dhe Shqipërisë. Mali i Zi është tashmë një destinacion i popullarizuar turistik, ndërsa Shqipëria ka ende shumë për të bërë, për t'u bërë një destinacion i tillë. Në **Mal të Zi**, turizmi është një sektor kryesor i ekonomisë, i cili përbën rreth 9.9% të GDP-së së vendit në vitin 2012, ose rreth 336 milionë euro, që është 20.7% më i lartë se në vitin 2011[3]. Rajoni bregdetar në zonën e programit përbën më shumë se 69% të totalit të qëndrimeve me fjetje në vend në vitin 2012[4], kryesisht në periudhën e pushimeve Korrik-Gusht. Bregdeti i zonës së programit tërhoqi rreth 67.5% të totalit prej 1,44 milionë turistë që hynë në Malin e Zi në vitin 2012. 160 objekte akomoduese bregdetare që gjenden në zonën e programit përbëjnë rreth 49% të totalit të mjediseve akomoduese në Mal të Zi, ndërsa në zonën e programit ndodhen edhe rreth 30% e objekteve akomoduese të zonave jobregdetare të vendit. Pavarësisht nivelit aktual të ulët të vizitave turistike, rajoni kontinental ka përparësi të shumta për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit të lidhura me sportet malore (ski, ecje, çiklizëm, rafting etj.), duke përmendur natyrën e paprekur dhe biodiversitetin e pasur (dy parqe kombëtare, liqene, kanione etj.), jetën autentike rurale, dhe prodhimin tradicional dhe cilësor të ushqimit.

Sektori i turizmit është më pak i rëndësishëm në pjesën shqiptare të zonës së programit (edhe pse ai ka një potencial të madh), në krahasim me anën malazeze. Specifikisht, rajonet e Shkodrës dhe Lezhës dhe rrethi i Tropojës kanë potencial të lartë individual për zhvillimin e një turizmi përgjatë gjithë vitit. Natyra atraktive dhe panoramat e natyrës malore dhe kodrinore, si dhe liqeni i Shkodrës, lugina e Valbonës në Tropojë dhe parqet e tjera kombëtare, dhe zonat e mbrojtura; vizitat turistike (peizazhet natyrore, speciet e rralla etj.); agroturizmi, vendet me interes historik dhe kulturor, të tilla si vendet parahistorike të banuara, qendrat arkeologjike, objektet e kultit, duhet të promovohen më mirë për një zhvillim më të shpejtë të turizmit në bregdetin e Shkodrës (Velipojë), dhe kryesisht në Lezhë (Shëngjin).

Infrastruktura

---

[1] Industria dhe okupacioni i popullsisë në Malin e Zi – Census i vitit 2011, publikimi 197 i MONSTAT.
[2] Libri statistikor, Ministria e Bujqësisë.
[3] Këshilli i Udhëtimeve nëpër Botë dhe Turizmit – mars 2013.
[4] MONSTAT – Mbërritjet turistike dhe qëndrimet me fjetje sipas qyteteve 2012.

Mali i Zi dhe Shqipëria janë pjesë e SEETO[1] – Rrjeti kryesor. Pozicioni i zonës së programit thekson rëndësinë e një infrastrukture të mirë transporti në zhvillimin e ardhshëm të turizmit, tregtisë, shkëmbimeve kulturore dhe në rritjen e konkurrencës. **Infrastruktura rrugore** që lidh Malin e Zi dhe Shqipërinë, në veçanti përmes akseve Sukobine - Muriqan dhe Bozaj -Hani i Hotit është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Edhe infrastruktura e shërbimeve nga këto pika të kalimit kufitar është përmirësuar, duke lejuar komunikimin më të shpejtë midis dy zonave, duke lehtësuar kështu transportin, tregtinë dhe turizmin. Pika e tretë kufitare në Gjercan - Plavë është më pak e zhvilluar. Një pikë e katërt e kalimit kufitar në Cijevna Zatrijebačka - Triesh, do të krijohet pas përfundimit të ndërtimit të rreth 23 km rrugë brenda territorit shqiptar, e cila është në ndërtim e sipër me financim të BERZH. Ajo do të shkurtojë ndjeshëm kohën e udhëtimit nga Plava në Podgoricë (koha e udhëtimit e pritur nëpër territorin shqiptar do të jetë rreth gjysmë ore). Mali i Zi dhe Shqipëria kanë rënë dakord për të integruar procedurat e organizimit të transportit hekurudhor midis dy vendeve. Një hekurudhë kalon përmes zonës së programit nga Podgorica në Shkodër, me një gjatësi prej rreth 63.5 km; ajo është përdorur vetëm për transportin e mallrave, pasi linja nuk është e elektrizuar. E njëjta hekurudhë lidh Tiranën me Shkodrën, nëpërmjet Lezhës. Planet e ardhshme përfshijnë elektrifikimin e saj, të paktën në anën e Malit të Zi, si dhe përdorimin e kësaj hekurudhe edhe për transportin e udhëtarëve, duke miratuar komunën urbane të Tuz-it, një nënndarje të Komunës së Podgoricës, si stacion të përbashkët kufitar.

Telekomunikacioni në zonën e programit përfiton si nga telefonia fikse, ashtu edhe nga ajo celulare. Telefonia fikse në Mal të Zi është plotësisht e digjitalizuar. Numri i abonentëve korrespondon me një normë prej 27,55%. Tregu i telefonisë celulare ka tre operatorë telekomunikacioni. Në vitin 2012, tri kompanitë celulare raportuan një total prej 990,868 përdoruesish, që korrespondon me një normë prej 159%. Në Shqipëri, niveli i depërtimit të telefonisë fikse dhe celulare në zonën e programit qëndron në 88.15%[2], pak nën mesataren kombëtare prej 89.47%. Megjithatë, me përjashtim të qyteteve kryesore, depërtimi i telefonisë fikse në zonat rurale është i ulët; komunikimi është i bazuar kryesisht në telefonat celularë. Niveli i depërtimit të telefonisë celulare në Shqipëri është mbi 130%.

Njohuritë kompjuterike në Mal të Zi[17] i përkasin mesatarisht 35% të popullsisë nga 15 vjeç e lart. Rreth 16% e popullsisë ka njohuri të pjesshme mbi kompjuterin. Në Shqipëri, niveli i përdorimit të internetit (që do të thotë se ka një kompjuter që përdoret për të hyrë në internet) në familjet në zonën e programit qëndron në 9.97%, i cili është nën mesataren kombëtare prej 12.35%.

Energjia është e disponueshme për të gjitha komunat në zonën e programit. Shumica e nevojave energjetike në të dyja anët janë plotësuar nëpërmjet importeve. Përfundimi i linjës ndërlidhëse 400 kV midis Shqipërisë dhe Malit të Zi (Elbasan-Podgoricë), rrit kapacitetet e shkëmbimeve të energjisë midis dy vendeve, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend. Edhe pse ka burime të mëdha, por ende të pashfrytëzuara hidrocentrale (veçanërisht në Shqipëri), zona karakterizohet nga një efikasitet i ulët në përdorimin e energjisë elektrike. Përdorimi i energjisë për qëllime ngrohje është i përhapur në shkallë të gjerë.

Shumica e familjeve (247,354) në Mal të Zi përdorin **ujin** nga sistemi publik i ujit, edhe pse sistemi publik i ujit mund të jetë i pamjaftueshëm në zonat rurale dhe gjatë kohës së verës. Nga numri i përgjithshëm i banesave[3], 92% prej tyre kanë akses në sistemet e furnizimit me ujë brenda shtëpive të tyre, dhe po i njëjti numër banesash është i lidhur me sistemin e kanalizimit brenda shtëpisë. Në zonën e programit në Shqipëri, furnizimi me ujë dhe sistemet e kanalizimit dhe ujitjes mbeten problematike. Aksesi në ujë brenda banesave në zonën e programit është i siguruar për rreth 55% të tyre; rreth 40% e banesave kanë pjesërisht akses në sistemet e

[1] Observatori i Transportit Jug-Lindor. Korridoret e rrugëve & Lidhjet që përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjën, Kroacinë, Kosovën, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë, Malin e Zi.
[2] Shqipëri, Census 2011.
[3] MONSTAT. Banesat, lidhur me pajisjen me instalime, Publikimi nr. 280.

furnizimit me ujë, ndërsa 4.6% e familjeve në zonën e programit nuk kanë akses në sistemin e ujësjellësit.

Sociale

Tregu i punës

Si në Mal të Zi ashtu edhe në Shqipëri, papunësia është relativisht e lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Ajo është ende një problem i madh ekonomik në të dyja anët e zonës së programit, dhe karakterizohet nga dallime të mëdha rajonale. Në **Mal të Zi** tregu i punës ka pësuar krizë, duke regjistruar një rritje të papunësisë që arriti në 20.45% në vitin 2011[1], duke u ulur në 19.6% në vitin 2012. Zona e programit ka rreth 93.4% të forcës aktive të punës të vendit; rajoni bregdetar dhe rajoni qendror janë më mirë se rajonet më të varfra dhe më pak të zhvilluara pa dalje në det në zonën veriore. Shumica e fuqisë punëtore është e punësuar në sektorin e shërbimeve (76.2%), pasuar nga industria me 18.1%, dhe bujqësia me 5.6% të totalit të punësuar. Punëdhënësi më i madh në program është sektori i tregtisë me 20.5%, i ndjekur nga administrata publike me 12.5%. Femrat përbëjnë 44.1% të totalit të të punësuarve.

Fuqia e përgjithshme punëtore në **Shqipëri** arrin në 1,117,082 persona në fund të muajit dhjetor 2012[2]. Ajo nuk ka pasur ndryshime të mëdha, pavarësisht nga ngadalësimi ekonomik gjatë 2-3 viteve të fundit. Shkalla e përgjithshme e papunësisë[3] ka ngelur në 13.9%, njëlloj si në vitin 2011. Në ndryshim nga Tropoja, papunësia në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës pasqyron të njëjtën normë mesatare të papunësisë si në nivel kombëtar, ndërsa që të tria rajonet ruajnë të njëjtën strukturë të punësimit. Në fund të vitit 2012, numri i të papunëve në Shkodër qëndron në 19,417 persona, duke përbërë 13.6% të totalit të të papunëve, kurse Lezha me 15,021 persona të papunë përbën 10.6% të totalit. Ndërsa Tropoja regjistron 2,368 të papunë, ose rreth 36% të forcave të përgjithshme të punës që i përkasin grup-moshës 15-64 vjeç në rrethin e Tropojës. Papunësia është më e pranishme në zonat urbane, pasi ata që jetojnë në zonat rurale janë konsideruar si të vetë-punësuar.

Arsimi

Niveli i pabarabartë arsimor është i pranishëm në zonën e programit, me një rritje të analfabetizmit në zonat e thella. Të rinjtë me arsim të lartë kanë tendencë për t'u larguar drejt rajoneve që ofrojnë më shumë mundësi apo jashtë vendit. Sistemi i arsimit të mesëm është më pak tërheqës dhe i aksesueshëm, veçanërisht për popullsinë e re në zonat rurale të programit. Shkollat private dhe Formimi Profesional janë të pranishme, por nuk janë në gjendje që të përputhen me kërkesat e tregut të punës për punonjës të kualifikuar dhe të aftë, duke përbërë kështu një pengesë për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Dispozitat arsimore në të gjitha nivelet kërkojnë përmirësim, në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tregut të punës. Sistemi arsimor në zonën e programit në të dyja vendet kërkon reforma, veçanërisht përvoja praktike mësimore dhe lidhje me sektorin e biznesit. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore është një përparësi e madhe për të dyja qeveritë, në nivel qendror dhe lokal. Përmirësimi i sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një prioritet i madh për zonën e programit. Programi BNK do të ketë një rol të kufizuar në adresimin e këtyre çështjeve, por mund të mbështesë shkëmbimet midis shkollave dhe qendrave të formimit profesional në zonat kufitare. Prezenca e universiteteve dhe qendrave kërkimore në të dyja anët e zonës së programit është një pasuri për programin BNK dhe një mundësi jo vetëm për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit akademik, por edhe për inicimin e programeve kërkimore në zonën kufitare në sektorë të ndryshëm, të tillë si bujqësia apo turizmi.

Kërkimi shkencor & Zhvillimi është i pazhvilluar. Pavarësisht faktit se në zonën e programit janë të pranishëm 4 Universitete, investimet dhe aktivitetet mbështetëse qeveritare, rajonale ose lokale për Kërkimin shkencor dhe Zhvillimin janë të pamjaftueshme. Nuk ka të

[1] Census Mal i Zi, 2011.

[2] INSTAT, Buletini Statistikor Tremujor, nr. 2, 2013.

[3] Norma e papunësisë përfaqëson përqindjen e personave të papunësuar në popullsinë e përgjithshme aktive.

dhëna specifike mbi kërkimin shkencor, zhvillimin dhe inovacionin. Megjithatë nuk ka pothuajse asnjë bashkëpunim midis institucioneve të arsimit në të dyja vendet, dhe fusha e kërkimit shkencor, zhvillimit dhe inovacionit nuk është eksploruar. Mali i Zi shpenzon rreth 0.41% të GDP-së në Kërkim shkencor dhe Zhvillim[1], ndërkohë që Shqipëria shpenzon rreth 0.02% të GDP-së së saj[2]. Shqipëria dhe Mali i Zi kanë nënshkruar një marrëveshje në lidhje me lëvizjen e studiuesve dhe ekspertëve teknik midis universiteteve partnere; ngritjen e qendrave të përbashkëta kërkimore për të studiuar burimet hidrike të lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës; dhe një qendër të përbashkët për studimet e avancuara për rreziqet sizmike në Ballkanin Perëndimor.

Shëndetësia

Organizimi i sistemit shëndetësor në Mal të Zi dhe Shqipëri është i ngjashëm; ai është kryesisht publik me një prani modeste (por në rritje) private, dhe mbulimi territorial është i pajisur siç duhet me shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor. Në përgjithësi, shërbimet shëndetësore në zonën e programit janë duke u përmirësuar, por duhet të bëhet akoma më shumë për të siguruar akses universal në shërbime të tilla edhe nga familjet e varfra. Sfida kryesore e radhës për të garantuar që të gjithë qytetarët janë të pajisur me shërbimet e duhura shëndetësore është heqja e pengesës ekonomike për të pasur akses në shërbimet cilësore, e cila është e rënduar nga mungesa totale e sigurimit shëndetësor.

Kultura

Në përgjithësi, në zonën e programit kultura karakterizohet nga elemente të ndryshme të traditave individuale dhe të përbashkëta. Qendrat turistike dhe qytetet e mëdha janë të pasura me trashëgimi kulturore që përfshijnë monumente dhe vende fetare (kisha, manastire dhe xhami), qytete të vjetra, vende arkeologjike dhe muzeume të ndryshme. Zona e programit është gjithashtu e pasur në traditën e kuzhinës dhe artizanatit, të cilat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit. Bashkëpunimi ndërkufitar mund të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e kësaj trashëgimie, si dhe në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të bashkëpunimit rajonal midis dy vendeve. Investimet dhe subvencionet e kufizuara publike kanë mbajtur një nivel të ulët të aktiviteteve kulturore në zonën e programit, pavarësisht trashëgimisë së saj të pasur. Megjithatë, aktivitetet kulturore dhe kontaktet mund të intensifikohen, duke krijuar kështu një bazë për një bashkëpunim ndërkufitar më aktiv. Kjo krijon kushte të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të nismave të përbashkëta që synojnë shtimin e vlerës në trashëgiminë e përbashkët në të dyja anët e zonave kufitare.

Shoqëria Civile

Në **Mal të Zi** janë 5,843[3] Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) të regjistruara. Pjesa më e madhe e tyre janë shoqata qytetare (5665), dhe 175 janë fondacione. OSHC-të me më shumë ndikim dhe përvojë janë të vendosura në Podgoricë, aktive në sektorë të ndryshëm (të drejtat e njeriut, politikat publike, mjedisi dhe zhvillimi rural, ngritja e kapaciteteve, aftësitë e kufizuara etj.). Shumica e tyre kanë një përvojë në përcaktimin e projekteve BNK. Kapacitetet njerëzore dhe kapacitetet e financimit janë përgjithësisht të pamjaftueshme; partneriteti me autoritetet lokale, si dhe krijimi i rrjeteve rajonale të OSHC-ve janë ende të dobëta. Megjithatë, rrjeti lokal i organizatave komunitare është i shumëllojshëm dhe i pasur. Disa prej tyre, të tilla si shoqatat e malësorëve, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e nismave BNK.

Sektori i OSHC-ve në **Shqipëri** është i vogël dhe relativisht i pazhvilluar. Zyrtarisht ekzistojnë 2,231 shoqata, 311 fondacione dhe 552 qendra të regjistruara [4]. Shumica e OSHC-ve janë të përqendruara në kryeqytet (Tiranë), ose në rajonin qendror (i cili përfshin Tiranën dhe qytetet e mëdha të tilla si Shkodra, Durrësi, Elbasani, Korça). Shoqëria civile është e përfaqësuar dobët në të gjitha zonat rurale. Sektori i Shoqërisë Civile në Shqipëri, si një i tërë, është pak i integruar dhe

[1] S & Zh në 2011, Zyra Statistikore e Malit të Zi, publikimi nr. 24.

[2] Shqipëri, Buxheti i Shtetit 2012.

[3] Raporti i Vlerësimit të Nevojave në Mal të Zi nga TACSO. Nuk dihet se sa prej tyre janë aktive.

[4] Vlerësimet e fundit të shoqërisë civile dhe vëzhgimet intensive nga Zyra e Projektit TACSO në Shqipëri vlerësojnë se numri i përgjithshëm i OSHC-ve aktive nuk i kalon 450.

përfaqësuar. Nuk ka asnjë forum të sektorëve të gjerë ose rrjet që i dedikohet koordinimit të përpjekjeve të OSHC-ve.

Mjedisi dhe Natyra

Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit janë të rëndësishme për një zhvillim të qëndrueshëm të zonës së programit, e cila është mjaft e pasur në burime mjedisore dhe biodiversitet në të dyja anët e kufirit. Megjithatë ka disa faktorë që kërcënojnë burimet mjedisore në zonën e programit, të tillë si; shpyllëzimi për shkak të rënies së pakontrolluar të pemëve; menaxhimi i varfër i ujit dhe i ujërave të zeza; largimi i pakontrolluar i mbeturinave; urbanizimi i parregulluar; ndotja industriale në disa zona; vend-groposjet e paligjshme, të cilat rrezikojnë ndotjen e lumenjve dhe liqeneve; përdorimi intensiv i pesticideve, i cili po dëmton bujqësinë; peshkimi i tepruar dhe gjuetia e jashtëligjshme, të cilat kërcënojnë faunën në liqene dhe lumenj. Degradimi i tokës është i pranishëm në të dyja anët e kufirit. Bashkëpunimi midis dy vendeve në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e liqenit të Shkodrës është rritur në dekadën e fundit.

Mali i Zi ka një diversitet të lartë biologjik, për shkak të sfondit të tij gjeologjik, klimës dhe pozicionit në afërsi të detit dhe maleve. Mali i Zi ka dy vende të Trashëgimisë Botërore, një rezervë të biosferës dhe pesë parqet kombëtare. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit është një shtyllë e të gjitha strategjive të zhvillimit të vendit. Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura të Malit të Zi mbulon 108,866 ha[1] ose 7.88% të territorit të përgjithshëm. Ajo përbëhet nga 5 parqe kombëtare - Liqeni i Shkodrës, Durmitor, Lovćen, Biogradska Gora, dhe Prokletije.

Në Shqipëri, zona e programit ofron një biodiversitet dhe klimë të pasur, pasi ajo përfshin malet, kodrat, fushat, liqenin, lumenjtë dhe bregdetin. Ajo ka 8 parqe kombëtare[2], rezerva natyrore dhe peizazhe të mbrojtura, të cilat mbulojnë mbi 13% të territorit të përgjithshëm. Parku më i rëndësishëm natyror në zonën e programit është Liqeni i Shkodrës.

Ndryshimet sociale dhe ekonomike të viteve të fundit si dhe ndryshimet demografike në Shqipëri dhe Mal të Zi, kanë ushtruar presion mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe biodiversitetit në zonën e programit. Dëmet e dekadës së kaluar janë të dukshme në zonën e pyjeve, për shkak të ndërhyrjeve të popullsisë lokale. Shumica e dëmit ka ardhur për shkak të prerjeve abuzive dhe mbi-kullotjes. Mbrojtja e burimeve natyrore me fokus tek pyjet, zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimi i burimeve ujore përfaqësojnë vlerat ekonomike dhe mjedisore për këtë zonë. Megjithëse ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit është rritur, një shkallë më e lartë e zbatimit të standardeve për mbrojtjen e mjedisit është e nevojshme për të siguruar zhvillimin e duhur urban dhe zgjerimin e turizmit. Reduktimi i ndotjes ekzistuese, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik dhe garantimit të një mjedisi të pastër, i lidhur me masat për të mbrojtur tokën nga shkatërrimi natyror dhe artificial si dhe zbatimi i një procesi strategjik të planifikimit urban, janë sfidat kryesore për t'u përballuar në zonën e programit.

2.2 Gjetjet kryesore

Zona e programit është e ndryshme, e megjithatë, disa tipare të përbashkëta në lidhje me natyrën, pozicionin gjeografik, tendencat demografike, ekonominë, kapitalin njerëzor etj., mund të gjenerojnë sinergji dhe të jenë një mundësi e mirë për zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave BNK.

- **Karakteristikat ekonomike** të të dyja vendeve tregojnë tendenca të ngjashme. Të dyja vendet janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mbi mesatare nga Banka Botërore. Struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërsa rajonet shqiptare mbështeten në bujqësi, shërbime, tregje shumice dhe pakice, rajonet malazeze shfaqin industri më të zhvilluar, dhe një niveli shumë më të zhvilluar të turizmit. Përgjithësisht, bujqësia është e rëndësishme për të dyja palët. Sfidat kryesore përfshijnë: adresimin e pabarazive ekonomike rajonale; nivelin e ulët të prodhimtarisë si pasojë e mungesës së njohurive teknologjike dhe aftësive të punës, si dhe për shkak të mospërputhjes së kërkesës së tregut për shërbime dhe produkte të cilësisë së lartë me

[1] MONSTAT, Libri statistikor 2012

[2] Shqipëria, Ministria e Mjedisit, Rrjeti i zonave të mbrojtura në Shqipëri, shtator 2013

aftësitë joadekuate të punës.

- **Konkurrenca është e ulët në të dyja anët e kufirit.** Produktivitet më i lartë dhe investime të mëtejshme në njohuritë mbi përdorimin e teknologjive të inovacionit është një parakusht për t'u bërë më konkurrues si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Zakonisht, bizneset në zonat kufitare shfrytëzojnë mundësitë për tregti përtej kufirit dhe në arenën ndërkombëtare, por tregtia ndërmjet dy vendeve dhe palëve të treta është ende e kufizuar nga barrierat e shumta administrative.

- **Forcimi i rrjeteve të NVM-ve dhe lidhjet e shërbimeve ekzistuese në zonat kufitare janë një potencial që përdoret shumë pak.** Mbi 97% e NVM-ve të regjistruara punësojnë më pak se 4 persona. Niveli i bashkëpunimit përtej kufirit është minimal. Një sfidë kryesore është aksesi i varfër i NVM-ve në burimet financiare. Politikat tepër të kujdesshme në kredi-dhënie të miratuara nga institucionet financiare në të dyja vendet, janë një pengesë serioze në rritjen e ndërmarrjeve të vogla në zonën e programit. Promovimi i *biznesit virtual* është një sfidë. Me pak fjalë, në aspektin e zhvillimit të sektorit privat ka sinergji të qarta për t'u zhvilluar brenda zonës së programit, të cilat duhen mbështetur nga programi BNK.

- **Të dyja anët e zonës së programit janë duke u bërë gjithnjë e më tërheqëse për investitorët e huaj,** por tek të dyja anët ka nevojë për përmirësimin e kushteve, veçanërisht të infrastrukturës, për të bërë biznes. Investimet në turizëm, në energjinë e rinovueshme dhe në bujqësi mund t'i bëjnë këto të fundit sektorët potencialë për tërheqjen e më shumë IHD-ve (Investime të Huaja Direkte). Industritë e përpunimit të dritës dhe ushqimit janë konsideruar gjithashtu si një potencial për rritjen e përshpejtuar ekonomike të zonës së programit.

-**Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në zonën e programit, por përdoret pak**. Në përgjithësi, ekonomia rurale është e fragmentuar, në një shkallë më të lartë në zonën shqiptare të programit, dhe pronat e vogla bujqësore kanë vështirësi për të hyrë në treg. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë plotësuese sesa konkurruese. Sfidat kryesore përfshijnë: përmirësimin e aksesit në treg; forcimin e sistemit të sigurisë ushqimore dhe organeve inspektues; dhe në përgjithësi rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë. Ndërhyrja e ardhshme duhet të synojë përmirësimin e efikasitetit në bujqësi dhe pylltari, si dhe të zhvillojë burime shtesë të të ardhurave nga ruajtja e pasurive natyrore dhe turizmit.

- **Papunësia mbetet një problem i mprehtë** për popullsinë e zonës së programit, veçanërisht për grupet e ndjeshme sociale siç janë të rinjtë, popullsia rurale, dhe gratë. Pasiguria e punësimit konsiderohet si arsyeja kryesore për shkallën e lartë të migracionit, veçanërisht në zonat rurale ose më pak të zhvilluara, ku niveli i papunësisë është i lartë si rezultat i mjeteve të jetesës dhe prodhimeve bujqësore të një niveli të ulët që ofrojnë një formë të sigurimit shoqëror për pjesën më të madhe të popullsisë rurale dhe të punës, si një amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

- Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshëm të zhvillimit të zonës së programit. Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit mbështetur kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Sfidat në këtë fushë përfshijnë: nevojën për të rritur zbatimin e rregullave dhe standardeve për mjedisin, për të siguruar menaxhim më të mirë të pyjeve dhe zonave të mbrojtura, në mënyrë që të parandalohet degradimi i mjedisit; parandalimin e shfrytëzimit të pakontrolluar të burimeve natyrore në zonën e programit; rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve lokalë për përdorim më të mirë të burimeve natyrore. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, kontrolli i ndotjes, dhe përmirësimi i menaxhimit të tokave janë ndër prioritetet kryesore për t'u adresuar nga planet zhvillimore qeveritare dhe lokale. Vleftësimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës, veçanërisht në anën shqiptare të kufirit.

- Infrastruktura e varfër është një sfidë kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës së programit. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës

publike mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në një rritje të përgjithshme të pasurisë në zonën e programit. Zhvillimi i infrastrukturës që lehtëson biznesin dhe përhapjen e rrjeteve dhe shërbimeve për të mbështetur zhvillimin dhe inovacionin e biznesit, mund të kontribuojë në një rritje të përgjithshme të pasurisë dhe ekonomisë në zonë.

- Zona e programit ka potencial të lartë turistik, por këto mundësi janë përdorur kryesisht në anën e Malit të Zi, ndërsa turizmi në anën e Shqipërisë është zhvilluar pak, pavarësisht potencialit të madh që ka. Iniciativa BNK me qëllim për të prodhuar një ofertë të përbashkët turistike, duhet të konsiderohet. Sfidat kryesore mbeten: zhvillimi i pa balancuar i turizmit, me mbizotërimin e turizmit bregdetar dhe nevojën për të zhvilluar lloje të ndryshme të turizmit (malor, kulinar dhe agroturizëm) në të gjithë zonën e programit; infrastruktura e dobët e turizmit (veçanërisht në anën shqiptare); vizibiliteti i ulët i trashëgimisë së pasur historike dhe kulturore dhe i veçorive tradicionale; nevoja për të rritur të ardhurat në zonën e programit, duke nxitur aktivitetet për të ruajtur traditën, dhe trashëgiminë kulturore dhe natyrore. Sinergji të dukshme, me mundësi që të mbështeten nga bashkëpunimi ndërkufitar (programi BNK), mund të ndërtohen midis rajoneve në Shqipëri dhe zonave bregdetare në Mal të Zi, por edhe me "zonat më pak turistike" në verilindje të Malit të Zi, të cilat kanë karakteristika të ngjashme me veriun e Shqipërisë, në aspektin e mjedisit, natyrës së egër dhe maleve.

- Ekziston një trashëgimi e pasur historike-kulturore-artistike në zonën në kufi, e cila duhet të ruhet. Vleftësimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe kulturore mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës. Trashëgimia kulturore është një pasuri për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Bashkëpunimi midis institucioneve kulturore është i pranishëm, por ai mund të intensifikohet akoma më tej.

- **Përmirësimi i cilësisë së sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një sfidë dhe prioritet** për zonën e programit, veçanërisht në zonat rurale. Prezenca e universiteteve të rëndësishme private dhe publike si dhe e qendrave kërkimore të biznesit në zonën e programit është një pasuri për programin BNK. Veprime të mëtejshme të përbashkëta do të mund të ndërmerren për të krijuar rrjetin e qendrave të formimit profesional si dhe të institucioneve të larta, agjencive dhe organizatave kërkimore.

- Në përgjithësi, **sektori i shëndetësisë** është i dobët dhe i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Mungesa e një kuadri të duhur ligjor për sigurimin shëndetësor në zonat rurale (në anën shqiptare të kufirit), vazhdon të pengojë zhvillimin e këtij sektori. Duke pasur parasysh se sektori i shëndetësisë menaxhohet në nivel qendror, ndoshta nuk mund të bëhet shumë në kuadrin e programeve BNK, por sigurisht që ka vend për aktivitete të mundshme të përbashkëta që lidhen me fushatat parandaluese dhe edukimin shëndetësor.

- **Inkurajimi i rrjeteve rajonale të OSHC-ve** (duke përfshirë organizatat e sportit, rinisë dhe ato kulturore) mund të kontribuojë në ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet komuniteteve në të dyja anët e kufirit në këtë zonë të programit shumetnik.

- **Depërtimi i kërkimit shkencor dhe zhvillimit dhe i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është në disproporcion të dukshëm midis vendeve të programit, dhe mbetet në nivel të ulët.** Investimet e pamjaftueshme, mungesa e aktiviteteve mbështetëse në nivel qendror, rajonal ose lokal për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, janë të pranishme, pavarësisht faktit që në zonën e programit ka 4 Universitete. Nuk ka të dhëna specifike mbi kërkimin shkencor, zhvillimin dhe inovacionin, por praktikisht mungon bashkëpunimi midis institucioneve edukuese në të dyja vendet, dhe kjo fushë është e pa eksploruar.

-**Në përgjithësi, qeveritë lokale dhe rajonale janë të dobëta financiarisht dhe nuk mund të nxisin zhvillimin lokal.** Ndryshe nga Shqipëria, Mali i Zi nuk ka qeverisje lokale. Sfidat përfshijnë: mungesën e aftësive në menaxhim, kontroll financiar dhe buxhetim, si dhe qasjet demokratike në proceset vendimmarrëse. Absorbimi i fondeve të BE-së është i ulët. Bashkëpunimi midis qeverive lokale ndërmjet dy vendeve mund të përmirësohet. Procesi i decentralizimit është duke vazhduar në të dyja vendet.

Bazuar në analizën e situatës dhe në analizat PESTLE ose SWOT, ndërhyrjet e mëposhtme të

mundshme konsiderohen si thelbësore për zhvillimin e rajonit kufitar:

1. Turizmi dhe trashëgimia kulturore;

2. Mbrojtja e mjedisit, ndryshimi klimatik dhe parandalimi i riskut;

3. Punësimi, lëvizja gjeografike e punonjësve dhe përfshirja sociale;

4. Asistenca teknike.

Seksioni 3: Strategjia e Programit

3.1 Arsyetim – Arsyetimi për strategjinë e zgjedhur të ndërhyrjes

Programi BNK do të synojë të promovojë iniciativa të përbashkëta ndërkufitare dhe veprime që synojnë të përmirësojnë ekonominë e zonave kufitare në mënyrë të qëndrueshme sociale dhe mjedisore. Në kuadër të këtij programi janë zgjedhur tri prioritete tematike, të cilat përfshijnë:

PRIORITETI TEMATIK 1: Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Prioriteti i parë do të promovojë iniciativa të përbashkëta ndërkufitare dhe veprime që synojnë të mbështesin zhvillimin ekonomik me fokus turizmin (por jo ekskluzivisht), pasi ai konsiderohet të ketë një potencial të madh për të gjithë zonën e programit si një e tërë. Përveç kësaj, do të mbështeten shkëmbime kulturore dhe sociale. Ky prioritet i programit do të kontribuojë në përmirësimin dhe rritjen e standardeve të jetesës, duke ofruar mundësi për partneritete më të gjera dhe shkëmbime të interesit të përbashkët përtej kufirit, për të zhvilluar turizmin dhe për të vlerësuar trashëgiminë kulturore të zonës. Aktivitetet që do të zbatohen, pritet të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, krijimin e rrjeteve dhe partneriteteve ndërmjet pushtetit vendor dhe palëve të interesuara në nivel lokal për të promovuar vendet e përbashkëta turistike, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, inkurajimin e sipërmarrjes dhe konkurrencës në sektorin e turizmit, promovimin e ofertave të përbashkëta turistike, zhvillimin dhe promovimin e markave të reja të produkteve vendase, promovimin e imazhit të zonës për investitorët dhe vizitorët potencial etj. Rezultatet e pritshme do të kenë një ndikim në promovimin e aktiviteteve sipërmarrëse turistike përtej kufirit dhe rritjen e shkëmbimeve të diversitetit kulturor, vlerave historike dhe kulturore, si një tipar unik i përbashkët i zonave në secilën anë të kufirit.

PRIORITETI TEMATIK 2: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut

Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit duke u mbështetur kryesisht tek burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e burimeve natyrore janë vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm. Aktivitetet në kuadër të këtij prioriteti do të mbështesin bashkëpunimin për mbrojtjen e mjedisit, si për shembull Shkodra/Liqeni i Shkodrës dhe rrethinat e saj, duke krijuar sinergji ndërkufitare për menaxhimin e zonave të mbrojtura që ndodhen në zonën kufitare, do të mbështesin reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e integruar, menaxhimin e ekosistemeve të ndjeshme dhe përdorimin e mirë të ujërave sipërfaqësore, sistemet e integruara të monitorimit të mjedisit dhe bazat e të dhënave, veprime të përcaktuara për të inkurajuar aktivitetet ekonomike ekologjikisht-miqësore etj., me qëllim vlerësimin e mëtejshëm të burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik.

PRIORITETI TEMATIK 3: Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit

Ky prioritet do të synojë të adresojë çështjet që lidhen me normat e larta të papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë, integrimin e ulët të tregjeve të punës ndërkufitare, dhe lëvizjen gjeografike të punonjësve. Aktivitetet në kuadër të këtij prioriteti do të synojnë të promovojnë lidhjen më të mirë të formimit profesional me kërkesat e tregut të punës, në mënyrë që të rriten aftësitë e fuqisë punëtore dhe mundësitë për punësim, iniciativat ekonomike të punës intensive me një shtrirje ndërkufitare, bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit dhe sektorit privat për të përmirësuar përputhjen e kurrikulave të trajnimit me kërkesat e tregut të punës, zhvillimin e *mësimit virtual* të vazhdueshëm për të përmirësuar aftësitë e personave të punësuar si dhe atyre të papunë, për të rritur mundësitë e tyre në tregun e punës, mbështetjen e shfrytëzimit të

teknologjive TIK për krijimin e rrjeteve dhe lëvizjet ndërkufitare të fuqisë punëtore.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të kontekstit dhe arsyetimet që çojnë në zgjedhjen e këtyre prioriteteve.

Tabela 1: Pasqyrë sintetike e justifikimit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike

Prioritetet tematike të zgjedhur	Justifikimi për përzgjedhjen
Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.	- Turizmi është sektori ekonomik më premtues në Mal të Zi, ndërkohë që edhe në zonën e programit në Shqipëri ka një potencial të lartë për zhvillim; - Nevoja për të nxitur zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit (malor, kulinar, dhe agroturizmi) në të gjithë zonën e programit, pasi ka një zhvillim të çekuilibruar të turizmit, me mbizotërimin e turizmit bregdetar; - Nevoja për të rritur vizibilitetin e trashëgimisë së pasur historike dhe kulturore, si dhe të veçorive tradicionale, me qëllim rritjen e të ardhurave në zonën e programit, duke nxitur aktivitetet për të ruajtur traditën dhe trashëgiminë kulturore dhe natyrore; - Nevoja për të rritur nivelin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në fushën e zhvillimit të turizmit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut.	- Biodiversiteti i pasur natyror dhe ekzistenca e disa zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare në zonën e programit, si dhe cenueshmëria e lartë e rajonit nga përmbytjet; - Nevoja për të promovuar dhe për të përmirësuar zbatimin e ligjit dhe standardeve mbi mjedisin, për të siguruar menaxhim më të mirë të pyjeve dhe zonave të mbrojtura, në mënyrë që të parandalohet degradimi i mjedisit; - Nevoja për të nxitur përpjekjet e përbashkëta në menaxhimin dhe kontrollin për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe parandalimin e shfrytëzimit të pakontrolluar të burimeve natyrore në zonën e programit; - Nevoja për të nxitur rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve lokalë për një përdorimin më të mirë të burimeve natyrore, për potencialin e lartë ekzistues në pyje, si dhe për promovimin e ekoturizmit.

Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale.	- Shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë dhe gratë, reduktimi i popullsisë dhe largimi i personave të aftë dhe të arsimuar nga pjesa rurale e zonës së programit, integrimi shumë i ulët i tregjeve të punës ndërkufitare, dhe lëvizja e ulët ndërkufitare e punonjësve; - Nevoja për të rritur aksesin në tregun e punës, veçanërisht të popullsisë rurale, duke nxitur zhvillimin e programeve të punësimit për integrimin social të grupeve të margjinalizuara, në mënyrë që të zbutet rreziku i normave të larta të migrimit; - Nevoja për të nxitur lidhjen më të mirë të formimit profesional me kërkesat e tregut të punës, në mënyrë që të rriten aftësitë e fuqisë punëtore dhe si rrjedhojë të rriten mundësitë për punësim; - Nevoja për të promovuar kthimin e multietnicitetit në zonën e programit si një avantazh për përfshirjen ekonomike, sociale dhe kulturore që rrit nivelin e integrimit të tregjeve të punës ndërkufitar, si dhe lëvizjen gjeografike të punonjësve; - Nevoja për të promovuar aktivitetet e kërkimit shkencor dhe zhvillimit duke përdorur institucionet ekzistuese kërkimore dhe ato të arsimit të lartë në fushat me interes të përbashkët, të cilët rrisin përfitimet që rrjedhin nga të tilla bashkëpunime ndërkufitare.

3.2 Përshkrimi i prioriteteve të programit

Tabelat e mëposhtme paraqesin një përshkrim të çdo prioriteti, të mbështetur nga objektivat specifikë, rezultatet, aktivitetet dhe treguesit e suksesit:

PRIORITETI 1 – NXITJA E TURIZMIT DHE E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE NATYRORE				
Objektivi specifik	**Rezultatet**	**Treguesit***	**Burimet e verifikimit**	**Llojet e aktiviteteve**
Objektivi specifik 1 **Konkurrenca e sektorit të turizmit rritet nga vlerësimi ekonomik i**	**Rezultati 1.1** **Cilësia e shërbimeve dhe produkteve të turizmit është**	1.1.1 Kontributi i turizmit në GDP-të rajonale për çdo anë të programit, rritur me 20% *(standardi bazë 2013, Mali i Zi 9.9% të GDP, Shqipëria 6.4% të GDP)*	Statistikat zyrtare Raportet nga ministritë/autoritetet përkatëse kombëtare	- Inkurajimi i sipërmarrjes dhe konkurrencës në sektorin e turizmit - Diversifikimi i ofertës turistike, përmirësimi i saj dhe promovimi i atraksioneve turistike më pak të njohura në zonën e

* Bazuar në aktivitetet mbështetëse të programit deri më 2022-shin.

trashëgimisë kulturore dhe natyrore	**përmirësuar**	1.1.2 Të paktën 5 oferta të reja turistike të përbashkëta, të zhvilluara për zonën e programit *(standardi bazë 2013 = 2)* 1.1.3 Ofertat turistike të krijuara nga iniciativat BNK, të miratuara dhe pranuara nga të paktën 40% e operatorëve turistikë aktivë në zonë 1.1.4 Dy harta turistike dhe oferta të integruara turistike të prezantuara për zonat malore (më pak të favorshme) në të dyja anët e kufirit	Raportet e organizatave kombëtare dhe lokale të turizmit Raportet e monitorimit / projektit	programit - Rritja e kapaciteteve dhe futja e teknikave dhe qasjeve të reja për promovimin, duke përfshirë hartat, përdorimin e TIK, multimedian, hulumtimin etj. - Iniciativa të përbashkëta lidhur me trajnimin profesional, të cilat synojnë aftësitë që lidhen me një ofertë konkurruese turistike dhe kërkesat e tregut - Vepra të vogla infrastrukturore dhe sigurimi i pajisjeve për të përmirësuar standardet e ofertës turistike dhe restaurimi ose ruajtja e trashëgimisë historike
	Rezultati 1.2 **Bashkëpunim i në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe natyrore është rritur (p.sh. rreth zonës së Shkodrës / Liqenit të Shkodrës)**	- 1.2.1 Nr. i turistëve (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) që vizitojnë zona të tilla si Shkodra / Liqeni i Shkodrës, i rritur me 30% - 1.2.2 2000 pjesëmarrës (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) në eventet e reja kulturore - 1.2.3 Nr. i vizitorëve (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) në vendet kulturore dhe natyrore ku janë bërë ndërhyrjet e vogla, i	Statistikat zyrtare Raportet nga ministritë/autoritetet përkatëse kombëtare Raportet e organizatave kombëtare dhe lokale të turizmit Raportet e monitorimit / projektit	- Fushata ndërgjegjësimi dhe programe dhe kurrikula edukative lidhur me turizmin dhe shfrytëzimin më të mirë të potencialeve të tij në zonë - Aktivitete për të promovuar potencialin turistik kulturor dhe natyror të zonës së programit - Aktivitete të përbashkëta për të nxitur, por edhe për të përtërirë vlerat kulturore dhe trashëgiminë natyrore nëpërmjet festivaleve, panaireve, konkurseve - Trajnime për të rritur cilësinë e shërbimeve në vendet kulturore dhe
		rritur me 20%		natyrore - Aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin e njerëzve mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, veçanërisht në shkolla

*- Shumica e treguesve kanë si bazë "0". Përkatësisht, disponueshmëria e kufizuar e informacionit statistikor dhe burimeve nuk lejon përcaktimin e saktë të treguesve në nivelin bazë. E njëjta qasje vlen për të tri prioritetet tematike. Ju lutem kini parasysh se kudo ka synime, ato janë thjesht tentativë, pasi shumat e alokimeve të programit janë ende të panjohura.

PRIORITETI 2 – MBROJTJA E MJEDISIT, NXITJA E PËRSHTATJES DHE LEHTËSIMIT NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I RREZIKUT				
Objektivi specifik	**Rezultatet**	**Treguesit***	**Burimet e verifikimit**	**Llojet e aktiviteteve**
Objektivi Specifik 2 **Mbrojtja e burimeve mjedisore tek liqeni dhe zonat alpine, çohet më tej**	**Rezultati 2.1** Ndërgjegjësimi mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve mjedisore në zonën e liqenit dhe zonat alpine, ka avancuar	- 2.1.1 Të paktën 40% e popullsisë (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) në zonën e programit ka qenë subjekt i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi mjedisin. - 2.1.2 Kontrolli i niveleve të ndotjes në zonën e Shkodrës / Liqenin e Shkodrës është bërë më i saktë dhe më i rregullt teknikisht - 2.1.3 Shkodra / Baseni i Liqenit të Shkodrës plotëson kushtet për t'u bërë pjesë e zonave të mbrojtura në Listën e Rezervës së Biosferës të UNESCO-s - 2.1.4 Të paktën një kurrikul e	Statistikat zyrtare Raportet nga ministritë/autoritetet përkatëse kombëtare Raportet e bashkive/ institucioneve lokale Raportet e monitorimit / projektit	- Aktivitete të projektuara për të trajtuar së bashku mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit në zonën e programit - Mbështetje për mbrojtjen dhe menaxhimin e integruar të ekosistemeve të ndjeshme duke i dhënë përparësi zonave të mbrojtura dhe mbrojtjes së zonës së programit - Aktivitete të projektuara për të inkurajuar aktivitetet ekonomike ekologjikisht miqësore në zonën e programit - Aktivitete të projektuara për të parandaluar dhe për të menaxhuar fatkeqësitë natyrore dhe rreziqet mjedisore të bëra nga njeriu, të cilat ndikojnë në zonën e programit - Mbështetje për
		harmonizuar mbi edukimin mjedisor dhe / ose një program ekstra- kurrikular, i futur në arsimin e mesëm në të dyja anët e kufirit		ndërgjegjësimin e popullsisë lidhur me rëndësinë, mbrojtjen dhe promovimin e burimeve mjedisore të zonës së programit

* Bazuar në aktivitetet mbështetëse të programit deri në 2022.

PRIORITETI 3 – NXITJA E PUNËSIMIT, LËVIZJES GJEOGRAFIKE TË PUNONJËSVE, DHE PËRFSHIRJES SOCIALE				
Objektivi specifik	**Rezultatet**	**Treguesit***	**Burimet e verifikimit**	**Llojet e aktiviteteve**
Objektivi Specifik 3 **Punësimi dhe përfshirja sociale nxitet**	**Rezultati 3.1** Aksesi në tregun e punës i përmirësuar, veçanërisht për grupet vulnerabël	- 3.1.1. Të paktën 5 iniciativa të reja të biznesit që nxisin lëvizjen e fuqisë punëtore përtej kufirit - 3.1.2. Të paktën 20% e të papunëve (të ndarë sipas gjinisë dhe moshës) pjesëmarrës në iniciativat BNK, ia dalin për të gjetur një punë - 3.1.3. Të paktën 300 të rinj (të ndarë sipas gjinisë) të trajnuar nëpërmjet shërbimeve të reja të të mësuarit gjatë gjithë jetës - 3.1.4. Të paktën 10% e NVM-ve të reja të krijuara në zonat ndërkufitare	Statistikat zyrtare Raportet nga ministritë/autoritete t përkatëse kombëtare Regjistrat e agjencive të punësimit Regjistrat e Dhomave të tregtisë Raportet e monitorimit / projektit	- Mbështetja e bashkëpunimit midis dhe ndërmjet institucioneve të arsimit (profesional) dhe sektorit privat për të përmirësuar përputhjen e kurrikulave të trajnimit për grupet në nevojë, me kërkesën e tregut të punës, duke përfshirë programet e mësimit virtual dhe përdorimin e TIK - Iniciativa mbështetëse dhe fushata për vetë-punësim, veçanërisht në zonat rurale, duke përfshirë mbështetjen e grupeve vulnerabël për të nisur një biznes - Mbështetja e forcimit të kapaciteteve të institucioneve të promovimit të punës, shkëmbimi i eksperiencave dhe modeleve më të mira për të rritur punësimin (veçanërisht të grupet vulnerabël) brenda dhe përtej kufijve - Aktivitete që synojnë krijimin
		janë në pronësi të të rinjve dhe anëtarëve të grupeve të margjinalizuara (të ndarë sipas gjinisë dhe grupit vulnerabël)		e mundësive dhe aftësive për punë për grupet në nevojë të shoqërisë - Punë kërkimore për të nxitur punësimin, lëvizjen e fuqisë punëtore dhe përfshirjen sociale - Inkurajimi i partneritet pushtet lokal - OSHC mbi përfshirjen sociale (plane veprimi në nivel lokal për grupet në nevojë, rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për të menaxhuar programet sociale dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e aksioneve të ndërmarra) - Organizimi i programeve të shkëmbimit të të rinjve, për shembull, nëpërmjet programeve të shkëmbimit shkollor ose iniciativave të tjera të OJQ-ve

* Bazuar në aktivitetet mbështetëse të programit deri në 2022.

Në rastet kur është e mundur, zbatimi i prioriteteve tematike dhe objektivave specifikë të programit duhet të bëhet në përputhje me objektivat e vendosur nga Strategjia e BE-së për Rajonin Adriatik dhe Jonian "COM (2014) 357".

PRIORITETI 4 – ASISTENCA TEKNIKE

Objektivi specifik:

Objektivi specifik i asistencës teknike është të sigurojë zbatimin efektiv, efikas, transparent dhe në kohë të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e komuniteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, dhe në popullsinë e zonës së programit në përgjithësi. Gjithashtu ai mbështet aktivitete ndërgjegjësimi në nivel kombëtar, me qëllim informimin e qytetarëve në të dyja vendet përfituese të IPA II. Për më tepër, siç ka treguar përvoja në ciklin e programit 2007-2013, ky prioritet do të forcojë kapacitetin administrativ të autoriteteve dhe përfituesve që do të zbatojnë programin, me qëllim për të përmirësuar pronësinë dhe përshtatshmërinë e programit me rezultatet e projekteve.

Alokimi për asistencën teknike do të përdoret për të mbështetur punën e Strukturave Kombëtare Operative (SO) dhe të Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (KPM), në sigurimin e fillimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit efikas të programeve, si dhe për një përdorim optimal të burimeve. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të një Sekretariati të Përbashkët Teknik (SPT) me bazë në territorin e Malit të Zi dhe një Zyrë Antena në Shqipëri. SPT do të jetë në krye të menaxhimit të përditshëm të programit dhe do t'i raportojë mbi ecurinë e tij SO-ve dhe KPM-së.

Rezultatet e synuar:

1. Mbështetja administrative për Strukturat Operative (SO) dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM) të programit është rritur

Ky prioritet do të sigurojë një zbatim normal të programit gjatë të gjitha fazave të tij. Ai përfshin disponueshmërinë e mjeteve financiare dhe vendosjen e personelit të kualifikuar përgjegjës për të ndihmuar Strukturat Operative dhe Komitetin e Përbashkët të Monitorimit, si dhe krijimin dhe zbatimin e mekanizmave dhe procedurave të menaxhimit, monitorimit dhe kontrollit. Nëse kërkohet, ai gjithashtu do të kontribuojë në përgatitjen e ciklit pasardhës financiar (2021-2027).

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	***Njësia***	***Baza***	***Synimi deri në 2022***
Përqindja mesatare e përfituesve të kënaqur me mbështetjen nga programi i zbatuar[1]**	Përqindje	Nuk ka të dhëna	80%

2. Kapaciteti teknik dhe administrativ për menaxhimin dhe zbatimin e programit është rritur

Ky prioritet do të ofrojë mundësi për përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të strukturave menaxhuese të programeve, si dhe të aplikantëve të mundshëm dhe përfituesve të granteve. Aktivitete specifike për ngritjen e kapaciteteve do të planifikohen dhe zbatohen në bazë të nevojave të identifikuara gjatë zbatimit të programit. Si pjesë e mësimeve të nxjerra nga cikli i programit 2007-2013,

i. do të pritet një pjesëmarrje në rritje e anëtarëve të KPM në detyrat e përcaktuara nën kuadrin ligjor të IPA II; ii. kapaciteti i aplikantëve të mundshëm për zhvillimin e partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare do të rritet; dhe iii. kapaciteti i përfituesve të granteve për të përmbushur detyrimet e kontratave të tyre në mënyrë të kënaqshme, të do të përforcohet.

[1] Kërkon një studim të rregullt dhe të thjeshtë duke përdorur një pyetësor standard me pyetje të mbyllura.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022
Rritja mesatare e numrit të propozimeve të marra në kuadër të çdo thirrje të njëpasnjëshme*	Përqindje	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna*
Rritja mesatare e numrit të koncept ideve që do të kualifikohen për vlerësim të mëtejshëm	Përqindje	0	10%

[*]Ju lutemi të vini re se në perspektivën financiare 2014-2020, thirrjet e mundshme të përshtatura/ strategjike për propozime janë parashikuar me fokus të qartë dhe / ose kërkesa të caktuara në lidhje me përfituesit e mundshëm. Gjithashtu, thirrjet për projektpropozime mund të përdorin parimin e rotacionit për përzgjedhjen e prioriteteve tematike (PT) dhe objektivave të tyre specifikë, dhe në këtë aspekt numri i propozimeve jo domosdoshmërisht mund të rritet. Për këto arsye, rritja e pritshme e numrit të aplikimeve të marra mund të llogaritet për çdo thirrje të njëpasnjëshme në mënyrë individuale, dhe do të ndikohet nga një faktor që mund të llogaritet në bazë të: 1. Buxheti i përgjithshëm në dispozicion. 2. Prioritetet tematike, objektivat specifikë dhe rezultatet e përfshira në thirrjen për projektpropozime. 3. Shumat minimale dhe maksimale të lejuara të granteve. 4. Numri i aplikimeve dhe granteve të lejuara për aplikues/bashkaplikues /entet e lidhur; dhe 5. Çdo dispozitë tjetër e veçantë që ndikon në kritere të ndryshme të pranueshmërisë, të zbatueshme për një thirrje specifike për projektpropozime.

4.1.3 Vizibiliteti i programit dhe i rezultateve të tij, garantohet.

Programet BNK kanë qenë shumë të famshëm në zonat përfituese, përveç të tjerave, falë veprimeve të vizibilitetit të ndërmarra gjatë ciklit të programit 2007-2013. Duke parë numrin e aplikuesve në thirrjet pasuese, është vënë re se ka një interes në rritje për iniciativat e bashkëpunimit. Këto arritje duhet të ruhen dhe të përmirësohen edhe gjatë zbatimit të perspektivës financiare 2014–2020. Një shumëllojshmëri e kanaleve të komunikimit dhe mjeteve të publicitetit duhet të zhvillohet për të siguruar informacion të rregullt midis palëve të interesuara të programit dhe një audience më të gjerë, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në evente që lidhen me Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit.

Treguesit e rezultatit:

Treguesi	Njësia	Baza	Synimi deri në 2022
Rritja e numrit të personave që marrin pjesë në eventet promocionale	Përqindje	1,682	20%
Vizita në faqen e internetit të programit	Numër	3,244	50,000

Lloji i aktiviteteve:

Një listë jo shteruese e aktiviteteve të mundshme të mbuluara nga alokimi i asistencës teknike do të përfshijë:

Ngritja dhe funksionimi i Sekretariatit të Përbashkët Teknik dhe Antena-s së tij.

Organizimi i eventeve, takimeve, trajnimeve, vizitave studimore apo vizitave të shkëmbimit, për të mësuar nga praktikat më të mira të nismave të tjera të zhvillimit territorial.

Pjesëmarrja e stafit të strukturave të menaxhimit në forumet e Ballkanit Perëndimor apo të BE- së.

Përgatitja e manualeve / doracakëve të brendshëm dhe / ose të jashtëm.

Asistencë për aplikuesit e mundshëm në partneritet dhe për zhvillimin e projektit (forume për kërkimin e partnerëve etj.).

Këshilla për përfituesit e granteve mbi çështje lidhur me zbatimin e projektit.

Monitorimi i zbatimit të projektit dhe programit, duke përfshirë krijimin e një sistemi të monitorimit dhe raportimit përkatës.

Organizimi i aktiviteteve të vlerësimit, analizave, sondazheve dhe/ose studimeve.

Informim dhe publicitet, duke përfshirë përgatitjen, miratimin dhe rishikimin e rregullt të një plani vizibiliteti dhe komunikimi, shpërndarjen e informacionit (ditë informimi, mësimet e

nxjerra, studimet e rasteve më të mira, artikuj dhe deklarata për shtyp), ngjarje promocionale dhe artikuj të shtypur, zhvillimi i mjeteve të komunikimit, mirëmbajtja, përditësimi dhe përmirësimi i faqes së internetit të programit etj.

Mbështetje për punën e task forcës së përbashkët të ngarkuar me përgatitjen e ciklit të programit 2021–2026.

Pjesëmarrja në forume vjetore dhe aktivitete të tjera që lidhen me Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit.

Grupet e synuara dhe përfituesit përfundimtarë (listë joshteruese)*:*

- Strukturat e menaxhimit të programit, duke përfshirë autoritetet kontraktuese
- Aplikuesit e mundshëm
- Përfituesit e granteve
- Përfituesit përfundimtarë të projektit
- Publiku i gjerë

3.3 Çështjet horizontale dhe të ndërthurura

Çështjet e ndërthurura përcaktohen në një sërë konventash, deklaratash dhe traktatesh ndërkombëtare mbi zhvillimin, dhe janë të detyrueshme për vendet e BE-së dhe shumicën e vendeve përfituese. Ato duhet të merren në konsideratë në të gjitha fazat e ciklit të financimit.

Prandaj, në përputhje me objektivat dhe politikat e BE-së, programi do të përfshijë parimet horizontale të partneritetit ndërkufitar, pronësinë lokale dhe mundësitë e barabarta, dhe do të sigurojë që çështjet e ndërthurura, siç janë: mosdiskriminimi i minoriteteve dhe grupeve vulnerabël, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, mbrojtja e mjedisit, të drejtat gjinore, dhe qeverisja e mirë, respektohen dhe nxiten në hartimin dhe zbatimin e projekteve. Të gjitha çështjet e mësipërme synohen nëpërmjet 3 prioriteteve kryesore të programit.

Kuadri aktual i Politikës së Kohezionit të BE-së e bën zhvillimin mjedisor dhe të qëndrueshëm një nga temat horizontale që duhet të integrohet në të gjitha prioritetet, masat dhe projektet. Programi synon në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e mjedisit si një nga çështjet kryesore me interes për zonat ndërkufitare të synuara nëpërmjet prioritetit 2: Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut. Projektet që rrjedhin në kuadër të këtij prioriteti duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë që mjedisi nuk dëmtohet, por shndërrohet në një mundësi për zhvillimin rajonal.

BE-ja ka pranuar në mënyrë të përsëritur se barazia gjinore është çelësi për arritjen e objektivave të zhvillimit. Për më tepër barazia gjinore është një prioritet për BE-në. Programi synon në mënyrë të drejtpërdrejtë promovimin e punësimit dhe mundësive në bazë të perspektivës gjinore nëpërmjet prioritet 3 "promovimi i punësimit, lëvizja e fuqisë punëtore dhe përfshirja sociale", por perspektiva dhe barazia gjinore duhet të trajtohen edhe nëpërmjet 2 prioriteteve të tjera të programit, në aspektin e pjesëmarrjes dhe kontributit të balancuar.

Projektet e përgatitur në bazë të qasjes së Zhvillimit të Bazuar në Zonë (ZhBZ) për të lehtësuar rritjen e qëndrueshme në zonat gjeografike të përcaktuara në rajonet ndërkufitare në Ballkanin Perëndimor, në zona të veçanta rurale që karakterizohen nga probleme të veçanta zhvillimore komplekse, mund të konsiderohen për financim sipas këtij programi të bashkëpunimit ndërkufitar. Puna përgatitore për qasjen ZhBZ tashmë e kryer në rajonin ndërkufitar që mbulon Malin e Zi dhe Shqipërinë, do të merret në konsideratë.

Financimi i dyfishtë duhet të shmanget dhe duhet të sigurohet plotësimi i aktiviteteve me programet e tjera.

Seksioni 4: Plani Financiar

Tabela 1 tregon sasinë indikative vjetore të kontributit të Bashkimit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar për periudhën 2014-2020. Tabela 2 ofron një shpërndarje indikative për alokimet për secilin prioritet tematik si dhe një indikacion mbi shumën maksimale të bashkëfinancimit të Bashkimit Evropian.

Tabela 1. Alokimet indikative financiare në vit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar 2014-2020

Viti	PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA II_MAL I ZI - SHQIPËRI							Totali (EURO)
	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2014-2020
Operacionet BNK *(të gjitha prioritetet tematike)*	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 190 000	1 700 000	1 700 000	1 530 000	10 710 000
Asistenca Teknike	510 000	0	0	510 000	0	0	170 000	1 190 000
Totali (EURO)	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	**1 700 000**	11 900 000

Tabela 2: Alokimet indikative financiare për prioritet gjatë periudhës 2014-2020 dhe shkalla e kontributit të BE-së

PRIORITETET	PROGRAMI IPA BNK MAL I ZI - SHQIPËRI 2014-2020			
	Kontributi i BE	Bashkëfinancimi i përfituesve	Financimi total	Shkalla e kontributit të BE
	(a)	(b)	(c) = (a)+(b)	(d) = (a)/(c)
1 Nxitja e turizmit dhe e trashëgimisë kulturore dhe natyrore	4 165 000.00	735 000.00	4 900 000.00	85%
2 Mbrojtja e mjedisit, nxitja e përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut	3 570 000.00	630 000.00	4 200 000.00	85%
3 Nxitja e punësimit, lëvizjes gjeografike të punonjësve, dhe përfshirjes sociale dhe kulturore përtej kufirit	2 975 000.00	525 000.00	2 800 000.00	85%
4 –Asistenca Teknike	1 190 000.00	0	1 190 000.00	100 %
GRANTI TOTAL (EURO)	**11 900 000.00**	**1 890 000.00**	**13 790 000.00**	

Kontributi i BE-së është llogaritur në raport me shpenzimet e pranueshme, të cilat bazohen në totalin e shpenzimeve të pranueshme, duke përfshirë shpenzimet publike dhe private. Shkalla e bashkë financimit të BE në nivel të çdo prioriteti tematik nuk duhet të jetë më pak se 20% dhe jo më e lartë se 85% e shpenzimeve të pranueshme.

Bashkëfinancimi i prioriteteve tematike do të sigurohet nga përfituesit e granteve. Përfituesit e grantit duhet të kontribuojnë me një minimum prej 15% të totalit të shpenzimeve të pranueshme.

Shuma e dedikuar për asistencën teknike do të kufizohet në 10% të shumës totale të caktuar për programin. Shkalla e bashkëfinancimit të BE-së do të jetë 100%.

Fondet për prioritetet tematike do të jepen nëpërmjet Vendimeve të Komisionit Zbatues, duke mbuluar alokime një deri në trevjeçare, sipas nevojës. Fondet për asistencën teknike do të jepen nëpërmjet një Vendimi të veçantë të Komisionit Zbatues.

Seksioni 5: Dispozitat zbatuese

Thirrje për projektpropozime:

Si rregull i përgjithshëm, ky program do të zbatohet nëpërmjet nisjes së thirrjeve për propozime (ThpP), të cilat mbulojnë një ose më shumë prioritete tematike apo objektiva specifike të programit BNK. Komiteti i Përbashkët i Monitorimit do të jetë përgjegjës për identifikimin e prioriteteve tematike, objektivave specifikë, përfituesve të synuar dhe të fokusit të veçantë të secilës thirrje për propozime, e cila duhet të miratohen nga Komisioni Evropian.

Autoritetet përgjegjëse në vendet pjesëmarrëse janë duke planifikuar zbatimin e pjesës më të madhe të ndërhyrjeve nëpërmjet skemave të granteve të bazuara në thirrjet publike për propozime. Ato do të sigurojnë transparencë të plotë në procesin dhe aksesin në një gamë të gjerë të subjekteve publike dhe jopublike.

Dinamikat e publikimit të thirrjeve për propozime varen nga një numër faktorësh, duke përfshirë faktorët logjistikë, kohën e vlerësimit dhe nivelin e interesit nga aplikuesit e mundshëm. Pra, nuk mund të përcaktohet në këtë fazë se sa thirrje për propozime do të publikohen gjatë periudhës së programit. Gjithsesi, autoritetet përgjegjëse janë të angazhuara t'i publikojnë thirrjet për propozime në mënyrë të tillë që të shmangin mbivendosjen e prioriteteve tematike midis programeve të ndryshme BNK. Thirrjet për propozime do të realizohen duke përdorur parimin e rotacionit për zgjedhjen e prioriteteve tematike dhe objektivat e tyre specifikë.

Projektet strategjike:

Gjatë përgatitjes së programit, nuk është identifikuar asnjë projekt strategjik që do të financohet jashtë një thirrje për propozime. Megjithatë, gjatë periudhës së zbatimit të programit, autoritetet përgjegjëse mund të konsiderojnë të ndajnë një pjesë të alokimit financiar të programit për një ose më shumë projekte strategjike. Identifikimi i projekteve të tilla do të varet nga fakti nëse të dyja vendet kanë treguar interes specifik për adresimin e prioriteteve strategjike specifike.

Projektet strategjike mund të zgjidhen nëpërmjet thirrjeve për projekte strategjike ose thirrjeve të jashtme për propozime. Në rastin e dytë, partnerët e programit do të identifikojnë së bashku dhe të bien dakord për çdo projekt strategjik që do të miratohet nga KPM në momentin e duhur përgjatë zbatimit të programit. Në këtë rast, pas propozimit dhe aprovimit nga KPM dhe miratimit nga Komisioni, programi BNK duhet të ndryshohet për të përfshirë një projekt të tillë strategjik.

Projektet strategjike janë përcaktuar si ndërhyrje që kanë një ndikim të rëndësishëm ndërkufitar në të gjithë zonën e programit, i cili në mënyrë të pavarur ose në kombinim me projekte të tjera strategjike, kontribuon në një masë të madhe në arritjen e objektivave madhorë në nivel prioritar. Disa kritere të përgjithshme për përzgjedhjen e projekteve strategjike do të jenë: ndikimi në të dyja anët e zonës së programit; lidhja me strategjitë rajonale për zhvillimin e zonave kufitare; niveli i kontributit dhe bashkë financimit nga autoritetet rajonale; numri i popullsisë që përfiton nga ndërhyrja; efektiviteti i kostove të ndërhyrjes; plotësimi i veprimeve paralele, dhe qëndrueshmëria. Për më tepër, këto projekte duhet të kenë një dokumentacion të plotë të tenderit, dhe në rast të investimeve në infrastrukturë, përveç vlerësimeve të nevojshme të ndikimit në mjedis, duhet të kenë edhe të gjitha lejet e nevojshme për vendin dhe ndërtimin.

Strategjitë makro-rajonale:

Duke qenë se të dyja vendet po marrin pjesë në Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit "COM (2014) 357", përkufizimi dhe zhvillimi i projekteve strategjike mund të bëhet në kuadër të fushave prioritare apo temave të identifikuara si në planin e komunikimit, ashtu edhe në planin e veprimit të këtyre strategjive. E njëjta gjë vlen edhe për thirrjen për propozime që mund të dalë në lidhje me fushat prioritare ose temat e strategjisë makro-rajonale ku bën pjesë programi.

ANEKS 1
ANALIZAT E SITUATËS
ANALIZA E SITUATËS

Programi IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri 2014–2020

Përmbajtja
1. HYRJE
2. ANALIZA PESTLE
2.1 Reformat politike dhe procesi i integrimit në BE
Konteksti Ekonomik i Vendit
2.2 KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË ZONËS SË PROGRAMIT
2.2.1 Sektori privat
2.2.2 Tregu i punës
2.2.3 Bujqësia dhe zhvillimi rural
2.2.4 Turizmi
2.3 SOCIALE
2.3.1 Demografia
Dendësia
Minoritetet
Varfëria
2.3.2 Arsimi
2.3.3 Shëndetësia
2.3.4 Kultura
2.3.5 Shoqëria civile
2.4 INFRASTRUKTURA
2.5 MJEDISI
2.6 MARRËVESHJET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE
2.7 KONKLUZIONE
3. ANALIZA SWOT

1. HYRJE

Zona e programit për Programin Ndërkufitar midis Malit të Zi dhe Shqipërisë mbulon një territor prej 11,970 km^2 me një popullsi prej rreth 749.257 banorë. Territori i zonës së programit është disi më i madh në Shqipëri, duke zënë rreth 52.1% kundrejt 47.9% në Mal të Zi. Gjatësia e vijës kufitare ndërmjet dy vendeve është 244 km, nga të cilat 38 km janë kufi ujor i përbërë nga liqeni i Shkodrës, deti Adriatik dhe lumenj. Ka tri pika funksionale të kalimit kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi përgjatë kësaj vije kufitare, të quajtura Murriqan -Sukobinë, Hani i Hotit -Božaj, dhe Vermosh -Gjercan.



Zona e programit në Mal të Zi mbulon një territor prej 5,745 km^2. Ajo përbëhet nga 12 bashki dhe 615 vendbanime - qytete dhe fshatra - me një popullsi të përgjithshme prej 379,366 banorë. Ajo kufizohet me Shqipërinë në lindje, dhe Kosovën dhe Serbinë në verilindje. Mali i Zi ka vendosur ndarjen në rajone që i korrespondojnë klasifikimit NUTS, i cili është miratuar nga EUROSTAT, dhe sipas ndarjes së lartpërmendur, Mali i Zi është një rajon në të tria nivelet e NUTS. Për qëllime të planifikimit strategjik, vendi është i ndarë në tri rajone gjeografike, veriore, qendrore dhe jugore. Bashkitë nga zona e programimit:

- Andrijevica, Berane, Plavë, Guci[1], Petnjica[2] dhe Rožaje;
- Podgorica, kryeqyteti i Malit të Zi, Cetinje dhe Danilovgrad; dhe
- Budva, Ulqin dhe Tivar.

Zona e programit në Shqipëri përfshin rajonet e Lezhës dhe Shkodrës dhe rrethin e Tropojës, me një territor të përgjithshëm prej 6,225 km^2 dhe një popullsi prej 369,891 banorë. Rajoni i Shkodrës ka popullsinë më të madh të përbërë prej 215,347 banorëve, të ndjekur nga Lezha me 134,027 banorë dhe rrethi i Tropojës me vetëm 20.517 banorë. Shqipëria ka një ndarje administrative ekuivalente me NUTS II [3], por akoma nuk është zbatuar.

Tabela 1. Zona e mbuluar nga zona e programit

Shteti	Zona në km^2	% e territorit të përgjithshëm
Mali i Zi	**13,812**	**100**
Rozaje	432	3.12
Berane*	544	3.

[1] Gucia është një bashki e re, e paraqitur si një ndarje administrative e Komunës së Plavës; ajo është në fazat e hershme të organizimit

[2] Petnjica është një bashki e re, e paraqitur si një ndarje administrative e Komunës së Beranes; ajo është në fazat e hershme të organizimit; Edhe Gucia është një komunë e themeluar rishtazi.

[3] Shqipëria ka 12 rajone të cilat përfshijnë 36 rrethe, 64 bashki dhe 309 komuna, të cilat përmbajnë një numër të përgjithshëm prej 74 qytetesh dhe 2980 fshatrash. Rajonet e kësaj zone të programit janë të ndarë në 7 rrethe të përbërë nga 11 bashki, 54 komuna, të cilat përmbajnë 16 qytete dhe 484 fshatra

		94
Petnjica	173	1.25
Andrijevica	283	2.04
Plava	329	2.38
Gucia**	157	1.13
Danilovgrad	501	3.62
Podgorica	1,441	10.43
Tivar	598	4.32
Ulqin	255	1.84
Cetinja	910	6.58
Budva	122	0.88
Gjithsej Mali i Zi	**5,745**	**41.59**
Shqipëria	**28,748**	**100**
Shkodra	3,562	12.39
Lezha	1,620	5.63
Tropoja	1,043	3.62
Gjithsej Shqipëria	**6,225**	**21.6**
Zona e përgjithshme e programit	**11,970**	**MNE: 47.9 % AL: 52.1 %**

***** Të dhëna nga http://www.trpezi.eu/BIHOR%20I%20STUDIJA.html
** Të dhëna nga http://www.plav.me/uploads/dokumenta/odluke/GUSINJE%20-%20studija.pdf

Në përgjithësi, zona e programit ka 23 komuna dhe një total prej 1.114 vendbanimeve - qytete dhe fshatra. Shtatë komuna ndodhen direkt në kufi: Plavë, Andrijevica, Podgoricë, Gucia dhe Ulqini në Mal të Zi, dhe Shkodër dhe Koplik në Shqipëri. Vija kufitare kalon nëpër vargjet malore të lartë të Prokletije/Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare) dhe liqenin e Shkodrës, për të përfunduar në detin Adriatik. Pikat e kalimit kufitar, veçanërisht ato të Sukobinë - Muriqan dhe Bozaj - Hani i Hotit, janë lehtësisht të arritshme gjatë gjithë vitit, ndërsa në pikën e kalimit kufitar Vermosh-Gercan janë duke u bërë përmirësime në infrastrukturën rrugore të saj, pasi ndodhet në lartësi të madhe, duke e bërë të vështirë kalimin e saj gjatë dimrit.

Zona e programit në **Mal të Zi** karakterizohet nga një profil gjeografik dhe klimatik i ndryshëm, i mbushur me vargje malore, fusha, lugina, lumenj, laguna dhe liqene. Zona e programit përmban disa parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe peizazhe që pasqyrojnë biodiversitet të pasur dhe dallimet mjedisore. Pjesa kontinentale ose veriore e rajonit është një zonë malore. Majat malore arrijnë deri në

2.500 m lartësi, dhe territori përshkohet nga lumenj, si lumi Lim, Morava dhe Tara, duke formuar kanione dhe lugina mbresëlënëse. Në lindje rajoni është i dominuar nga malet Prokletije dhe Hajla, ngjitur me Shqipërinë. Prokletije është shënuar si një Park Kombëtar që nga viti 2009. Komunat bregdetare të Tivarit dhe Ulqinit ndjekin traditën e kultivimit të agrumeve dhe ullinjve, si dhe atë të prodhimit të vajit të ullirit.

Zona e programit në **Shqipëri** paraqet kontraste të mprehta, pasi alternon male, kodra, lumenj, liqene dhe bregdet, shumë afër me njëri-tjetrin. Në këtë zonë kalumenj të shumtë që kalojnë nëpër territor, të cilët shpesh shkaktojnë përmbytje gjatë stinëve me reshje. Zona shtrihet

nga malet e larta (Alpet Shqiptare) në pjesën veriore të saj në kufi me Malin e Zi, deri në bregdet (Velipojë dhe Shëngjin), në pjesën veriperëndimore të Shqipërisë. Maja më e lartë është Jezerca me 2,694 m lartësi, në rajonin e Shkodrës, dhe ajo më e ulëta (-6m) ndodhet në rajonin e Lezhës. Në territorin e rajonit të Shkodrës mbizotërojnë malet, duke zënë 80% të sipërfaqes; dhe pyjet përbëjnë rreth 30% të saj.

Liqeni i Shkodrës



Tipari më dallues gjeografik dhe mjedisor i zonës së programit është Liqeni i Shkodrës. Ai është liqeni më i madh në Ballkan, me një sipërfaqe prej 384 km^2, të shtrira në Mal të Zi (2/3) dhe Shqipëri (1/3); të dyja vendet e kanë listuar atë si një Park Kombëtar - liqeni është i shënuar edhe si një vend Ramsar. Liqeni është pjesërisht nën nivelin e detit, i cili mbushet nga lumi Moraça dhe derdhet në Adriatik nëpërmjet lumit 41 km të gjatë (Buna), e cila formon kufirin ndërkombëtar në gjysmën e poshtme të gjatësisë së saj. Liqeni përmban një nga rezervatet më të mëdhenj në Evropë, duke pasur 270 specie zogjsh, pjesë e të cilëve janë disa nga pelikanët e fundit në Evropë. Gjithashtu liqeni përmban habitate të pulëbardhave dhe çafkave, si dhe është i bollshëm në peshk, veçanërisht në krap, gjuhëz dhe ngjala. Bashkëpunimi mes dy vendeve në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e liqenit të Shkodrës është rritur në dekadën e fundit.

Rajoni i Shkodrës është gjithashtu i pasur me burime ujore. Drini, Buna, Shala, Cemi, Kiri janë lumenjtë kryesorë që rrjedhin në këtë zonë, me Drinin, i cili është lumi më i rëndësishëm i Shqipërisë - hidrocentralet e ndërtuar në të prodhojnë mbi 60% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në Shqipëri. Lezha ka pjesën e saj të maleve të larta dhe kodrave, të cilat mbulojnë rreth 65% të territorit të saj, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga fushat. Lumenjtë Mat dhe Ishëm, të cilët derdhen në detin Adriatik, së bashku me disa fusha lagunore, e bëjnë rajonin e Lezhës të pasur me burime ujore. Lezha ka një vijë bregdetare 38 km të gjatë, e cila fillon tek Kepi i Rodonit në jug dhe kufizohet me Velipojën-Shkodër në veri. Rrethi i Tropojës dominohet nga malet, me pyje që zënë 62% të territorit të tij të përgjithshëm; duke qenë se përmban liqenin e Fierzës dhe përshkohet nga lumenjtë Drini dhe Valbona, kjo zonë është e pasur me burime ujore.

Zona e Programit ka klimë mesdhetare në zonën e saj bregdetare, me verë dhe vjeshtë të nxehtë dhe të thatë, dhe klimë kontinentale në zonën veriore malore, me dimër relativisht të

ftohtë dhe me reshje dëbore të rënda në brendësi. Elemente të tilla gjeografike me kontrast të lartë pasurojë mjedisin, florën dhe faunën e zonës së programit. Burimet e saj natyrore janë stimuluese për zhvillimin e turizmit dhe agrobiznesit, si stimujt kryesorë ekonomikë për të rritur mundësitë për mirëqenien dhe prosperitetin e banorëve në zonën e programit.

2. ANALIZA PESTLE

2.1 Reformat politike dhe procesi i integrimit në BE

Si Mali i Zi ashtu edhe Shqipëria janë të angazhuar për t'u bërë anëtarë të Bashkimit Evropian. Mali i Zi e ka marrë tashmë statusin e vendit kandidat, ndërsa Shqipëria pret ta marrë atë në qershor të vitit 2014.

Transformimi në demokraci funksionale dhe ekonomi tregu ka qenë baza logjike e proceseve të thella të reformave kombëtare institucionale dhe ristrukturuese në Mal të Zi dhe Shqipëri.

Mali i Zi ka bërë progres për sa i përket përmirësimit të legjislacionit në vend, kuadrit institucional dhe politik, forcimit të funksionimit të parlamentit, sistemit gjyqësor, politikave antikorrupsion, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve[1]. Reformat e vazhdueshme në administratën kushtetuese dhe atë publike duhet të përparojnë akoma më tej. Stabiliteti makroekonomik është ruajtur gjerësisht. Përmirësime të mëtejshme janë bërë në procedurat për hyrjen në treg dhe rimëkëmbjen nga falimentimi, së bashku me reformat e liberalizimit të tregut. Është bërë progres i mirë edhe në fushat e prokurimit publik, politikave të transportit, statistikave, dhe të shkencës dhe kërkimit.

Ristrukturimi i ekonomisë për të siguruar një alokim efikas të burimeve mbetet një sfidë kryesore, së bashku me luftimin e një sektor të madh informal, i cili vazhdon të pengojë mjedisin e biznesit; këto janë rreziqe të mëdha për aftësinë për të ndjekur politikat e duhura makroekonomike për të siguruar se stabiliteti makro-financiar është ruajtur.

Marrëdhëniet me Bashkimin Evropian kanë parë përparim të konsiderueshëm që kur është nënshkruar Partneriteti Evropian për Malin e Zi nga Këshilli i Evropës, më 22 janar 2007. Një vit më pas, më 15 tetor 2007 Mali i Zi nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) dhe një Marrëveshje të Përkohshme mbi tregtinë dhe çështjet e lidhura me të. Kjo e fundit hyri në fuqi në 1 janar 2008, ndërsa MSA hyri në fuqi në 1 maj 2010. Të bindur në përparimin e reformave të tij, Mali i Zi aplikoi për anëtarësim në BE më 15 dhjetor 2008. Pas një viti, në 19 dhjetor 2008, BE-ja hoqi kërkesën e vizave për malazezët që vizitonin shtetet anëtare të saj. Që nga data 17 dhjetor 2010, Mali i Zi ka marrë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE. Bisedimet për negociatat mbi pranimin në BE kanë filluar më 29 qershor 2012 pasi Këshilli miratoi vlerësimin e Komisionit, i cili pranon se Mali i Zi është në përputhje me kriteret për anëtarësim në BE.

Në përgjithësi, Mali i Zi vazhdon të zbatojë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit (MSA) me një ecuri të mirë.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2007 (SKZhQ) e Malit të Zi[2] është një nga dokumentet kryesore të zhvillimit të politikave të vendit. Ajo përcakton pesë qëllimet afatgjata për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm:

Përshpejtimi i rritjes dhe zhvillimit ekonomik dhe reduktimi i pabarazive të zhvillimit rajonal;

- Reduktimi i varfërisë; sigurimi i aksesit të barabartë në shërbime dhe burime;
- Sigurimi i kontrollit efikas të ndotjes dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore;
- Përmirësimi i sistemit të qeverisjes dhe pjesëmarrjes publike; mobilizimi i të gjitha palëve të interesuara dhe ngritja e kapaciteteve në të gjitha nivelet;
- Ruajtja e diversitetit dhe identiteteve kulturore.

Duke njohur progresin e **Shqipërisë** me reformat politike dhe ekonomike, Bashkimi Evropian nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Shqipërinë në qershor të vitit 2006, e cila hyri në fuqi në prill 2009. Shqipëria iu bashkua NATO-s në prill 2009. Liberalizimi i vizave për qytetarët e Shqipërisë për të hyjnë në shtetet e Shengenit hyri në fuqi më 15 dhjetor 2010.

---

[1] Strategjia e zgjerimit të BE-së dhe sfidat kryesore 2012-2013 (faqe 12).

[2] Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Malit të Zi 2007.

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit shënoi një etapë cilësisht të re në marrëdhëniet dypalëshe, duke sjellë detyrime dhe angazhime të reja të rëndësishme për vendin në fushat e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, lëvizjes së lirë të punonjësve, të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të kapitalit dhe shërbimeve, si dhe për transportin, fushën audio-vizuale dhe telekomunikacionit. Në përgjithësi, zbatimi i MSA-së ka vazhduar pa probleme, dhe Shqipëria ka vazhduar përafrimin e legjislacionit të saj me kërkesat e legjislacionit të BE-së në një sërë fushash dhe rritjen e aftësive të saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Përmirësime thelbësore janë bërë në fusha të tilla si reformat e brendshme dhe ekonomike të tregut, rendi publik dhe menaxhimi i kufijve, reformat ligjore dhe administrata publike, prokurimi publik, statistikat, drejtësia, liria dhe siguria, dhe doganat.

Duke parë që Shqipëria arriti përparimin e nevojshëm, Komisioni Evropian rekomandoi në tetor të vitit 2013 që Këshilli Evropian t'i japë Shqipërisë statusin e Vendit Kandidat për në BE[1].

Megjithatë, sfidat kryesore mbesin në përfundimin e reformave në administratën publike dhe sistemin gjyqësor, në mënyrë që të forcohen institucionet e vendit. Zbatimi i reformës së pronës dhe reformës së administratës publike janë gjithashtu të rëndësishme, pasi njëra do t'i hapë rrugën krijimit të tregut të tokës dhe të tjera do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Përfundimi i ristrukturimit ekonomik - privatizimi në shkallë të gjerë dhe ruajtja e stabilitetit makroekonomik, dhe përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit për të tërhequr investimet private të drejtpërdrejta, janë prioritete kyçe për të ardhmen, së bashku me luftën ndaj ekonomisë së madhe informale. Është thelbësore të ruhet vrulli i reformave, veçanërisht duke u përqendruar në zbatimin e legjislacionit të miratuar dhe sigurimin e sundimit të ligjit.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim të Shqipërisë 2014-2020 (SKZHI), konsiderohet si kuadri i politikave gjithëpërfshirëse për vendin në kontekstin e integrimit në BE. Ajo përcakton katër shtyllat e politikës strategjike që përcaktojnë themelet për ndërhyrjet sektoriale dhe të bazuara në vend[2]:

- *Forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës që adreson aspekte si:* sistemi zgjedhor, drejtësia dhe punët e brendshme, të drejtat e njeriut dhe media, qeverisja efektive dhe politikat e jashtme dhe të mbrojtjes;

- *Krijimi i kushteve për zhvillim ekonomik konkurrues dhe të qëndrueshëm* nëpërmjet përdorimit efikas të burimeve që mbulojnë: stabilitetin dhe qëndrueshmërinë makroekonomike, ekonominë konkurruese të tregut, përdorimin efikas të burimeve, zhvillimin e integruar rajonal dhe zhvillimin e qëndrueshëm;

-*Nxitja e përfshirjes sociale, mirëqenies dhe zhvillimit të tregut të punës,* të cilat synojnë të promovojnë: politikat e punësimit dhe përfshirjes sociale, politikat sociale;

- *Zhvillimi i një shoqërie të bazuar në dituri, inovacion dhe teknologji digjitale,* që përfshin ndërhyrjet në fushat në vijim: arsimin e lartë, kërkimin dhe inovacionin, teknologjinë e informacionit dhe komunikimit.

Strategjia Ndërsektoriale e Zhvillimit Rajonal të Shqipërisë dallon zonat kufitare si subjekt të planifikimit të politikave ndërsektoriale dhe i bën çështjet ndërkufitare pjesë të planifikimit të politikave të zhvillimit në nivel qarku.

Konteksti Ekonomik i Vendit

Mali i Zi po përpiqet të sigurojë forcimin ekonomik dhe stabilitetin financiar nëpërmjet konsolidimit fiskal dhe reformave strukturore. Reformat strukturore të Malit të Zi në sektorin publik, sektorin financiar, si dhe në klimën e investimeve, kanë bërë të mundur që vendi të bëjë progres në vitet e fundit në rritjen e të ardhurave për frymë dhe reduktimin e varfërisë, avancimin e reformave strukturore, dhe përgatitjen për anëtarësim në BE. GDP për frymë është 5.063 Euro në vitin 2012[3], pak më e ulët në krahasim me 5.211 euro e regjistruar në vitin 2011, por më e lartë se në gjashtë vendet e tjerë të rajonit.

[1] Një vendim që pritej të merrej në Qershor të vitit 2014.

[2] Draftstrategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014–2020 (SKZHI).

[3] MONSTAT, GDP e Malit të Zi Publikimi nr. 246, shtator 2013.

Ekonomia e Malit të Zi ka hyrë në recesion në vitin 2008, dhe ka filluar të ngrihet pjesërisht në vitin 2010 dhe 2011 me një mesatare prej 2.9%. Megjithatë, rritja ka ndaluar përsëri, pasi GDP-ja ka regjistruar një rritje negative prej 2.5%[1], ndërsa papunësia ka arritur në rreth 19.7% në vitin 2012 nga 16.5% që ishte në vitin 2010[2]. Shtyllat kryesore ekonomike të vendit mbeten turizmi, i ndjekur nga prodhimi, ndërsa sektorë të tjerë si ndërtimi dhe industria janë kontraktuar gjatë vitit 2012. Inflamacioni është rritur nga 0.5% në vitin 2010, në rreth 3.6% në vitin 2012 dhe borxhi publik është rritur nga nën 30% e GDP-së në vitin 2007 në mbi 54% të GDP-së në vitin 2012. Nga ana tjetër, kredia për ekonominë vazhdon të mbetet në nivele shumë të ulëta, ndërkohë që disa banka kanë ndaluar së dhëni hua për sektorin privat.

Sfida kryesore në të ardhmen mbetet fuqizimi i konkurrencës së ekonomisë së Malit të Zi, duke përmirësuar produktivitetin dhe duke tërhequr IHD të tjera në më shumë sektorë sesa vetëm turizmi dhe pasuritë e patundshme. Mjedisi i biznesit do të përmirësohet më tej duke vazhduar luftën ndaj korrupsionit dhe fuqizimin e shtetit ligjor. Hendeku midis ofertës dhe kërkesës së aftësive të punës duhet të tejkalohet duke lejuar vendosjen më të pavarur të pagave në nivel kompanie. Forcimi i financave publike së bashku me reduktimin e ekonomisë informale janë gjithashtu sfida të rëndësishme që duhet përballuar.

Mali i Zi u bë anëtar i plotë i Organizatës Botërore të Tregtisë në prill të vitit 2012. Si vend anëtar i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (PBEJL) që nga data 11 maj 2007, Mali i Zi e ka nënshkruar anëtarësimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) më 26 korrik 2007, dhe gjithashtu ka nënshkruar një marrëveshje të tregtisë së lirë me vendet pjesë të Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA), e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2012.

Shqipëria ka bërë ecje relativisht të mirë gjatë dekadës së fundit. Vendi ka qëndruar larg recesionit, duke ruajtur ritmet pozitive të rritjes, pavarësisht ekspozimit të saj ndaj krizës së vështirë ekonomike, e cila ka goditur Greqinë dhe Italinë, si dhe rrethimit nga ekonomitë rajonale kontraktuese. Rritja e GDP-së së saj është ngadalësuar nga një kulm i normës së rritjes prej 7.5% në vitin 2008, në një normë më të ulët të rritjes prej 1.6% në vitin 2012[3]. Sektori i shërbimeve është kontribuuesi kryesor në GDP, duke përbërë më shumë se gjysmën e GDP-së së vendit. Shqipëria cilësohet si një vend me të ardhura të ulëta deri në mesatare me një GDP për frymë, e cila në vitin 2012 qëndron në 3.415 euro[4]. Shkalla e papunësisë me një mesatare prej 13% është ndër më të ulëtat në rajon. Borxhi publik i përgjithshëm i Shqipërisë ka arritur në 60.6% të GDP-së deri në fund të vitit 2012[5]. Ekonomia mbetet e brishtë për shkak të dobësive të brendshme strukturore dhe paqëndrueshmërisë ekonomike globale.

Sfida kryesore në të ardhmen mbetet sigurimi i rritjes së qëndrueshme afatgjatë, duke ndjekur politika të matura fiskale dhe monetare dhe reformat strukturore. Shqipëria duhet të punojë për reduktimin e niveleve të larta të deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Ajo duhet të përmirësojë parashikimin fiskal duke hequr dorë nga mbivlerësimi i të ardhurave dhe duke përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme përputhjen e taksave. Përmirësimi i mëtejshëm i mjedisit të biznesit dhe investimeve është thelbësor për diversifikimin e ekonomisë dhe nxitjen e potencialit të saj të rritjes afatgjatë. Përforcimi i shtetit ligjor, lufta kundër korrupsionit dhe adresimi i detyrimeve të pashlyera, si dhe zhvillimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor, janë fushat kryesore ku duhet të përqendrohen shumë përpjekje. Reduktimi i ekonomisë gri mbetet një sfidë e rëndësishme.

Shqipëria ka Marrëveshje për Tregti të Lirë me të gjitha vendet e rajonit, duke përfshirë Malin e Zi, dhe është anëtare e CEFTA-s që nga viti 2006.

2.2 KARAKTERISTIKAT EKONOMIKE TË ZONËS SË PROGRAMIT

[1] MONSTAT, GDP e Malit të Zi, Publikimi nr. 246, shtator 2013.
[2] MONSTAT, Sondazhi i Fuqisë Punëtore 2012.
[3] INSTAT, GDP tremujore 2012.
[4] Banka Botërore, Të dhënat e shtetit 2008–2012.
[5] Ministria e Financave, 2012.

Zona e programit përmban të gjitha pabarazitë rajonale të hasura në **Mal të Zi** në drejtim të zhvillimeve social-ekonomike. Ashtu si në nivel kombëtar, ajo është e dominuar nga Podgorica, e cili është motori ekonomik i vendit. Strategjia e Zhvillimit Rajonal të Malit të Zi 2010-2014 ofron një pasqyrë të qartë të situatës social-ekonomike në zonën e programit nëpërmjet indeksit të saj të zhvillimit, e cila veçon vetëm bashkitë e Budvës dhe Podgoricës me një nivel zhvillimi mbi mesataren kombëtare. Çdo bashki e zonës së programit është nën mesataren kombëtare, me Bashkinë e Plavës në krye që është më pak e zhvilluara në vend. Ndryshe nga Budva, e cila ka indeksin më të lartë të zhvillimit në Mal të Zi, përkatësisht 362.4, dy bashkitë e tjera bregdetare të zonës së programit, Tivari dhe Ulqini, janë nën mesataren kombëtare.

Grafiku 1. Indeksi i Zhvillimit Rajonale, Mal i Zi




Rajoni verior, relativisht i industrializuar në kohën e Jugosllavisë, është përballur me një rënie të madhe ekonomike. I gjithë rajoni verior kontribuon në GDP-në kombëtare me vetëm 18%[1], ndërsa papunësia mesatare dhe niveli i varfërisë janë dukshëm më të larta sesa në rajonet qendrore dhe bregdetare. Kjo situatë mund të çojë në një rrallim të vazhdueshëm të popullsisë së këtij rajoni, i cili mund të pengojë planet e mëtejshme të zhvillimit. Megjithatë, rajoni ka burime të vlefshme, të cilat janë të lidhura kryesisht me mjedisin e tij unik. Veçanërisht, ky është rasti për sektorët e bujqësisë dhe pyjeve, për prodhimin e energjisë së rinovueshme, dhe për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit malor dhe ekoturizmit. Veprimtaritë e vogla prodhuese, kryesisht të lidhura me përpunimin e ushqimit (mish, fruta dhe perime) dhe përpunimin e drurit po rimarrin zhvillim, dhe shumë përpjekje i janë kushtuar zhvillimit të produkteve të reja të turizmit.

Duke pasur një pozitë qendrore, Bashkia e Podgoricës është e përqendruar në ofrimin e shërbimeve dhe industritë. Gjithashtu, ajo përfiton edhe nga toka dhe kushtet e favorshme klimatike për zhvillimin e bujqësisë intensive. Pavarësisht nga aktivitetet që lidhen me portin e Tivarit, rajoni bregdetar është shumë i varur nga turizmi dhe aktivitetet përkatëse. Në aspektin e infrastrukturës së turizmit, Ulqini dhe Tivari janë ende larg nga të qenit në nivel të bashkive të tjera të bregdetit Adriatik të Malit të Zi.

Në **Shqipëri** pabarazitë rajonale janë gjithashtu të dukshme. Zhvillimi social-ekonomik i vendit anon shumë në favor të rajonit qendror. Rajoni i Tiranës kontribuon me më shumë se një të tretën e GDP-së së vendit, dhe është deri tani rajoni më i zhvilluar në krahasim me të gjitha rajonet e tjera të Shqipërisë. Kjo tregon qartë se të gjitha rajonet e tjera janë nën potencialin e tyre të zhvillimit, pasi i duhet të gjejnë rrugë dhe mundësi për të përfituar nga avantazhet e tyre krahasuese. Rajonet Shkodër dhe Lezhë pasqyrojnë gjerësisht këto pengesa për sa i përket zhvillimit social-ekonomik.

[1] Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Malit të Zi.

Shkodra është rajoni më i zhvilluar në zonën e programit të Shqipërisë. Kontributi i Qarkut të Shkodrës NË GDP- në e vitit 2011[1] arriti në 555 milionë euro, pra 6.1% të GDP-së së përgjithshme të vendit, duke u renditur e shtata ndër 12 qarqet e Shqipërisë. Kontribuuesi kryesor në aktivitetin ekonomik në rajonin e Shkodrës të jetë rreth 26% në GDP-në e rajonit, pasuar nga tkontributi i përbashkët i të cilave në vitin 2011 është 23% në GDP-në e rajonit. Kontributi i sektorit financiar dhe i pasurive të patundshme arrin në 19%, pasuar nga shërbimet e tjera që llogaritet të kontribuojnë me 13% të GDP-së rajonale. Kontributi i industrisë në ekonominë e rajonit është 11%, e ngjashme me mesataren kombëtare, e cila vlerësohet të jetë 11.2%. Sektori me nivelin më të ulët të kontributit në ekonominë e rajonit të Shkodrës është ndërtimi, i cili përbën 8% të GDP-së së rajonit.



Grafiku 2. Kontributi rajonal në GDP në %, Shqipëria

GDP e qarkut të Lezhës për vitin 2011 llogaritet me 334 milionë Euro ose rreth 3.7% të GDP-së së vendit[2]. Kontribuuesit kryesorë në GDP-në e qarkut të Lezhës janë tregtia, hotelet, transporti dhe komunikimi, që kontribuojnë me 26%, dhe sektori i bujqësisë që kontribuon me 25%. Kontributi i sektorit financiar dhe i pasurive të patundshme arrin në 19%, pasuar nga shërbimet e tjera që kontribuojnë me 13% të GDP-së rajonit. Kontributi i sektorit të ndërtimit është vlerësuar me 10%, nën mesataren kombëtare të vlerësuar me 12.8%, ndërkohë që industria është kontribuuesi më i vogël për ekonominë e qarkut të Lezhës , duke zënë 8% të GDP-së në vitin 2011.

Kontributi i qarkut të Kukësit në GDP-në e Shqipërisë, ku Tropoja përbën 24% të popullsisë, është më i ulëti në vend me vetëm 2.4%; sektorët më të rëndësishëm janë bujqësia, e cila është përgjegjëse për 34%, dhe tregtia, hotelet dhe turizmi me 20%.

Përveç sektorit të shërbimeve, i cili është kontribuuesi kryesor në GDP-në e vendit, sektori i bujqësisë ka një rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik dhe punësimin në zonën e programit, pasi pavarësisht lëvizjeve të mëdha drejt zonave urbane të regjistruara nga Censusi i fundit në vitit 2011, një pjesë e madhe e popullsisë ende jeton në zonat rurale.

2.2.1 Sektori Privat

Struktura e operatorëve ekonomikë në zonën e programit mbizotërohet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. NVM-të në Mal të Zi përbëjnë 98.6% të numrit të përgjithshëm të operatorëve ekonomikë, ndërsa në Shqipëri ato përbëjnë 95.4% të totalit. Shumica e NVM-ve në të dyja anët e kufirit punojnë në sektorin e shërbimeve.


Pjesa më e madhe e operatorëve ekonomikë të **Malit të Zi** janë të përqendruar në zonën e programit, e cila ka një total prej 14,215 ndërmarrjesh[3], që përbëjnë 67.3% të numrit të


[1] INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013
[2] INSTAT, Llogaritë Rajonale 2013
[3] MONSTAT, Regjistri i Bizneseve, Numri dhe struktura e subjekteve të biznesit 2011.

përgjithshëm të ndërmarrjeve në nivel kombëtar. Rreth 49.2% e këtyre NVM-ve janë të vendosura në Podgoricë, duke treguar pabarazitë e zhvillimit rajonal. Komuna të tjera të rëndësishme në zonën e programit janë Budva me 16% dhe Tivari me 14.5% të NVM-ve të zonës së programit. Andrijevica dhe Plava janë dy komunat me numrin më të vogël të ndërmarrjeve me më pak se 1% të numrit të përgjithshëm. Rreth 83% e totalit të 34 ndërmarrjeve që kanë më shumë se 250 punonjës janë të vendosura në Podgoricë. Niveli i femrave që zotërojnë një biznes në zonën e programit është mjaft modest, më i ulët se 9.5%; ai është pak më i ulët se 9.6% që është mesatarja kombëtare.

Forcimi i mekanizmave mbështetës të biznesit mbetet një sfidë. Dhomat e Tregtisë së Malit të Zi kanë ende një aktivitet të kufizuar në ofrimin e mbështetjes dhe këshillave për sipërmarrësit. Ekzistojnë 2 inkubatorë biznesi në zonën e programit, një në Podgoricë nën mbikëqyrjen e Drejtorisë për Zhvillimin e NVM-ve (SMEDA) që mbulon Podgoricën dhe Tivarin, dhe një tjetër në Berane.

Grafiku 3. NVM-të sipas sektorëve kryesorë ekonomikë në zonën e programit Mal i Zi Shqipëri





Në **Shqipëri** zona e programit regjistron një total prej 10,174 ndërmarrjesh[1] në fund të vitit 2012, ose rreth 9.7% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të vendit. Ajo ka një shkallë lindje prej 13%[2], më e lartë në krahasim me mesataren kombëtare prej 12.2%, e ndikuar kryesisht nga Shkodra, e cila me 14.1% tregon një zhvillim relativisht më të lartë të aktivitetit ekonomik, në të kundërt me rajonin e Lezhës dhe rrethin e Tropojës, të cilat kanë një përqindje më të ulët krahasuar me mesataren në nivel kombëtar, vetëm 10.8%.

Operatorët ekonomikë në rajonet e Shkodrës, Lezhës si dhe në rrethin e Tropojës, janë jashtëzakonisht shumë të fragmentuar dhe të vegjël në madhësi, duke pasqyruar strukturën e ndërmarrjeve në nivel kombëtar, dhe duke treguar se biznesi është kryesisht familjar dhe mbizotëron vetëpunësimi. Struktura e ndërmarrjeve është e dominuar nga ndërmarrje shumë të vogla, me 1–4 persona të punësuar, të cilat përbëjnë 85.7% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve në zonën e programit. Megjithatë, kjo vlerë është nën mesataren kombëtare, e cila i përllogarit NVM-të me 1–4 persona të punësuar në rreth 90.2% në vitin 2012. Aktiviteti ekonomik menaxhohet kryesisht nga meshkujt, dhe numri i femrave menaxhuese në zonat përfituese është nën mesataren kombëtare prej 27.4% - më e larta në Shkodër në vlerën 25.1%, e ndjekur nga Lezha me 24.7%, dhe më pas nga Tropoja, që regjistron nivelin më të ulët në Shqipëri me 14.2%.

Përveç përmasave të vogla të ndërmarrjeve, një faktor i rëndësishëm që përbën pengesë për zhvillimin ekonomik në zonën e programit në të dyja anët e kufirit është mungesa e njohurive

[1] INSTAT, Regjistri Statistikor i Biznesit të Ndërmarrjeve 2012.

[2] Numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara për një vit të caktuar e shprehur në % mbi numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve.

teknologjike dhe aftësive të punës. Kjo mbetet një sfidë themelore, sepse kërkesa e tregut për shërbime dhe produkte të cilësisë së lartë nuk përputhet me aftësitë e papërshtatshme të punonjësve. Ekonomitë më pak të zhvilluara të zonave rurale dhe të largëta nuk janë në gjendje të shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga qytetet më të zhvilluara bregdetare dhe qendrat e mëdha urbane të zonës së programit. Një tjetër sfidë kryesore është aksesi i dobët i NVM-ve në financim; politikat tepër të kujdesshme të kredi-dhënies të miratuara nga institucionet financiare në të dyja vendet janë një pengesë serioze në rritjen e ndërmarrjeve në zonën e programit. Dhomat e Tregtisë, organizatat e biznesit dhe Agjencitë për Zhvillim Rajonal të pranishme në zonën e programit duhet të marrin një rol më proaktiv në promovimin e zhvillimit të bizneseve dhe të bashkëpunimit.

2.2.2 Tregu i punës

Si në Mal të Zi ashtu edhe në Shqipëri, papunësia është relativisht e lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Ajo është ende një problem i madh ekonomik në të dyja anët e zonës së programit, dhe karakterizohet nga dallime të mëdha rajonale.

Në **Mal të Zi** tregu i punës ka pësuar krizë, duke regjistruar një rritje të papunësisë që arriti në 20.45% në vitin 2011[1] duke u ulur në 19.6% në vitin 2012. Zona e programit ka rreth 93.4% të forcës aktive të punës në vend. Të dhënat e censusit tregojnë pabarazitë e zhvillimit rajonal në Mal të Zi me rajonin bregdetar dhe atë qendror duke përparuar më shumë se rajonet më të varfra dhe më pak të zhvilluara pa dalje në det, të cilat ndodhen në veri të vendit. Budva ka nivelin më të ulët të papunësisë me 13.2%, e ndjekur nga të gjitha bashkitë bregdetare dhe ato të rajonit qendror. Nga ana tjetër, bashkitë pa dalje në det të Rozhajës dhe Plavës janë bashkitë më pak të zhvilluara në zonën e programit me një shkallë të lartë papunësie deri në 58.5% dhe 50.4% respektivisht.

Pjesa më e madhe e fuqisë punëtore është e punësuar në sektorin e shërbimeve (76.2%), pasuar nga industria me 18.1%, dhe bujqësia me 5.6% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në nivel kombëtar. Pjesa veriore e Malit të Zi regjistron një shkallë më të lartë të punësimit në bujqësi, me rreth 14.9%, dhe në industri me rreth 21.7%, ndërkohë që punësimi në shërbime llogaritet në 63.3%. Punësimi në shërbime në rajonin bregdetar është rreth 83%, i ndjekur nga industria me 15.1% dhe bujqësia me vetëm 1.9%. Rajoni qendror është më i balancuar dhe më afër normave kombëtare. Deri tani, Podgorica përbën motorin kryesor ekonomik dhe të punësimit të rajonit qendror. Punëdhënësi më i madh në program është sektori i tregtisë me 20.5%, i ndjekur nga administrata publike me 12.5%. Rreth 55.9% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve janë meshkuj, ndërkohë që femrat përbëjnë pjesën e mbetur prej 44.1 %.

Fuqia e përgjithshme punëtore në Shqipëri arrin në 1,117,082 persona në fund të muajit dhjetor 2012[2]. Ajo nuk ka pasur ndryshime të mëdha, pavarësisht nga ngadalësimi ekonomik gjatë 2-3 viteve të fundit. Shkalla e përgjithshme e punësimit[3] në Shqipëri gjatë vitit 2012 arriti në 56.4 %, ndërkohë që shkalla e përgjithshme e papunësisë[4] ka mbetur në 13.9%, njëlloj si në vitin 2011. Papunësia në rajonet e Shkodrës dhe Lezhës pasqyron të njëjtën normë mesatare të papunësisë si në nivel kombëtar, dhe gjithashtu të njëjtën strukturë punësimi. Rrethi i Tropojës ruan të njëjtën strukturë të punësimit duke regjistruar nivele të larta të papunësisë. Në fund të vitit 2012, numri i të papunëve në Shkodër qëndron në 19,417 persona, duke përbërë 13.6% të totalit të të papunëve; Lezha me 15,021 persona të papunë përbën 10.6% të totalit; ndërsa

[1] Census i Malit të Zi 2011.

[2] INSTAT, Buletini Tremujor i Statistikave nr. 2, 2013.

[3] Shkalla e punësimit përfaqëson përqindjen e personave të punësuar në raport me popullsinë e përgjithshme aktive të moshës 15 vjeç e lart.

[4] Norma e papunësisë përfaqëson përqindjen e personave të papunësuar në raport me popullsinë e përgjithshme aktive.

Tropoja regjistron 2,368 të papunë, ose rreth 36% të forcave të përgjithshme të punës që i përkasin grup-moshës 15-64 vjeç në rrethin e Tropojës. Papunësia është më e pranishme në zonat urbane, pasi ata që jetojnë në zonat rurale janë konsideruar si të vetë-punësuar.

Fuqia punëtore në Shqipëri dhe në zonën e programit është e dominuar nga grup-mosha 25-54 vjeç, e cila përbën 66.5% të fuqisë së përgjithshme punëtore. Më shumë se 54% e punësimit të përgjithshëm është në sektorin e bujqësisë, ndërsa punësimi në sektorin privat jobujqësor qëndron në 28.7%.

Punësimi në sektorin privat jobujqësor dominohet nga sektori i shërbimeve (tregti, hotele, transport), e cila përbën 55.6% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në sektorin privat, e ndjekur nga punësimi në sektorin e ndërtimit, i cili përbën 22.2%. Punësimi në prodhim qëndron në 17.2%, ndërsa në sektorin e energjisë shkon deri në 5% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në sektorin privat.

Duhet të theksohet se në të dyja vendet, një numër i konsiderueshëm personash punojnë jashtë vendit dhe janë shumë aktivë në ofrimin e ndihmës për familjet e tyre. Pra, dërgesat e emigrantëve luajnë një rol të rëndësishëm në subvencionimin e të ardhurave dhe konsumin vendor.

2.2.3 Bujqësia dhe Zhvillimi rural

Pjesa Malazeze e zonës së programit është më e pasur në burime bujqësore dhe ka më shumë potencial në këtë sektor në krahasim me pjesën e Shqipërisë. Megjithatë, sektori i bujqësisë dhe zhvillimi i tij është po aq i rëndësishëm për të gjithë zonën e programit, veçanërisht për shkak të pjesës së madhe të popullsisë që jeton në zonën rurale, ku bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik. Një tipar i përbashkët në zonën e programit është produktiviteti dhe konkurrenca e ulët në fushën e bujqësisë. Ai vjen si pasojë e: fermave të vogla të cilat kanë prodhim dhe fitim të kufizuar; prodhimit kryesisht për të mbuluar nevojat e jetesës, sesa për shitje direkte në tregjet e gjelbra; dhe nivelit të ulët të finalizimit të produkteve bujqësore dhe industrisë ushqimore të pazhvilluar.

Zona e programit mbulon rreth 38% të totalit të tokës bujqësore të **Malit të Zi**. Punësimi në bujqësi është raportuar të jetë rreth 2.5% e totalit të të punësuarve[1], Podgorica është rajoni kryesor fushor në Mal të Zi – vetëm ajo zë rreth 31.5% të tokës bujqësore në zonën e programit. Ajo ofron kushte optimale për prodhim të larmishëm: perime, prodhimin e drithërave, blegtori, fruta dhe verë. Vera, e cila është produkti kryesor Malazez i orientuar drejt eksportit, prodhohet në Podgoricë - rreth 80% e prodhimit të përgjithshëm të verës në vend. Bashkitë e tjera të ndodhura në zonën qendrore, si Berane dhe Danilovgrad janë prodhuesit kryesorë të mollëve, kumbullave dhe dardhave. Bashkitë në zonën bregdetare të cilat kanë aktivitet të veçantë bujqësor janë të Ulqini dhe Tivari. Rajoni bregdetar është veçanërisht i përshtatshëm për frutat subtropikale dhe prodhimin e ullirit. Më shumë se 80% e pemëve agrume në Mal të Zi janë në Ulqin (65%) dhe Tivar. Këto dy bashki (Tivar dhe Ulqin) janë edhe prodhuesit më të mëdhenj të vajit të ullirit - me 47% të prodhimit të përgjithshëm të vajit të ullirit në Mal të Zi. Ndërkohë që prodhimi i vajit të ullirit mban një potencial të madh për zhvillim, relievi kodrinor i zonës bregdetare dhe rajonit përreth liqenit të Shkodrës është, gjithashtu, i pasur me bimë mjalti dhe bimë mjekësore, dhe është i përshtatshëm për blegtori.

Zona e programit në **Shqipëri** mbulon rreth 3.2% të sipërfaqes së përgjithshme të tokës së vendit[2]. Pjesa më e madhe e territorit të saj është e dominuar nga pyjet, kullotat (80%), ndërsa pjesa e tokës në shfrytëzim për qëllime bujqësore është vetëm 14.8% ose 92,748 ha. Terreni është kryesisht malor dhe i thyer, i cili kufizon në mënyrë të konsiderueshme zonat ku potenciali bujqësor mund të mbajë disa domethënie krahasuese. Zona të tilla janë të vendosura kryesisht në rrethinat e liqenit të Shkodrës, ku terreni dhe kushtet klimatike janë të favorshme për bujqësinë e perimeve. Qarku i Lezhës ka një traditë për blegtorinë e derrave, pasi ajo ka 91.7% të inventarit

[1] Industria dhe punësimi i popullsisë në Mal të Zi – Census 2011 MONSTAT, publikimi nr. 197.

[2] Libri statistikor, Ministria e Bujqësisë.

total të shtetit. Prodhimi bujqësor në rrethin e Tropojës është i orientuar kryesisht drejt prodhimit të thekrës, dhe zona është e famshme për pyjet me gështenja.

Pavarësisht se zona e programit është e pasur me burime ujore, vetëm 32% e tokës bujqësore në zonë ujitet, duke treguar nivelin e ulët të zhvillimit në sektorin e bujqësisë. Bujqësia në zonën e programit është një aktivitet familjar, i orientuar drejt nevojave për jetesë, me toka shumë të fragmentuara - madhësia e fermës është 1.1 ha në Shkodër; 0.89 ha në Lezhë, dhe 0.60 ha në Tropojë, madhësi të cilat janë sa gjysma e mesatares Shqiptare, prej 1.20 ha.

Përmirësimi i mëtejshëm i aksesit në treg, infrastruktura rurale, dhe menaxhimi më i mirë i burimeve ujore mund të jenë prioritetet e ardhshme në zonën e programit. Modernizimi i bujqësisë, përmirësimi i proceseve të prodhimit dhe vendosja e standardeve të sigurisë ushqimore në përputhje me standardet e BE-së, si dhe rritja e prodhimit tradicional bujqësor, janë sfida për t'u përballuar në zonën e programit. Iniciativat ndërkufitare mund të mbështesin dhe promovojnë: i. diversifikimin e aktiviteteve rurale (p.sh. akomodimi i turistëve në ferma); ii. aksesin në tregje dhe zhvillimin e prodhimit dhe marketingut të produkteve ushqimore organike; iii. mbrojtjen (p.sh. mbrojtja e emërtimit të origjinës) dhe tregtimin e produkteve tradicionale bujqësore dhe agroushqimore; dhe iv. bashkëpunimin midis prodhuesve. Mund të konsiderohet përkrahja e përpjekjeve që janë duke u bërë në të dyja vendet për të ndjekur një qasje të integruar që synon promovimin dhe lidhjen e bujqësisë me aktivitete të tjera turistike dhe ekonomike në një paketë, si forma më e përshtatshme e zhvillimit të bujqësisë në zonën e programit.

2.2.4 Turizmi

Rëndësia e turizmit është e ndryshme për ekonomitë e Malit të Zi dhe Shqipërisë. Mali i Zi është tashmë një destinacion i popullarizuar turistik, ndërsa Shqipëria ka ende shumë për të bërë, për t'u bërë një destinacion i tillë.

Në **Mal të Zi**, turizmi është një sektor kryesor i ekonomisë, i cili përbën rreth 9.9% të GDP-së së vendit në vitin 2012, ose rreth 336 milionë euro, që është 20.7% më i lartë se në vitin 2011[1]. Turizmi punëson rreth 12.000 persona, ose 6.9% të punësimit të përgjithshëm në vitin 2012. Ai është sektori më premtues ekonomik në Mal të Zi, dhe pritet që të përbëjë rreth 14.8% të GDP-së së vendit në vitin 2021, veçanërisht në qoftë se përpjekjet për "integrimin e të gjitha rajoneve në një destinacion të vetëm me cilësi të lartë" nën markën "Mali i Zi–Bukuria e Egër"[2] dalin me sukses. Një objektivi i tillë politik synon të sigurojë një zhvillim të përgjithshëm më të ekuilibruar të rajoneve të Malit të Zi, në veçanti në sektorin e turizmit, i cili mbështetet kryesisht në turizmin bregdetar gjatë kohës së verës.

Zona e programit në kufi me Shqipërinë, ofron një shumëllojshmëri të destinacioneve turistike, duke ofruar aktivitete të turizmit bregdetar dhe malor të tilla si noti, ecja në natyrë, çiklizmi, si dhe shijimi i pijes së verës. Rajoni bregdetar në zonën e programit përbën më shumë se 69% të totalit të qëndrimeve me fjetje në vend në vitin 2012[3], kryesisht në periudhën e pushimeve Korrik-Gusht. Bregdeti i zonës së programit tërhoqi rreth 67.5% të totalit prej 1,44 milionë turistësh që hynë në Malin e Zi në vitin 2012. 160 objekte akomoduese bregdetare që gjenden në zonën e programit përbëjnë rreth 49% të totalit të mjediseve akomoduese në Mal të Zi, ndërsa në zonën e programit ndodhen edhe rreth 30% e objekteve akomoduese të zonave jobregdetare të vendit. Ture të verës organizohen në Podgoricë dhe vreshtat e bashkive jugore. Pavarësisht nivelit të ulët aktual të vizitave turistike, rajoni kontinental ka përparësi të shumta për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit të lidhura me sportet malore (ski, ecje, çiklizëm, *rafting* etj.), duke përmendur natyrën e paprekur dhe biodiversitetin e pasur (dy parqe kombëtare, liqene, kanione etj.), jetën autentike rurale, dhe prodhimin tradicional dhe cilësor të ushqimit.

Bashkitë bregdetare në zonën e programit janë gjithashtu të pasura me monumente arkitekturore dhe kulturore nga kohët antike, të cilat i bëjnë këto zona shumë tërheqëse për

[1] Këshilli i udhëtimeve nëpër Botë dhe Turizmit – mars 2013.

[2] Mali i Zi, Strategjia për Zhvillimin e Turizmit deri më 2020-ën.

[3] MONSTAT – Mbërritjet turistike dhe qëndrimet me fjetje sipas qyteteve 2012.

turistët. Tivari është një qytet-port i njohur edhe për shumë monumente të rëndësishme historike dhe kulturore.

Sektori i turizmit është më pak i rëndësishëm në pjesën **shqiptare** të zonës së programit, në krahasim me anën malazeze. Zona e programit ka një natyrë të gjerë, me potencial për turizëm kulturor dhe historik, për mbetet e pashfrytëzuar në një masë të madhe. Ajo ka një vijë bregdetare 50 km të gjatë (12 km Velipojë–Shkodër dhe 38 km Lezha), e përshtatshme për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit bregdetar. Përmirësimet e kohëve të fundit në infrastrukturën rrugore e kanë bërë këtë bregdet lehtësisht të arritshëm, veçanërisht nga turistët nga Kosova dhe Maqedonia. Strukturat ekzistuese pritëse, kryesisht në pronësi private, kanë vështirësi për të përballuar numrin në rritje të turistëve, veçanërisht në Shëngjin-Lezhë. Rrethi i Tropojës, edhe pse ka potencial të konsiderueshëm për turizmin malor dhe sportet (ski, ecje, çiklizëm etj.), natyrë të paprekur dhe biodiversitet të pasur (të parkut kombëtar të Luginës së Valbonës, "Bjeshkët e Nemuna" dhe "Bjeshkët e Doberdolit, të cilat kanë liqene akullnajore"), dhe jetë autentike rurale, ofron shumë pak në drejtim të strukturave pritëse. Pavarësisht përmirësimeve gjatë viteve të fundit, infrastruktura e turizmit mbetet e pazhvilluar sa duhet, dhe potenciali ekzistues i pasur me burime natyrore dhe kulturore ende duhet të shpaloset.

Rajonet e Shkodrës dhe Lezhës, si dhe rrethi i Tropojës kanë potencial të lartë individual për zhvillimin e një turizmi përgjatë gjithë vitit. Natyra atraktive dhe panoramat e natyrës malore dhe kodrinore, si dhe liqeni i Shkodrës, lugina e Valbonës në Tropojë dhe parqet e tjera kombëtare, dhe zonat e mbrojtura; vizitat turistike (peizazhet natyrore, speciet e rralla etj.); agroturizmi, vendet me interes historik dhe kulturor, të tilla si vendbanimet parahistorike, qendrat arkeologjike, objektet e kultit, duhet të promovohen më mirë për një zhvillim më të shpejtë të turizmit në bregdetin e Shkodrës (Velipojë), dhe kryesisht në Lezhë (Shëngjin).

2.3 SOCIALE

2.3.1 Demografia

Si në Shqipëri, ashtu edhe në Malin e Zi, gjatë vitit 2011 u realizua një census. Ndërkohë, që popullsia e regjistruar në Malin e Zi tregoi ndryshime të papërfillshme, popullsia e regjistruar në Shqipëri ka rënë me 8.8% në vitin 2011 krahasuar me censusin e vitit 2001.

Tabela 2. Popullsia dhe dendësia në zonën e programit

	Banorë	Dendësia banorë/km^2
Mali i Zi	**620,029**	**44.89**
Zona e përgjithshme e Programit	**379,366**	**65.69**
Rozaje, Berane, Andrijevica, Plavë, Danilovgrad, Podgoricë, Bar, Ulqin, Cetinje, Budva, Petnjica, Guci	**379,366**	**65.69**
Shqipëria	**2,800,138**	**97.40**
Zona e përgjithshme e programit	**369,891**	**59.4**
Rajoni Shkodër	215,347	60.46
Rajoni Lezhë	134,027	82.70
Qarku Tropojë	20,517	19

Popullsia që jeton në zonën e programit llogaritet të përbëjë rreth 61% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, dhe 13.2% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Popullsia në zonën e programit është e balancuar, e përbërë nga popullsi e Malit të Zi prej rreth 379,366 banorësh, duke zënë 50.63% të popullsisë totale në zonën e programit, dhe popullsi shqiptare prej rreth 369,891 banorësh, duke zënë 49.37% të popullsisë totale në zonë. Në pjesën malazeze dendësia e popullsisë me 65.7 banorë/km^2 është më e lartë se mesatarja kombëtare prej 45

banorësh/km^2, ndërsa në Shqipëri është 59 banorë/km^2, më e ulët në krahasim me mesataren kombëtare prej 97 banorësh/km^2. Podgorica, Berane, Petnjica Tivari dhe Rozaja janë qytetet kryesore në Mal të Zi, ndërsa Shkodra dhe Lezha janë qendrat më të rëndësishme urbane në zonën e programit në Shqipëri.


Popullsia e përgjithshme në zonën e programit në **Mal të Zi** është 379,366[1] banorë. Zona e programit ka një normë rritje natyrore prej 1.87%, që është nën mesataren kombëtare prej 2.2%; shkalla e vdekshmërisë qëndron në 9.4% e barabartë me mesataren kombëtare. Në **Shqipëri**, numri i përgjithshëm i popullsisë që jeton në zonën e programit është 369,891[2] banorë, ose rreth 13.2% e popullsisë së përgjithshme të vendit. Rajoni i Shkodrës është rajoni i gjashtë më i madh i vendit me një popullsi prej 215,347 banorësh, ose rreth 7.6% e popullsisë së përgjithshme, e ndjekur nga Lezha e cila renditet e dhjeta mes rajoneve të vendit, që numëron një total prej 134,027 banorësh apo 4.7% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë. Rrethi i Tropojës regjistron një popullsi totale prej 20,517 banorësh, e cila përbën 0.07% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë.

Zona e programit në Mal të Zi ka një popullsi kryesisht urbane, duke zënë rreth 52% të popullsisë së saj, e cila është më e ulët, në krahasim me 62% që jetojnë në zonat urbane në nivel kombëtar. Rreth 49% e popullsisë në zonën e programit është e përqendruar në Podgoricë. Nga ana tjetër, Andrijevica ka përqendrimin më të madh të popullsisë rurale, e cila përbëhet nga 79.3%, e pasuar nga Berane dhe Danilovgrad me përkatësisht 67.4% dhe 62%. Gjithashtu, bashkitë Plav dhe Tivar dominohen nga popullsia rurale me 59%, ndërsa të gjitha bashkitë e tjera në zonën e programit janë të dominuara nga popullsi urbane, e cila varion nga 53.7% në Ulqin deri në 84.6% në Cetinjë, e cila shënon përqendrimin më të lartë të popullsisë urbane. Në **Shqipëri** situata është ndryshe, pasi popullsia është kryesisht rurale, me një mesatare prej 53.2%. Këtë mesatare e përcakton rajoni i Shkodrës, pasi popullsia rurale është 55.6% e 119,794 banorëve të tij. Në të kundërt, rajoni i Lezhës ka një dominim të popullsisë urbane, me rreth 53.8% të popullsisë. Ndërsa rrethi i Tropojës ka një popullsi kryesisht rurale, e cila përbën rreth 74% të popullsisë së tij.

Përbërja e popullsisë në zonën e programimit të të dyja vendeve tregon se 50% e popullsisë i takon segmentit moshor 15–49 vjeç.

Grafiku 4. Përbërja e popullsisë sipas grup-moshave në zonën e Programit_Census i vitit 2011

Mali i Zi Shqipëria



Zona e programit në të dyja vendet ka përjetuar flukse të **migrimit të brendshëm**. Lëvizja e popullsisë drejt rajoneve qendrore dhe bregdetare, të cilat janë gjerësisht më të zhvilluara dhe ofrojnë më shumë mundësi, është e pranishme në zonën e programit. Në **Mal të Zi**, këto modele të migrimit të brendshëm, por edhe të jashtëm, kanë ndikuar në disa prej bashkive në zonën e programit, të cilat regjistrojnë një rritje negative të popullsisë, si Andrijevica me -5.5%, e

[1] Monstat Census 2011.
[2] INSTAT Census 2011.

ndjekur nga Danilovgrad me -1.4% dhe Cetinje me -1.2%[1]. Në zonën e programit në **Shqipëri**, edhe pse pjesa më e madhe e popullsisë banon në zonat rurale, përsëri ka ndryshime të dallueshme të popullsisë. Popullsia rurale në Shkodër dhe Lezhë ka rënë respektivisht me 25.3% dhe 42.67%. Nga ana tjetër, popullsia urbane në Shkodër është tkurrur me 0.28% në vitin 2011, ndërkohë që popullsia urbane në Lezhë është rritur me një normë mbresëlënëse prej 49.4%[2], ndërsa në rrethin e Tropojës ka ruajtur një profil të thellë rural.

Dendësia

Dendësia e popullsisë e regjistruar në zonën e programit në Mal të Zi gjithashtu tregon flukset e migrimit të brendshëm dhe të jashtëm nga zonat më pak të zhvilluara apo zonat rurale, drejt zonave urbane dhe më tërheqëse ekonomikisht. Dendësia e popullsisë së Andrijevicës dhe Cetinjës është shumë e ulët, me 18 banorë për km^2, e ndjekur nga Plava me 27 dhe Danilovgrad me 37 banorë për km^2. Nga ana tjetër, bashkia turistike e Budvës ka dendësinë më të lartë të popullsisë me 157 banorë, e ndjekur nga Podgorica me 129 banorë për km^2. Qytetet bregdetare të Ulqinit dhe Tivarit kanë gjithashtu një dendësi të lartë të popullsisë, me përkatësisht 78 dhe 70 banorë për km^2, duke qenë mbi mesataren prej 45 banorësh për km^2 në Mal të Zi. Në zonën Shqiptare të programit, dendësia mesatare e popullsisë është 71 banorë për km^2. Dendësia më e lartë e popullsisë vërehet në rajonin e Lezhës, i cili me 83 banorë për km^2 është më afër me mesataren kombëtare prej 97 banorësh për km^2, e ndjekur nga Shkodra me një dendësi të popullsisë prej 60 banorësh për km^2, ndërsa rrethi i Tropojës regjistron një dendësi shumë të ulët me 19 banorë për km^2. Është njëlloj e rëndësishme si për Malin e Zi ashtu edhe për Shqipërinë që të ndryshojnë ose të frenojnë disi tendencat e migrimit, pasi ato përfaqësojnë një shqetësim dhe një sfidë, veçanërisht kur politikat e zhvillimit mbështeten në turizëm dhe agrobiznes.

Minoritetet

Struktura etnike e zonës së programit ndryshon shumë. Në Mal të Zi ka diversitet të madh në popullsi, pasi shumica e saj është e përbërë nga malazezët dhe serbët, e ndjekur nga boshnjakët dhe shqiptarët. Grupet më të mëdha etnike në zonën e programit në Mal të Zi[3] janë Serbët, të cilët përbëjnë 24.8% të popullsisë. Grupi i dytë më i madh minoritar përbëhet nga boshnjakët me 16.3%, dhe grupi i tretë me përqindje më të lartë i përket shqiptarëve me 10.7%. Në bashkitë bregdetare dhe në Bashkinë e Plavës, shqiptarët përbëjnë një minoritet të fortë, ndërsa në Bashkinë e Ulqinit ata përbëjnë një shumicë prej 70%. Në Shqipëri, prania e grupeve etnike në zonën e programit është e papërfillshme. Shqiptarët etnikë përbëjnë shumicën absolute të popullsisë. Ka vetëm një komunitet shumë të vogël të malazezëve etnikë në Shkodër, duke zënë rreth 0.13%[4] të popullsisë së përgjithshme të rajonit të Shkodrës.

Varfëria

Kufiri absolut i varfërisë në Mal të Zi në vitin 2011 ishte 175,25 Euro për të rritur, duke regjistruar një rritje prej 5 eurosh në krahasim me vitin e kaluar 2010[5]. Vulnerabiliteti i popullsisë së Malit të Zi është rritur kohët e fundit, pasi numri i personave nën vijën e varfërisë ka pësuar një rritje nga 6.6% e popullsisë, deri në rreth 9.3% të popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi, në vitin 2011. Rritja e shkallës së varfërisë është shumë më e theksuar në zonat rurale, mesatarisht 18.4%, ndryshe nga zonat urbane ku arrinte mesatarisht 4.4% në vitin 2011. Pabarazia është rritur në Mal të Zi, pasi koeficienti Gini u rrit nga 24.3% në vitin 2010, në 25.9% në vitin 2011[6].

Pabarazitë rajonale janë të dukshme - varfëria është e përhapur në rajonet veriore (mbi 50% e njerëzve të varfër të vendit jetojnë atje) dhe zvogëlohet ndjeshëm në jug, në rajonet qendrore dhe bregdetare.

---

[1] Mal i Zi, Census 2011.
[2] Shqipëri, Census 2011.
[3] MONSTAT, Census 2011.
[4] INSTAT, Census 2011.
[5] MONSTAT, Analiza e varfërisë në Mal të Zi, në vitin 2011, Publikimi nr. 329.
[6] Banka Botërore, fotografim i programit të vendit.

Kufiri absolut i varfërisë në Shqipëri në vitin 2012 ishte 35.2 euro për të rritur1 Varfëria është rritur në Shqipëri, pasi norma e varfërisë në vitin 2012 arriti në 14.3% kundrejt 12.4% të regjistruar në vitin 2008. Vulnerabiliteti i popullsisë së Shqipërisë u rrit në vitin 2012; numri i regjistruar i personave nën vijën e varfërisë u rrit me 8.4%. Varfëria ekstreme ka arritur në 2.2% në vitin 2012, kundrejt 1.2% të regjistruar në vitin 2008.

Gjatë vitit 2012, rritjet në normat e varfërisë në zonat urbane kanë qenë më të shpejta në krahasim me normën e varfërisë në zonat rurale. Numri i personave të varfër në zonat rurale ka rënë me 11.8%, ndërsa numri i personave të varfër në zonat urbane është rritur ndjeshëm me 36.8% në vitin 2012 krahasuar me vitin 2008. Kjo tregon se popullsia e zonave rurale dhe rajoneve veriore të Shqipërisë ka lëvizur drejt zonave urbane, kryesisht kryeqytetit - Tiranës, dhe në zonat bregdetare - këto të fundit regjistrojnë normën më të lartë të varfërisë në vitin 2012, me një mesatare prej 17.6%.

Rajonet në zonën e programit janë më të varfër në krahasim me mesataren kombëtare të shkallës së varfërisë prej 14.3%. Rajoni i Lezhës regjistron një normë varfërie 17.5%, ndërsa rajoni i Shkodrës është pak më mirë, me një normë varfërie 15.7%. Qarku i Tropojës i përket rajonit më të varfër të Shqipërisë, Kukësit, me një normë varfërie 21.8%. Varfëria është bërë një shqetësim urban, duke treguar një ecuri të ngadaltë të ekonomisë gjatë viteve të fundit, ndërsa ripërtëritja e potencialit urban tashmë të përdorur, është bërë e domosdoshme për të sjellë rritjen ekonomike.

2.3.2 Arsimi

Sistemi arsimor në Mal të Zi ka menaxhim të centralizuar, ndërsa në Shqipëri është i decentralizuar me përgjegjësi të përbashkët ndërmjet pushtetit qendror dhe lokal.

Niveli i pabarabartë arsimor është i pranishëm në zonën e programit, me një rritje të analfabetizmit në zonat e thella. Të rinjtë me arsim të lartë kanë tendencë për t'u larguar drejt rajoneve që ofrojnë më shumë mundësi apo jashtë vendit. Sistemi i arsimit të mesëm është më pak tërheqës dhe i aksesueshëm, veçanërisht për popullsinë e re në zonat rurale të programit. Shkollat private dhe Formimi Profesional janë të pranishme, por nuk janë në gjendje që të përputhen me kërkesat e tregut të punës për punonjës të kualifikuar dhe të aftë, duke përbërë kështu një pengesë për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Dispozitat arsimore në të gjitha nivelet kërkojnë përmirësim, në mënyrë që të plotësojnë nevojat e tregut të punës. Sistemi arsimor në zonën e programit në të dyja vendet kërkon reforma, veçanërisht përvoja praktike mësimore dhe lidhje me sektorin e biznesit. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore është një përparësi e madhe për të dyja qeveritë, në nivel qendror dhe lokal.

Nevojat për arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm janë gjerësisht të mbuluara në zonën e programit të **Malit të Zi**. Mali i Zi ka një mbulim të mirë të territorit me shkollat 9-vjeçare dhe të mesme, duke përfshirë zonat rurale. Zona e programit ka 213 shkolla 9-vjeçare[2] për rreth 44,047 nxënës, dhe 29 shkolla të mesme, të cilat ofrojnë arsimim për rreth 19,881 nxënës. Arsimimi ofrohet në gjuhën malazeze dhe gjithashtu në gjuhën shqipe (në komunat e populluara me shqiptarë etnikë). Numri mesatar i nxënësve për klasë në shkollat 9-vjeçare qëndron në 22.4, ndërsa mesatarja e nxënësve për klasë në shkollat e mesme është 27.7, duke treguar një raport të mirë mësues / nxënës, duke lejuar kështu një proces cilësor të mësimdhënies.

Ekzistojnë 3 Universitete në zonën e programit[3]: Universiteti publik i Malit të Zi me bazë në Podgoricë, i cili ka 20 fakultete dhe 3 institute kërkimore – me degë në Budva dhe Cetinjë; Universiteti Mesdhetar me bazë në Podgoricë; dhe Universiteti "Donja Gorica" (në periferi të Podgoricës). Të tria universitetet kanë pasur një numër të përgjithshëm prej 21,134 studentësh gjatë vitit akademik 2012–2013, ku 86.4% i përkasin universitetit publik të Malit të Zi.

---

[1] Shqipëria, trended e varfërisë, Shtator 2013, INSTAT-Banka Botërore.

[2] MONSTAT, Libri statistikor 2012.

[3] MONSTAT, Deklaratat e Arsimit të Lartë 2012.

Problemet kryesore të sektorit të arsimit në Mal të Zi përfshijnë: nevojën për të përmirësuar infrastrukturën e shkollave; integrimin e pamjaftueshëm të Romëve dhe grupeve të tjera të margjinalizuara në sistemin arsimor; përfshirjen e pamjaftueshme të fëmijëve me nevoja të veçanta; nevojën për të përputhur më mirë kurrikulat me kërkesat e tregut të punës dhe sipërmarrjes; mungesën e burimeve financiare për kërkime shkencore dhe zhvillim.

Mali i Zi shpenzon rreth 0.41% të GDP-së në **Kërkim shkencor dhe Zhvillim**[1]; 58% i përkasin sektorit publik; 27% burojnë nga bizneset private dhe rreth 15% financohen nga projektet e BE dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. 59.4% e studiuesve është e punësuar në arsimin e lartë - pasuar nga sektori i Qeverisë me 32% dhe bizneset me 8%. Kërkimi shkencor dhe Zhvillimi në sektorin jofitimprurës llogaritet për vetëm 0.6%.

Zona e programit në **Shqipëri** ka një mbulim të mirë me institucione të arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm. Ajo ka një total prej 300 shkollash 9-vjeçare, nga të cilat 222 ndodhen në zonat rurale, duke i shërbyer 54,274 nxënësve, ose 62% të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Gjithashtu ka 72 shkolla të mesme për 16,974 nxënës, nga të cilat rreth 33% ndodhen në zonat rurale.

Ekzistojnë 3 shkolla profesionale në Lezhë dhe 9 në Shkodër, të cilat i shërbejnë një numri të përgjithshëm prej 3,330 nxënësish; vetëm 10.5% e këtyre nxënësve vijnë nga zonat rurale. Ekziston një Universitet në Shkodër, i cili përfaqëson ndoshta qendrën më të rëndësishme të zhvillimit intelektual, social dhe kulturor në zonën e programit - Universiteti "Luigj Gurakuqi", i cili ka 6 fakultete. Janë 14,538 studentë[2] të regjistruar në Universitetin e Shkodrës për vitin akademik 2011 - 2012. Ai ka një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Podgoricës që nga viti 2004. Universiteti ka një Qendër Kërkimore të Ujit [3].

Shqipëria shpenzon rreth 0.02% të GDP-së së saj[4] për **Kërkimin shkencor dhe Zhvillimin**, një shifër tepër modeste e cila është përdorur tërësisht në sistemin publik. Shqipëria dhe Mali i Zi kanë nënshkruar një marrëveshje në lidhje me lëvizjen e studiuesve dhe ekspertëve teknik midis universiteteve partnere; ngritjen e qendrave të përbashkëta kërkimore për të studiuar burimet hidrike të lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës; dhe ngritjen e një qendre të përbashkët për studimet e avancuara për rreziqet sizmike në Ballkanin Perëndimor.

Si përfundim, përmirësimi i sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një prioritet i madh për zonën e programit. Programi BNK do të ketë një rol të kufizuar në adresimin e këtyre çështjeve, por mund të mbështesë shkëmbimet midis shkollave dhe qendrave të formimit profesional në zonat kufitare. Prezenca e universiteteve dhe qendrave kërkimore në të dyja anët e zonës së programit është një pasuri për programin BNK dhe një mundësi jo vetëm për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit akademik, por edhe për inicimin e programeve kërkimore në zonën kufitare në sektorë të ndryshëm, të tillë si bujqësia apo turizmi.

2.3.3 Shëndetësia

Organizimi i sistemit shëndetësor në Mal të Zi dhe Shqipëri është i ngjashëm; ai është kryesisht publik me një prani modeste (por në rritje) private, dhe mbulimi territorial është i pajisur siç duhet me shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të **Malit të Zi** shpreh keqardhjen për faktin se "sistemi i kujdesit shëndetësor është përshtatur në një masë të madhe vetëm për ofrimin e shërbimeve kurative" dhe përcakton si prioritet forcimin dhe sistemimin e programeve të parandalimit dhe promovimit të shëndetit. Disa tregues të shëndetit (p.sh. norma e vdekshmërisë foshnjore, shkalla e vdekshmërisë së nënave), tregojnë një përmirësim të rregullt në shëndetin publik në Mal të Zi.

Kujdesi shëndetësor parësor në Mal të Zi ofrohet në nivel bashkie dhe të gjitha bashkitë kanë nga një qendër shëndetësore për kujdesin primar. Që nga miratimi i "modelit të mjekut të

[1] K&Zh në 2011, Zyra Statistikore e Malit të Zi, publikimi nr. 24.
[2] INSTAT, Studentët e regjistruar për secilin universitet 2012.
[3] Ajo ka një lidhje direkte me Universitetin e Podgoricës.
[4] Shqipëri, Buxheti i Shtetit 2012.

zgjedhur" numri i personave të siguruar të regjistruar arrin në 83%. Kujdesi shëndetësor dytësor është gjithashtu mjaft i pranishëm në territorin e zonës së programit. Qendra Klinike në Podgoricë shërben si spital i përgjithshëm për Podgoricën, Danilovgradin dhe Kolashinin, duke ofruar edhe kujdesin shëndetësor terciar për të gjithë Malin e Zi. Përveç kësaj, zona e programit ka edhe 3 spitale të tjerë të përgjithshëm (në Tivar, Beranë, dhe Cetinjë), si dhe 2 qendra shëndetësore në Plavë dhe Rozhajë.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në zonën e programit arrin në 3,331 persona[1], ose rreth 61.9% të fuqisë punëtore të përgjithshme të punësuar në sektorin e shëndetësisë në Mal të Zi.

Ngjashëm me Malin e Zi, kujdesi shëndetësor parësor në **Shqipëri** ofrohet në nivel komune dhe bashkie, ndërsa kujdesi shëndetësor dytësor është i vendosur kryesisht në qendrat më të mëdha urbane. Zona e programit ka një rrjet prej 421 institucionesh shëndetësore[2] në sektorin e kujdesit shëndetësor parësor – 46% prej të cilave ofrojnë shërbime në rajonin e Shkodrës, 37% në rajonin e Lezhës dhe 17% në qarkun e Tropojës. Në zonë gjenden 10 spitale; 6 në Shkodër, 3 në rajonin e Lezhës dhe 1 në qarkun e Tropojës.

Kujdesi shëndetësor dytësor është mjaft i pranishëm në rajonin e zonës së programit me një total prej 10 spitalesh. Rajoni i Shkodrës ka 6 spitale: 1 në Bashkinë Pukë me 11 mjekë, dhe 5 spitale në Shkodër – duke përfshirë spitalin rajonal të Shkodrës – me 85 mjekë dhe 262 infermierë, ndërsa shërbimet shëndetësore në Malësi të Madhe ofrohen nga 19 mjekë dhe 92 infermierë.

Rajoni i Lezhës ka 3 spitale: 1 në Bashkinë Lezhë, 1 në Bashkinë Rrëshen dhe 1 në Bashkinë Laç. Numri i përgjithshëm i mjekëve në rajonin e Lezhës shkon në 83, të mbështetur nga 341 infermierë.

Qarku i Tropojës ka 1 spital në Bashkinë Bajram Curri; spitali ka 13 mjekë të mbështetur nga 134 infermierë.

Në përgjithësi, shërbimet shëndetësore në Shqipëri janë duke u përmirësuar, por duhet të bëhet akoma më shumë për të siguruar akses universal në shërbime të tilla edhe nga familjet e varfra. Sfida kryesore e radhës për të garantuar që të gjithë qytetarët janë të pajisur me shërbimet e duhura shëndetësore është heqja e pengesës ekonomike për të pasur akses në shërbimet cilësore, e cila është e rënduar nga mungesa totale e sigurimit shëndetësor.

2.3.4 Kultura

Në përgjithësi, në zonën e programit kultura karakterizohet nga elemente të ndryshme të traditave individuale dhe të përbashkëta. Qendrat turistike dhe qytetet e mëdha janë të pasura me trashëgimi kulturore që përfshijnë monumente dhe vende fetare (kisha, manastire dhe xhami), qytete të vjetra, vende arkeologjike dhe muzeume të ndryshme. Zona e programit është gjithashtu e pasur në traditën e kuzhinës dhe artizanatit, të cilat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të turizmit. Bashkëpunimi ndërkufitar mund të luajë rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e kësaj trashëgimie, si dhe në forcimin e mëtejshëm të lidhjeve të bashkëpunimit rajonal midis dy vendeve. Investimet dhe subvencionet e kufizuara publike kanë mbajtur një nivel të ulët të aktiviteteve kulturore në zonën e programit, pavarësisht trashëgimisë së saj të pasur. Megjithatë, aktivitetet kulturore dhe kontaktet mund të intensifikohen, duke krijuar kështu një bazë për një bashkëpunim ndërkufitar më aktiv. Kjo krijon kushte të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të nismave të përbashkëta që synojnë shtimin e vlerës në trashëgiminë e përbashkët në të dyja anët e zonave kufitare.

Zona e programit në **Mal të Zi** përmban një shumëllojshmëri të besimeve fetare, traditave, dhe kulturave. Zona përmban popullsi me kombësi të përzier (malazezët, serbët, shqiptarët, boshnjakët), me një histori të gjatë të të qenët të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Një histori dhe

[1] Instituti i Shëndetit Publik i Malit të Zi 2011.

[2] Rajonet Shkodër dhe Lezhë, Buletini Statistikor 2012.

traditë e tillë krijon një terren të mirë për iniciativat ndërkufitare, pasi marrëdhëniet ndërkufitare dhe lidhjet kulturore janë të rrënjosura thellë në mendësinë e popullsisë në zonën e programit.

Në Shqipëri, zona e programit është e pasur në trashëgimi kulturore. Përveç kalasë së famshme të Rozafës, në Shkodër ka disa muzeume, një numër të konsiderueshëm të vendeve arkeologjike dhe atraksione turistike të lidhura me trashëgiminë kulturore të rajonit dhe qytetit. Lezha, një park arkeologjik që prej vitit 2005, ka gjithashtu rrënojat e kalasë së saj, të cilat dominojnë qytetin, së bashku me atraksione të tjera si muzetë dhe kishat, të cilat mund të gjenden në rajon. Monumenti më i rëndësishëm në rajonin e Lezhës është memoriali i heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastriot Skënderbeu, i vendosur mbi rrënojat e kishës së lashtë ku u themelua Lidhja Shqiptare për të luftuar otomanët në vitin 1444 në qytetin e Lezhës.

2.3.5 Shoqëria civile

Në **Mal të Zi** janë 5,843[1] Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC) të regjistruara. Pjesa më e madhe e tyre janë shoqata qytetare (5665), dhe 175 janë fondacione. OSHC-të me më shumë ndikim dhe përvojë janë të vendosura në Podgoricë, aktive në sektorë të ndryshëm (të drejtat e njeriut, politikat publike, mjedisi dhe zhvillimi rural, ngritja e kapaciteteve, aftësitë e kufizuara etj.). Shumica e tyre kanë një përvojë në përcaktimin e projekteve BNK. Në rajone të tjera dhe veçanërisht në rajonin verior, situata e OSHC-ve është më e pasigurt. Kapacitetet njerëzore dhe kapacitetet e financimit janë përgjithësisht të pamjaftueshme; partneriteti me autoritetet lokale, si dhe krijimi i rrjeteve rajonale të OSHC-ve janë ende të dobëta. Megjithatë, rrjeti lokal i organizatave komunitare është i shumëllojshëm dhe i pasur. Disa prej tyre, të tilla si shoqatat e malësorëve, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e nismave BNK.

Sektori i OSHC-ve në **Shqipëri** është i vogël dhe relativisht i pazhvilluar. Zyrtarisht ekzistojnë 2,231 shoqata, 311 fondacione dhe 552 qendra të regjistruara[2]. Pjesa më e madhe e OSHC-ve janë të përqendruara në kryeqytet (Tiranë), ose në rajonin qendror (i cili përfshin Tiranën dhe qytetet e mëdha të tilla si Shkodra, Durrësi, Elbasani, Korça). Shoqëria civile është e përfaqësuar dobët në të gjitha zonat rurale. Aktivitetet kryesore të OSHC-ve bazohen tek advokimi dhe kërkimi në fushat e promovimit të të drejtave të njeriut, mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve, demokracisë dhe qeverisjes së mirë, si dhe kërkimeve dhe advokimit mbi politikat, dhe zhvillimit ekonomik. Aksesi në financimet qeveritare dhe private është i kufizuar. Sektori i Shoqërisë Civile në Shqipëri, si një i tërë, është pak i integruar dhe përfaqësuar. Nuk ka asnjë forum të sektorëve të gjerë ose rrjet që i dedikohet koordinimit të përpjekjeve të OSHC-ve.

2.4 INFRASTRUKTURA

Mali i Zi dhe Shqipëria janë pjesë e SEETO[3] – Rrjeti kryesor. Linja më e rëndësishme në këtë zonë është rruga që lidh Podgoricën me Shkodrën nëpërmjet Bozaj -Hani Hotit, e cila është pjesë e Rrjetit Evropian të Rrugëve thelbësore.

Pozicioni i zonës së programit thekson rëndësinë e një infrastrukture të mirë transporti në zhvillimin e ardhshëm të turizmit, tregtisë, shkëmbimeve kulturore dhe në rritjen e konkurrencës. Infrastruktura rrugore që lidh Malin e Zi dhe Shqipërinë, në veçanti përmes akseve Sukobinë–Muriqan dhe Bozaj–Hani i Hotit është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Edhe infrastruktura e shërbimeve nga këto pika të kalimit kufitar është përmirësuar, duke lejuar komunikimin më të shpejtë midis dy zonave, duke lehtësuar kështu transportin, tregtinë dhe turizmin. Pika e tretë kufitare në Gjercan–Plavë është më pak e zhvilluar. Një pikë e katërt e kalimit kufitar në Cijevna Zatrijebačka–Triesh, do të krijohet pas përfundimit të ndërtimit të rreth 23 km rrugë brenda territorit shqiptar, e cila është në ndërtim e sipër me financim të

[1] Raporti i vlerësimit të nevojave për Malin e Zi nga TACSO. Nuk dihet se sa prej tyre janë aktive.

[2] Vlerësimet e fundit të shoqërisë civile dhe vëzhgimet intensive nga Zyra e Projektit TACSO në Shqipëri vlerësojnë se numri i përgjithshëm i OSHC-ve aktive nuk i kalon 450.

[3] Observatori i Transportit Jug-Lindor. Korridoret e rrugëve dhe Lidhjet përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjën, Kroacinë, Kosovën, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë, Malin e Zi.

BERZH. Ajo do të shkurtojë ndjeshëm kohën e udhëtimit nga Plava në Podgoricë (koha e udhëtimit e pritur nëpër territorin shqiptar do të jetë rreth gjysmë ore).

Rrugët

Në **Mal të Zi** nuk ka autostrada; rrugët kryesore të vendit janë rrugë të tipit me një karrexhatë. Lidhjet midis Podgoricës dhe qyteteve bregdetare janë përmirësuar ndjeshëm, kohët e udhëtimit janë bërë më të shkurtra dhe rrugët janë bërë më të sigurta me përfundimin e tunelit Sozina (koha e udhëtimit nga Podgorica në Tivar, gjysmë ore) dhe përmirësimet e shumta të rrugëve në drejtim të Cetinjës dhe Tivarit. Megjithatë, rrjeti i rrugëve sekondare dhe rurale, i menaxhuar nga bashkitë, kërkon përmirësime pasi shpesh është në gjendje të keqe.

Në zonën **shqiptare** të programit, infrastruktura e rrugëve është përmirësuar ndjeshëm në 5 vitet e fundit, edhe pse Tropoja ka ende nevojë për përmirësime në rrjetin e saj rrugor. Transporti i mallrave dhe i njerëzve tani është më i lehtë dhe më i shpejtë. Të udhëtosh nga Tirana për në Lezhë dhe Shkodër nuk merr më shumë se 120 minuta; një pjesë e kësaj rruge i përket autostradës Durrës–Kukës – "Rruga e Kombit", e cila lidh Shqipërinë me Kosovën.

Transporti hekurudhor

Mali i Zi dhe Shqipëria kanë rënë dakord për të integruar procedurat e organizimit të **transportit hekurudhor** midis dy vendeve. Një hekurudhë kalon përmes zonës së programit nga Podgorica në Shkodër, me një gjatësi prej rreth 63.5 km; ajo është përdorur vetëm për transportin e mallrave, pasi linja nuk është e elektrizuar. E njëjta hekurudhë lidh Tiranën me Shkodrën, nëpërmjet Lezhës. Duke qenë se zhvillimi i infrastrukturës është fokusuar kryesisht në rrjetin rrugor, rrjeti hekurudhor ka marrë pak vëmendje nga qeveritë përkatëse, duke çuar në përkeqësimin e kushteve fizike të kësaj hekurudhe ndër vite. Planet e ardhshme përfshijnë elektrifikimin e saj, të paktën në anën e Malit të Zi, si dhe përdorimin e kësaj hekurudhe edhe për transportin e udhëtarëve, duke miratuar komunën urbane të Tuzit, një nënndarje të Komunës së Podgoricës, si stacion të përbashkët kufitar.

Transporti ajror dhe detar

Aeroporti i Podgoricës në Mal të Zi është i vetmi aeroport në zonën e programit. Në zonën e programit në **Mal të Zi** gjendet **porti** i Tivarit, më i madhi në Mal të Zi, si dhe molet në Budva dhe porti i vogël i Ulqinit.

Në zonën e programit në **Shqipëri** është porti i Shëngjinit (qarku i Lezhës), i cili i shërben nevojave të pjesës veriore të Shqipërisë për transportin detar.

Telekomunikacioni

Telekomunikacioni në zonën e programit përfiton si nga telefonia fikse, ashtu edhe nga ajo celulare. Telefonia fikse në **Mal të Zi** është plotësisht e digjitalizuar. Numri i abonentëve është rreth 1.700.856[1], duke korresponduar me një normë prej 27,55%. Tregu i telefonisë celulare ka tre operatorë telekomunikacioni. Në vitin 2012, tri kompanitë celulare raportuan një total prej 990,868 përdoruesish, që korrespondon me një normë prej 159%.

Në **Shqipëri**, niveli i depërtimit të telefonisë fikse dhe celulare në zonën e programit qëndron në 88.15%[2], pak nën mesataren kombëtare prej 89.47%. Megjithatë, me përjashtim të qyteteve kryesore, depërtimi i telefonisë fikse në zonat rurale është i ulët; komunikimi është i bazuar kryesisht në telefonat celularë. Ekziston një ofrues kombëtar i telefonisë fikse, ndërkohë që ka 4 operatorë celularë. Niveli i depërtimit të telefonisë celulare në Shqipëri është mbi 130%.

Teknologjitë e Informacionit

Njohuritë kompjuterike në **Mal të Zi**[3] i përkasin mesatarisht 35% të popullsisë nga 15 vjeç e lart. Rreth 16% e popullsisë ka njohuri të pjesshme mbi kompjuterin. Përqindja më e madhe e njohjes së kompjuterit në zonën e programit është hasur në Budva me 46%, në Podgoricë 41%,

[1] Agjencia për Komunikimet Elektronike dhe Shërbimet Postare, Raporti Vjetor 2011.
[2] Shqipëria, Census 2011.
[3] MONSTAT, Popullsia sipas njohjes kompjuterike për bashkitë në Mal të Zi në vitin 2011, publikimi Nr. 156

ndërsa më e ulëta është në Andrijevica me rreth 18%. Njohuritë kompjuterike janë më të larta midis popullsisë më të re, dhe ato bien me rritjen e moshës.

Në **Shqipëri**, niveli i përdorimit të internetit (që do të thotë se ka një kompjuter që përdoret për të hyrë në internet) në familjet në zonën e programit qëndron në 9.97%, i cili është nën mesataren kombëtare prej 12.35%.

Energjia

Energjia është e disponueshme në të gjitha bashkitë në zonën e programit në **Mal të Zi**. Shumica e nevojave energjetike plotësohen nëpërmjet importeve – e gjithë nafta dhe derivatet importohen, ashtu si dhe një e treta e konsumimit të elektricitetit. Madhësia e tregut të energjisë elektrike është rreth 3.720 Gwh/ vit, nga të cilat 28.2% janë të importuara, duke treguar një nivel të moderuar të shfrytëzimit të potencialit të vet hidroenergjetik.

Kapaciteti aktual i instaluar në **Shqipëri** është 1,726 mw[1], një normë shfrytëzimi e vetëm 35% të potencialit të saj hidroenergjetik. Pjesa më e madhe e energjisë hidrike të vendit, rreth 52.3%, gjenerohet në zonën e programit, i cili ka tri hidrocentralet më të mëdha të Shqipërisë: Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës me kapacitet prej 1,350 mw në total. Impianti i Hidrocentralit të Ashtës me kapacitet të instaluar prej 53 mw u vu në punë në shtator 2012. Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike në vitin 2012 në Shqipëri arriti në 4,288 gwh, duke mbuluar vetëm 57% të konsumit të saj vjetor, dhe duke e bërë kështu Shqipërinë një rrjet importues të energjisë. Përfundimi i linjës ndërlidhëse 400 kV midis Shqipërisë dhe Malit të Zi (Elbasan-Podgoricë), rrit kapacitetet e shkëmbimeve të energjisë midis dy vendeve dhe lidh Shqipërinë me rrjetet rajonale dhe Evropiane, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike në vend. Edhe pse ka burime të mëdha, por ende të pashfrytëzuara hidrocentrale, Shqipëria karakterizohet nga një efikasitet i ulët në përdorimin e energjisë elektrike. Përdorimi i energjisë për qëllime ngrohje është i përhapur në shkallë të gjerë.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Shumica e familjeve (247,354) në **Mal të Zi** përdorin ujin nga sistemi publik i ujit, edhe pse sistemi publik i ujit mund të jetë i pamjaftueshëm në zonat rurale dhe gjatë kohës së verës. Nga numri i përgjithshëm i banesave[2], 92% prej tyre kanë akses në sistemet e furnizimit me ujë brenda shtëpive të tyre, dhe po i njëjti numër banesash është i lidhur me sistemin e kanalizimit brenda shtëpisë. Në zonën e programit, Budva ka shkallën më të lartë të aksesit në sistemet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, me një mesatare prej 99%, ndërsa Andrijevica ka normën më të ulët të aksesit në këto dy shërbime, mesatarisht 76%.

Në zonën e programit në **Shqipëri**, furnizimi me ujë dhe sistemet e kanalizimit dhe ujitjes mbeten problematike. Aksesi në ujë brenda banesave për rreth 106,094 familje[3] në zonën e programit është i siguruar për vetëm rreth 55.4% të tyre; rreth 39.5% e banesave kanë akses të pjesshëm në sistemet e furnizimit me ujë, ndërsa 5.1% e familjeve në zonën e programit nuk kanë akses në sistemin e ujësjellësit. Numri i familjeve pa akses në sistemet e ujësjellësit dhe të kanalizimeve është më i lartë në Shkodër me 1.13%, e pasuar nga Lezha me vetëm 0.98%, ndërsa rrethi i Tropojës regjistron 0.75% – duke qenë më mirë se mesatarja kombëtare me 1.12%. Përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë janë të nevojshme për të ruajtur dhe për të nxitur nivele të qëndrueshme të turizmit, si dhe për të zvogëluar pabarazitë rajonale.

2.5 MJEDISI

Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit janë të rëndësishme për një zhvillim të qëndrueshëm të zonës së programit, e cila është mjaft e pasur në burime mjedisore dhe biodiversitet në të dyja anët e kufirit. Zona e programit është shumë e pasur në burime natyrore dhe biodiversitet. Megjithatë ka disa faktorë që kërcënojnë burimet mjedisore në zonën e programit, të tillë si; shpyllëzimi për shkak të rënies së pakontrolluar të pemëve; menaxhimi i varfër i ujit dhe i ujërave të zeza; largimi

[1] ERE – Raporti Vjetor 2012.

2 MONSTAT. Banesat sipas pajisjes me instalime, publikimi nr. 280.

3 Census 2011, INSTAT treguesit e ndërtesave dhe banesave sipas prefekturave.

i pakontrolluar i mbeturinave; urbanizimi i parregulluar; ndotja industriale në disa zona; vend-groposjet e paligjshme, të cilat rrezikojnë ndotjen e lumenjve dhe liqeneve; përdorimi intensiv i pesticideve, i cili po dëmton bujqësinë; peshkimi i tepruar dhe gjuetia e jashtëligjshme, të cilat kërcënojnë faunën në liqene dhe lumenj. Degradimi i tokës është i pranishëm në të dyja anët e kufirit.

Mali i Zi ka një diversitet të lartë biologjik, për shkak të sfondit të tij gjeologjik, klimës dhe pozicionit në afërsi të detit dhe maleve. Mali i Zi ka dy vende të Trashëgimisë Botërore, një rezervë të biosferës dhe pesë parqet kombëtare. Mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit është një shtyllë e të gjitha strategjive të zhvillimit të vendit. Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura të Malit të Zi mbulon 108,866 ha[1] ose 7.88% të territorit të përgjithshëm. Ajo përbëhet nga 5 parqe kombëtare - Liqeni i Shkodrës, Durmitor, Lovćen, Biogradska Gora, dhe Prokletije. Zona e programit është e pasur në burime natyrore dhe përmban katër parqe kombëtare në zonën e programit të Malit të Zi:

- *Liqeni i Shkodrës* ndodhet në bashkitë e Podgoricës dhe Tivarit. Një e treta e liqenit i përket Shqipërisë. Pjesa e Malit të Zi (rreth 40.000 hektarë) është renditur si një Park Kombëtar në vitin 1983. Si liqeni më i madh në Ballkan, ai është jashtëzakonisht i pasur me zogj dhe peshq, si dhe me bimësi kënete. Liqeni i Shkodrës është në listën e zonave lagunore të rëndësishme në nivel ndërkombëtar, si habitat ujor dhe i zogjve migratorë (Konventa e Ramsarit).
- *Biogradska Gora* është i rrethuar nga bashkitë Andrijevice, Berane, Kolashin, dhe Mojkovac. Parku Kombëtar u shpall në vitin 1952 dhe mbulon 54 km^2. Ai është i njohur për pyjet e tij të paprekur (midis pyjeve të fundit primarë në Evropë), diversitetin e madh të florës dhe faunës dhe për gjashtë liqenet e tij akullnajore, duke përfshirë Liqenin e famshëm Biogradsko.
- *Lovćen* është një park kombëtar në zonë malore që gjendet në bashkitë Budva dhe Cetinje, dhe mbulon një sipërfaqe prej 6220 hektarësh.
- *Prokletije* është një varg malor që shtrihet nga Shqipëria veriore, në Kosovën jug-perëndimore dhe në zonën lindore të Malit të Zi. Si një vend natyror i paprekur dhe i jashtëzakonshëm, ai u shpall një Park Kombëtar në Mal të Zi në vitin 2009 (Parku mbulon rreth 210 km^2, kryesisht në bashkitë Plavë dhe Guci). Ai është Parku i fundit Kombëtar i listuar në Mal të Zi. Për këtë arsye, njësia e menaxhimit të parkut nuk është themeluar ende.

Industria dhe bujqësia nuk janë ndotës të mëdhenj në zonën e programit, edhe pse nivelet e fluorit në Podgoricë tejkalojnë kufijtë e lejuar 3–6 herë gjatë vitit. Ndërkohë ekziston një nevojë e përgjithshme për rinovimin teknologjik. Kërcënimet kryesore për mjedisin janë të lidhura me mungesën e sistemeve të trajtimit të ujërave të ndotura (Podgorica është pjesërisht e pajisur me impiante të trajtimit të ujërave të zeza) dhe vendgroposjeve të përshtatshme për mbetjet e ngurta. Disa projekte investimi të bashkë financuar nga BE-ja ose të mbështetur nga bankat evropiane janë planifikuar dhe duhet të përmirësojnë këtë situatë.

Në **Shqipëri**, zona e programit ofron një biodiversitet dhe klimë të pasur, pasi ajo përfshin malet, kodrat, fushat, liqenin, lumenjtë dhe bregdetin. Ajo ka 8 parqe kombëtare[2], rezerva natyrore dhe peizazhe të mbrojtura, të cilat mbulojnë mbi 13% të territorit të përgjithshëm. Agjencitë Rajonale të Mjedisit janë të pranishme në të dyja rajonet e zonës shqiptare të programimit. Qarku Tropojë mbulohet nga Agjencia Rajonale e Mjedisit e Rajonit të Kukësit.

Në qarkun e Shkodrës ndodhen tri parqe kombëtare – Parku Kombëtar i Thethit, i cili ndodhet në zonën malore në kufi me Malin e Zi; Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna, të cilat janë cilësuar si vende Ramsar. Parku më i rëndësishëm natyror në zonën e programit është Liqeni i Shkodrës. Bashkëpunimi midis dy vendeve në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e liqenit të Shkodrës është rritur në dekadën e fundit. Zonat e mbrojtura në qarkun e Lezhës përfshijnë Berzanën, Kune-Vain-Tale, dhe Patok-Fushëkuqe-Ishëm, të cilat janë të gjitha Burime Natyrore të Menaxhuara. Qarku i Lezhës gjithashtu përfshin 4.745 ha peizazhe të mbrojtura. Zona e

1 MONSTAT, Libri statistikor 2012.

2 Shqipëria, Ministria e Mjedisit, rrjeti i zonave të mbrojtura në Shqipëri, shtator 2013.

mbrojtur më e rëndësishme në qarkun e Lezhës është Kune-Vain-Tale, një kompleks lagunash me ishullin e rërës së Kunes prej 125 ha në të djathtë të deltës së lumit Drin. Kjo zonë ka një florë të pasur dhe përmban rreth 70 lloje shpendësh, 22 lloje zvarranikësh (nga 33 që janë në nivel kombëtar) dhe gjithashtu 6 lloje amfibësh nga një total prej 15 në nivel kombëtar.

Qarkut i Tropojës ka një Park Kombëtar që nga viti 1996, dhe 29 zona të mbrojtura që nga viti 2002. Parku Natyror i Luginës së Valbonës është zona më e rëndësishme e qarkut, pasi ajo përfshin një sipërfaqe prej 8000 ha.

Ndryshimet sociale dhe ekonomike të viteve të fundit si dhe ndryshimet demografike në Shqipëri dhe Mal të Zi, kanë ushtruar presion mbi mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe biodiversitetit në zonën e programit. Dëmet e dekadës së kaluar janë të dukshme në zonën e pyjeve, për shkak të ndërhyrjeve të popullsisë lokale. Shumica e dëmit ka ardhur për shkak të prerjeve abuzive dhe mbi-kullotjes. Mbrojtja e burimeve natyrore me fokus tek pyjet, zonat e mbrojtura dhe shfrytëzimi i burimeve ujore përfaqësojnë vlerat ekonomike dhe mjedisore për këtë zonë. Megjithëse ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit është rritur, një shkallë më e lartë e zbatimit të standardeve për mbrojtjen e mjedisit është e nevojshme për të siguruar zhvillimin e duhur urban dhe zgjerimin e turizmit. Reduktimi i ndotjes ekzistuese, menaxhimi i mbetjeve urbane dhe sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik dhe garantimit të një mjedisi të pastër, i lidhur me masat për të mbrojtur tokën nga shkatërrimi natyror dhe artificial si dhe zbatimi i një procesi strategjik të planifikimit urban, janë sfidat kryesore për t'u përballuar në zonën e programit.

2.6 MARRËVESHJET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Mali i Zi është i ndarë në 23 bashki, si njësi bazë të qeverisjes vendore.

Objektivat e vendit përfshihen në një numër të strategjive, të cilat vënë në dukje prioritetet zhvillimore që mund të shërbejnë si fushat e ndërhyrjes për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar. Strategjitë më të lidhura me qëllimet e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar janë:

- Drejtimet e zhvillimit të Malit të Zi 2013–2016;
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Malit të Zi (2007);
- Strategjia e Zhvillimit Rajonal 2010–2014;
- Strategjia për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme 2011–2015;
- Strategjia për Bujqësinë (2014–2020);
- Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore 2012–2015;
- Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Profesional në Mal të Zi 2010–2014.

Pushteti lokal në **Shqipëri** përbëhet nga dy nivele: niveli i parë përbëhet nga 374 njësi të qeverisjes vendore (NjQV) të ndara në 65 bashki në zonat urbane dhe 309 komuna në zonat rurale, të cilat mund të ndahen më tej në fshatra (3020); niveli i dytë përbëhet nga 12 rajone (*qarku*). Strategjitë më të lidhura me qëllimet e Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- Strategjia Kombëtare ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal 2007;
- Kuadri Strategjik i Zhvillimit Rajonal të Shkodrës 2010–2016;
- Kuadri Strategjik i Zhvillimit Rajonal të Lezhës 2010–2016.

1	Konkurrenca, zhvillimi i biznesit dhe NVM- ve, tregtia dhe investimet	-
2	Punësimi, Lëvizja gjeografike e punonjësve, dhe Përfshirja sociale	- "Konkluzionet e Malit të Zi " dokument i nënshkruar gjatë Forumeve të Konferencës së tretë Ministrore mbi Punësimin dhe Politikat Sociale në Evropën Juglindore, në 26.10.2007.

3	Kërkimi shkencor, Zhvillimi dhe Inovacioni Teknologjik dhe TIK	- Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Malit të Zi për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik, nënshkruar më 16.12.2008.
4	Mbrojtja e Mjedisit, Ndryshimet Klimatike dhe Parandalimi i rrezikut	- Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Malit të Zi mbi problemet e ujit. Statuti i Komisionit të përbashkët ndërqeveritar Shqiptaro-Malazez në trajtimin e kufijve ujor dhe Protokolli i mbledhjes së këtij Komisioni nënshkruar më 31.10.2001, hyrë në fuqi më 13 Shkurt 2003. - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për shfrytëzimin e LTL 400 kV, nënshkruar më 02.07.2004. - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi zhvillimin ndërkufitar të liqenit të Shkodrës, nënshkruar më 26.05.2006. - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Malit të Zi, nënshkruar më 14.12.2010, hyrë në fuqi në të njëjtën ditë.
5	Transporti dhe Infrastrukturat publike	- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi mbi vendosjen e qarkullimit të përhershme ndërkombëtar nëpërmjet pikës kufitare Han i Hotit–Bozhaj, nënshkruar më 24.01.2000. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, nënshkruar më 02.07.2000 dhe hyrë në fuqi më 11.11.2004. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për krijimin e linjës ndërkombëtare të liqenit për udhëtarët, Shkodër-Virpazar, nënshkruar në Podgoricë më 02.07.2004. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për marrëdhëniet reciproke për çështjet doganore, nënshkruar më 23.12.2005, hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2007. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi organizimin e trafikut hekurudhor ndërmjet dy vendeve, nënshkruar më 16.05.2006. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët kufitare Murriqan-Sukobinë, e nënshkruar më 17 janar 2007. - Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për kryerjen e transportit kufitar hekurudhor ndërmjet dy vendeve, të nënshkruar në Podgoricë, më 03.08.2012.
6	Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore	- Marrëveshja mbi bashkëpunimin kulturor ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Sporteve dhe Medias të Malit të Zi, nënshkruar më 28.02.2001, dhe hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit. - Marrëveshja për bashkëpunimin kulturor ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Sporteve dhe Medias të Malit të Zi, nënshkruar më 10.11.2009, dhe hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit.
7	Rinia dhe arsimi	-
8	Qeverisja Lokale dhe Rajonale, Planifikimi dhe Administrimi i Ngritjes së Kapaciteteve	-

3.7 KONKLUZIONE

Zona e programit është e ndryshme, e megjithatë, disa tipare të përbashkëta në lidhje me natyrën, pozicionin gjeografik, tendencat demografike, ekonominë, kapitalin njerëzor etj., mund të gjenerojnë sinergji dhe të jenë një mundësi e mirë për zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave BNK.

- **Karakteristikat ekonomike** të të dyja vendeve tregojnë tendenca të ngjashme. Të dyja vendet janë klasifikuar si ekonomi me të ardhura mbi mesatare nga Banka Botërore. Struktura e ekonomisë është e ndryshme në të dyja anët e kufirit. Ndërsa rajonet shqiptare mbështeten në bujqësi, shërbime, tregje shumice dhe pakice, rajonet malazeze shfaqin industri më të zhvilluar, dhe një niveli shumë më të zhvilluar të turizmit. Përgjithësisht, bujqësia është e rëndësishme për të dyja palët.

- **Konkurrenca është e ulët në të dyja anët e kufirit.** Produktivitet më i lartë dhe investime të mëtejshme në njohuritë mbi përdorimin e teknologjive të inovacionit është një parakusht për t'u bërë më konkurrues si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Zakonisht, bizneset në zonat kufitare shfrytëzojnë mundësitë për tregti përtej kufirit dhe në arenën ndërkombëtare, por tregtia ndërmjet dy vendeve dhe palëve të treta është ende e kufizuar nga barrierat e shumta administrative.

- **Forcimi i rrjeteve të NVM-ve dhe lidhjet e shërbimeve ekzistuese në zonat kufitare janë një potencial që përdoret shumë pak.** Mbi 97% e NVM-ve të regjistruara punësojnë më pak se 4 persona. Niveli i bashkëpunimit përtej kufirit është minimal. Promovimi i biznesit virtual do të jetë i rëndësishëm. Me pak fjalë, në aspektin e zhvillimit të sektorit privat ka sinergji të qarta për t'u zhvilluar brenda zonës së programit, të cilat duhen mbështetur nga programi i bashkëpunimit ndërkufitar.

- **Të dyja anët e zonës së programit janë duke u bërë gjithnjë e më tërheqëse për investitorët e huaj,** por tek të dyja anët ka nevojë për përmirësimin e kushteve, veçanërisht të infrastrukturës, për të bërë biznes. Investimet në turizëm, në energjinë e rinovueshme dhe në bujqësi mund t'i bëjnë këto të fundit sektorët potencialë për tërheqjen e më shumë IHD-ve (Investime të huaja direkte). Industritë e përpunimit të dritës dhe ushqimit janë konsideruar gjithashtu si një potencial për rritjen e përshpejtuar ekonomike të zonës së programit.

- **Bujqësia është një potencial i madh ekonomik në zonën e programit, por përdoret pak.** Në përgjithësi, ekonomia rurale është e fragmentuar, në një shkallë më të lartë në zonën shqiptare të programit, dhe pronat e vogla bujqësore kanë vështirësi për të hyrë në treg. Prodhimi është mesatarisht i larmishëm dhe gama e prodhimeve kryesore bujqësore në të dyja anët e kufirit është më shumë plotësuese sesa konkurruese. Përmirësimi i aksesit në treg dhe forcimi i sistemit të sigurisë ushqimore dhe organeve inspektues do të jenë të rëndësishme për rritjen e konkurrencës në sektorin e bujqësisë. Ndërhyrja e ardhshme duhet të synojë përmirësimin e efikasitetit në bujqësi dhe pylltari, si dhe të zhvillojë burime shtesë të të ardhurave nga ruajtja e pasurive natyrore dhe turizmit.

- **Papunësia mbetet një problem i mprehtë** për popullsinë e zonës së programit, veçanërisht për grupet e ndjeshme sociale siç janë të rinjtë, popullsia rurale dhe gratë. Pasiguria e punësimit konsiderohet si arsyeja kryesore për shkallën e lartë të migracionit, veçanërisht, në zonat rurale ose më pak të zhvilluara, ku niveli i papunësisë është i lartë si rezultat i mjeteve të jetesës dhe prodhimeve bujqësore të një niveli të ulët që ofrojnë një formë të sigurimit shoqëror për pjesën më të madhe të popullsisë rurale dhe të punës, si një amortizator kundër normave të larta të papunësisë së regjistruar.

- **Mbrojtja e mjedisit ka nevojë për vëmendje serioze në planet e ardhshëm të zhvillimit të zonës së programit.** Me zhvillimin e përgjithshëm të zonës së programit mbështetur kryesisht në burimet natyrore, mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e këtyre burimeve është vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, kontrolli i ndotjes, dhe përmirësimi i menaxhimit të tokave janë ndër prioritetet kryesore për t'u adresuar nga planet zhvillimore qeveritare dhe lokale. Vleftësimi i mëtejshëm i burimeve natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik është një çështje kyçe për zhvillimin e zonës, veçanërisht në anën shqiptare të kufirit.

- **Infrastruktura e varfër është një sfidë kryesore për zhvillimin ekonomik dhe social** të zonës së programit. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës publike mund të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në një rritje të përgjithshme të pasurisë në zonën e programit. Zhvillimi i infrastrukturës që lehtëson biznesin dhe përhapjen e rrjeteve dhe shërbimeve për të mbështetur zhvillimin dhe inovacionin e biznesit, mund të kontribuojë në një rritje të përgjithshme të pasurisë dhe ekonomisë në zonë.

- **Zona e programit ka potencial të lartë turistik, por këto mundësi janë përdorur kryesisht në anën e Malit të Zi**, ndërsa turizmi në anën e Shqipërisë është zhvilluar pak, pavarësisht potencialit të madh që ka. Iniciativa BNK me qëllim për të prodhuar një ofertë të

përbashkët turistike, duhet të konsiderohet. Sinergji të dukshme, me mundësi që të mbështeten nga bashkëpunimi ndërkufitar (programi BNK), mund të ndërtohen midis rajoneve në Shqipëri dhe zonave bregdetare në Mal të Zi, por edhe me "zonat më pak turistike" në verilindje të Malit të Zi, të cilat kanë karakteristika të ngjashme me veriun e Shqipërisë, në aspektin e mjedisit, natyrës së egër dhe maleve.

- **Ekziston një trashëgimi e pasur historike-kulturore-artistike në zonën në kufi, e cila duhet të ruhet.** Vleftësimi i mëtejshëm i trashëgimisë historike dhe kulturore mund të kontribuojë në forcimin e identitetit të zonës. Trashëgimia kulturore është një pasuri për zhvillimin ekonomik të zonës së programit. Bashkëpunimi midis institucioneve kulturore është i pranishëm, por ai mund të intensifikohet akoma më tej.

- **Përmirësimi i cilësisë së sistemit arsimor dhe infrastrukturës shkollore është një sfidë dhe prioritet** për zonën e programit, veçanërisht në zonat rurale. Prezenca e universiteteve të rëndësishme private dhe publike si dhe e qendrave kërkimore të biznesit në zonën e programit është një pasuri për programin BNK. Veprime të mëtejshme të përbashkëta do të mund të ndërmerren për të krijuar rrjetin e qendrave të formimit profesional si dhe të institucioneve të larta, agjencive dhe organizatave kërkimore.

- Në përgjithësi, **sektori i shëndetësisë** është i dobët dhe i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë. Mungesa e një kuadri të duhur ligjor për sigurimin shëndetësor në zonat rurale (në anën shqiptare të kufirit), vazhdon të pengojë zhvillimin e këtij sektori. Duke pasur parasysh se sektori i shëndetësisë menaxhohet në nivel qendror, ndoshta nuk mund të bëhet shumë në kuadrin e programeve BNK, por sigurisht që ka vend për aktivitete të mundshme të përbashkëta që lidhen me fushatat parandaluese dhe edukimin shëndetësor.

- **Inkurajimi i rrjeteve rajonale të OSHC-ve** (duke përfshirë organizatat e sportit, rinisë dhe ato kulturore) mund të kontribuojë në ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet komuniteteve në të dyja anët e kufirit në këtë zonë të programit shumetnik.

- **Depërtimi i kërkimit shkencor dhe zhvillimit dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është në disproporcion të dukshëm midis vendeve të programit, dhe mbetet në nivel të ulët.** Investimet e pamjaftueshme, mungesa e aktiviteteve mbështetëse në nivel qendror, rajonal ose lokal për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, janë të pranishme, pavarësisht faktit që në zonën e programit ka 4 Universitete. Nuk ka të dhëna specifike mbi kërkimin shkencor, zhvillimin dhe inovacionin, por praktikisht mungon bashkëpunimi midis institucioneve edukuese në të dyja vendet, dhe kjo fushë është e pa eksploruar.

- **Në përgjithësi, qeveritë lokale dhe rajonale janë të dobëta financiarisht dhe nuk mund të nxisin zhvillimin lokal.** Ndryshe nga Shqipëria, Mali i Zi nuk ka qeverisje lokale. Atyre iu mungojnë aftësitë menaxhuese, të kontrollit financiar dhe buxhetimit, si dhe qasjet demokratike në proceset vendimmarrëse. Absorbimi i fondeve të BE-së është i ulët. Bashkëpunimi midis qeverive lokale ndërmjet dy vendeve mund të përmirësohet. Procesi i decentralizimit është duke vazhduar në të dyja vendet.

4. ANALIZA SWOT

	PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
RRITJA E KONKURRENCËS, ZHVILLIMI I BIZNESIT DHE NVM-ve, TREGTIA DHE INVESTIMET	- Marrëveshja e tregtisë së lirë midis dy vendeve . Të dyja vendet marrin pjesë në CEFTA; - Klima e favorshme e biznesit dhe taksat e korporatave. Kuadri i përgjithshëm ligjor dhe institucional, i cili favorizon tërheqjen e investimeve të Huaja Direkte; - Protokolli ekzistues i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi . Ekzistenca e Forumit Ekonomik Rajonal ndërmjet Rajonit të Shkodrës dhe Malit të Zi - Një numër i madhe dhe në rritje i NVM-ve në të gjithë rajonin me aktivitete të shumëllojshme; - Burimet natyrore, Liqeni i Shkodrës, si dhe trashëgimia kulturore si potencial për zhvillimin e turizmit; - Mbulimi relativisht i mirë i zonës së programit me universitete dhe qendra të formimit profesional; - Ekzistenca e inkubatorëve të biznesit (Mal i Zi) dhe agjencive rajonale të zhvillimit (Shqipëri); - Rritja e investimeve në infrastrukturë me qëllim për të mbështetur zhvillimin e industrisë së turizmit në zonat përreth Liqenit të Shkodrës.	- Konkurrenca e ulët e bizneseve , produktivitet i ulët dhe njohuri të pamjaftueshme; - Migrimi dhe largimi i vazhdueshëm i fuqisë punëtore të kualifikuar; - Ekspozimi i kufizuar në tregjet ndërkombëtare; - Organizimi në shkallë të ulët i bujqësisë dhe produktivitet i ulët i aktiviteteve të agrobiznesit; - Kultura e kufizuar e sipërmarrjes, e dominuar nga tregtia afatshkurtër dhe aktivitetet e shërbimit më shumë sesa nga investimet kapitale afatgjata; - Pabarazia e lartë në zhvillimin urban dhe rural; - Niveli i ulët i teknologjisë; - Disponueshmëria e kufizuar e skemave të mikrokredive.	- Mundësia për të zhvilluar mekanizma dhe instrumente të ndryshëm, duke synuar lehtësimin në vendosjen e partneritetit të biznesit në iniciativat ndërkufitare; - Specializimi i NVM-ve dhe forcimi i tyre nëpërmjet rritjes së vlerës së produkteve të tyre; - Krijimi i produktit të integruar të turizmit , duke përfshirë të dyja zonat e liqenit, bregun dhe zonën malore ; - Identifikimi i disa produkteve të veçanta të zonës që mund të njihen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; - Zhvillimi i mëtejshëm i produkteve të agrikulturës dhe industrisë së agropërpunimit; - Përmirësimi i nivelit të arsimit profesional me qëllim që t'i shërbejë më mirë kërkesave të tregut të punës; - Rritja e partneritetit privat/ publik për ndërtimin e infrastrukturës adekuate rrugore; - Përparësitë që rrjedhin nga niveli relativisht i ulët i kostove të punës (veçanërisht në veri të Shqipërisë).	- Aksesi i kufizuar në sistemin e kredive për fermat dhe NVM- të mund të ngadalësojë zhvillimin ekonomik; - Administratat e vetë qeverisjes lokale të pazhvilluara dhe të pa pajisura; - Relievi malor dominues mund të ketë një ndikim negativ në zhvillimin ekonomik lokal; - Ekonomia informale konkurron padrejtësisht me sektorin formal; - Niveli i konsiderueshëm i korrupsionit; - Largimi i njerëzve të arsimuar në drejtim të zonave më të zhvilluara.

	PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
NXITJA E PUNËSIMIT, LËVIZJA E PUNONJËSVE, DHE PËRFSHIRJA SOCIALE DHE KULTURORE PËRMES KUFIRIT	- Fuqia punëtore me kosto relativisht të ulët; - Popullsia relativisht e re dhe normë rritje pozitive; - Prania e shkollave të arsimit profesional; - Prania e degëve universitare, me qëllim për të mbështetur dhe për t'u përqendruar më shumë në nevojat lokale për njohuri dhe aftësi; - Multietniciteti si një avantazh për përfshirje ekonomike, sociale dhe kulturore.	- Reduktimi dhe largimi i popullsisë së aftë dhe të arsimuar nga pjesët rurale të zonës së programit; - Shkalla e lartë e papunësisë, veçanërisht ndër popullsinë e re dhe femrat; - Kurrikula nuk i përshtatet plotësisht tregut të punës - trajnimi i orientuar profesional; - Numri i madh i familjeve që varen nga paratë e dërguara nga jashtë; - Niveli i ulët i arsimit të popullsisë rurale dhe grupeve shoqërore të margjinalizuara, të tilla si Romët etj.; - Institucione të dobëta të promovimit të punës në nivel lokal.	- Përmirësimi i nivelit të arsimit profesional në funksion të përshtatjes më të mirë me kërkesat e tregut të punës për punonjësit më të aftë; - Zhvillimi i aktiviteteve të kërkimit shkencor dhe zhvillimit, duke përdorur kërkimet ekzistuese dhe qendrat e arsimit të lartë; - Programet për rritjen e aksesit në tregun e punës të popullsisë rurale, veçanërisht të grave dhe grupeve të margjinalizuara; - Zhvillimi i programeve të punësimit për integrimin social të grupeve shoqërore të margjinalizuara; - Përmirësimi i lëvizjes së punonjësve në zonën e bashkëpunimit ndërkufitar.	- Mungesa e mundësive të punësimit që çojnë në migrim më të lartë në drejtim të zonave të zhvilluara të vendit ose jashtë vendit , veçanërisht të personave të rinj dhe të kualifikuar; - Kriza e zgjatur ekonomike e cila rrit papunësinë, me efekte më të mëdha të përhapura mbi grupet më pak të arsimuar dhe ato vulnerabël; - Aksesi i dobët i popullsisë rurale në sistemin arsimor për shkak të varfërisë apo infrastrukturës arsimore të papërshtatshme.

MBROJTJA E MJEDISIT , PROMOVIMI I PËRSHTATJES DHE LEHTËSIMIT TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE, PARANDALIMI DHE MENAXHIMI I RREZIKUT	- Biodiversiteti i pasur natyror, mjedisi i paprekur dhe tërheqës, diversiteti i peizazheve natyrore; - Ekzistenca e disa zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare të përshtatshme për zhvillimin e ekoturizmit; - Zonat e gjera pyjore dhe cilësia e pyjeve; - Potenciali i lartë për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë (energjisë së ujit, energjisë së erës, energjisë diellore dhe biomasës); - Zona e pastër, pa ndotje industriale, veçanërisht në breg dhe në zonat malore.	- Zbatimi i dobët i rregulloreve dhe standardeve mjedisore; - Menaxhimi dhe mekanizmi i dobët i kontrollit për mbrojtjen e burimeve natyrore; - Menaxhimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ngurta dhe mungesa e sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza; - Menaxhimi i papërshtatshëm i tokës; - Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i burimeve natyrore; - Ndërgjegjësimi i ulët për çështjet mjedisore.	- Menaxhimi më i mirë i zonave pyjore dhe të mbrojtura; - Zhvillimi i programeve të përbashkëta për trajtimin e mbetjeve; - Rritja e programeve dhe projekteve për mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, bujqësisë së qëndrueshme, mbeturinave të ngurta dhe ujërave të zeza etj.; - Interesi lokal për prodhimin e energjisë së gjelbër; - Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi masat për mbrojtjen e mjedisit nën trysninë e kërkesave ekoturistike; - Zona përreth liqenit të Shkodrës, bëhet pjesë e zonave të mbrojtura në "listën e Rezervës së Biosferës " të UNESCO-s.	- Ndotja e tokës dhe burimeve ujore për shkak të ekzistencës ose mungesës së një sistemi jo të përshtatshëm për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe ujërave të zeza; - Procesi i urbanizimit i pakontrolluar dhe jashtë standardeve; - Shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore (druri, zhavorri, frutat e pyllit), kryesisht shpyllëzimi; - Presionet në mjedisin rreth bregut për shkak të frekuentimit të lartë turistik; - Zgjerimi i industrisë së çimentos në rajonin e Lezhës, e cila paraqet një rrezik në rritje për natyrën përreth.

	PIKAT E FORTA	**PIKAT E DOBËTA**	**MUNDËSITË**	**KËRCËNIMET**
PROMOVIMI I TRANSPORTIT TË QËNDRUESHËM DHE PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURAVE PUBLIKE	- Pozicioni gjeografik strategjik në rajonin më të gjerë dhe pjesëmarrja në Rrjetet e Transportit Evropian; - Lidhjet e lehta duke përmirësuar infrastrukturën rrugore; - Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve të kalimit të kufirit; - Lidhjet hekurudhore; - Afërsia dhe aksesi i lehtë në të gjithë zonën e programit nga aeroportet në Podgoricë dhe Tiranë; - Portet e Tivarit dhe Shëngjinit, si një pasuri e rëndësishme ekonomike për rajonin.	- Infrastruktura në kushte të këqija e rrjetit të rrugëve rurale dhe dytësore, si dhe e hekurudhave; - Kosto e lartë e mirëmbajtjes dhe buxhetet e kufizuara në dispozicion; - Besueshmëria e ulët dhe mungesa e furnizimit me energji elektrike, të cilat varen shumë nga burimet hidrike (AL); - Infrastruktura e varfër dhe kapacitete të pamjaftueshme për trajtimin e ujit, ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta, veçanërisht në zonat rurale; - Aplikimet e pasaktë të standardeve të planifikimit urban; - Aksesi i kufizuar në internet.	- Programet për përmirësimin e rrjeteve rrugore dhe hekurudhore që lidhin Malin e Zi dhe Shqipërinë; - Menaxhimi i planeve dhe fondeve ekzistuese (BE, bankat evropiane etj.) dhe sistemet e ujërave të zeza; - Lëvizja më e lehtë e njerëzve dhe e mallrave nëpërmjet rrugëve të përmirësuara (duke përfshirë edhe ato të rihapurat) dhe pikave të reja ndërkufitare; - Rritja e investimeve në furnizimin me ujë, sistemin e kanalizimeve dhe trajtimin e mbeturinave për përmirësimin e mbetjeve të ngurta; - Potenciali për rritjen e transportit detar; • Zhvillimi i prodhimit të energjisë alternative; • Përmirësimi i aksesit në internet.	•Burimet e kufizuara financiare vonojnë investimet në infrastrukturën publike dhe veçanërisht në mirëmbajtje; - Burimet financiare të pamjaftueshme për rindërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së përkeqësuar lokale; - Ndërtimet e paligjshme, që ushtrojnë presion shtesë mbi zhvillimin e infrastrukturës në zonën e programit; - Çështjet e pazgjidhura të pronësisë që pengojnë investimet në infrastrukturë; - Planifikimi urban i pazhvilluar, duke përfshirë planifikimin e qëndrueshëm të mjeteve të transportit publik dhe privat.

	PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA	MUNDËSITË	KËRCËNIMET
INKURAJIMI I TURIZMIT DHE TRASHËGIMIA KULTURORE & NATYRORE	- Klima e këndshme mesdhetare dhe klima kontinentale japin mundësinë për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në të gjithë zonën e programit; - Natyra e pasur dhe e shumëllojshme, shumë e përshtatshme për aktivitete në natyrë; - Trashëgimia e pasur kulturore dhe historike; - Shoqatat e shumta komunitare të përfshira në aktivitete për të ruajtur kulturën dhe natyrën; - Diversiteti multikulturor dhe traditat në shkëmbimet kulturore; - Traditat e pasura të kulinarisë të përshtatshme për agroturizmin; - Eksperienca relativisht e gjatë në bregun e Malit të Zi me turizmin masiv.	- Infrastruktura e pazhvilluar e turizmit në pikëpamje të standardeve ndërkombëtare; - Zhvillimi i pabalancuar me mbizotërimin e turizmit bregdetar përkundrejt atij malor dhe agroturizmit; - Përpjekjet dhe financimi i pamjaftueshëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe të trashëgimisë historike dhe arkeologjike; - Njohja e kufizuar e potencialit të trashëgimisë historike dhe kulturore , si një burim i të ardhurave nëpërmjet aktiviteteve turistike dhe kulturore; - Aftësitë e kufizuara dhe niveli i dobët i shërbimeve në anën shqiptare; - Njohja e kufizuar në rang ndërkombëtar e rajonit si një destinacion turistik tërheqës.	- Nxitja e iniciativave për përfshirjen e mëtejshme të trashëgimisë kulturore në ofertën turistike; - Promovimi i traditës së veçantë të kulinarisë dhe produkteve agroushqimore për forcimin e identitetit dhe përvojën turistike të rajonit; - Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale vendore që lidhen me promovimin e turizmit, kulturës dhe aseteve tradicionale; - Zhvillimi i ekoturizmit të lidhur me eksperiencat në natyrë si pjesë e një pakete të integruar (p.sh. alpinizëm, rafting etj., çiklizëm); - Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive turistike për të ofruar paketa të integruara turistike përtej kufirit.	- Promovimi i pamjaftueshëm i turizmit, si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal, për shkak të mungesës së financimit; - Ndotja e mjedisit në zonat me potencial të lartë për ekoturizëm; - Mungesa e të kuptuarit të potencialit të trashëgimisë kulturore dhe historike të zonës së programit; - Mungesa e mbrojtjes së duhur të monumenteve dhe vendeve kulturore dhe historike; - Ndërtimet e paligjshme në afërsi të bregut të detit, parqeve natyrore dhe vendeve të trashëgimisë kulturore.

INVESTIME PËR TË RINJTË, ARSIMIN DHE AFTËSITË	- Popullsia relativisht e re dhe shkalla e lartë e lindjeve; - Prania e lartë e universiteteve publike dhe private; - Multietniciteti si një avantazh për zhvillimin social dhe kulturor; - Ekzistenca e ofruesve të trajnimeve profesionale dhe joformale; - Mjedisi shumëgjuhësh; - Një brez i ri entuziast i etur për të mësuar dhe për t'u zhvilluar.	- Kurrikula jo në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe orientimi profesional në drejtim të punësimit jo efikas; - Sistemi i pazhvilluar i arsimit gjatë gjithë jetës; - Niveli i ulët i arsimit të popullsisë rurale dhe grupeve të margjinalizuara të shoqërisë, siç janë komuniteti Rom, Ashkali etj.; - Niveli i braktisjes shkollore gjatë arsimit fillor dhe të mesëm, si rezultat i arsimit të dobët të ofruar, veçanërisht në disa zona rurale.	- Përmirësimi i nivelit të arsimit profesional për t'i shërbyer më mirë nevojave të tregut të punës me aftësitë e nevojshme; - Zhvillimi i aktiviteteve të kërkimit shkencor dhe zhvillimit, duke përdorur kërkimet ekzistuese dhe qendrat e arsimit të lartë; - Përdorimi i internetit në mënyrë që të përmirësojë aksesin në arsim në zonat rurale dhe rritjen e kontakteve dhe bashkëpunimit ndërkufitar virtual.	- Aksesi i kufizuar i popullsisë rurale në sistemin arsimor për shkak të varfërisë; - Infrastruktura e dobët ose inekzistente e TIK në zonat rurale, e cila rrit pabarazitë rajonale; •Migrimi i të rinjve për shkak të mungesës së mundësive.

	PIKAT E FORTA	**PIKAT E DOBËTA**	**MUNDËSITË**	**KËRCËNIMET**
PROMOVIMI I QEVERISJES LOKALE DHE RAJONALE, PLANIFIKIMI & NGRITJA E KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE	- Dalja e protokollit të bashkëpunimit midis vendeve; - Ekzistenca e strategjisë së zhvillimit rajonal; - Ekzistenca e planit të zhvillimit rajonal; - Procesi i decentralizimit në vazhdim e sipër.	- Kapacitetet e kufizuara të njësive të qeverisjes vendore për zbatimin e politikave të zhvillimit; - Burimet e pamjaftueshme financiare për të financuar objektivat e zhvillimit; - Mungesa e njohurive të duhura nga ana e administratës lokale për të përfituar dhe zbatuar fondet e BE.	- Pjesëmarrja e njësive të qeverisjes vendore në nismat apo programet për rritjen e kapaciteteve të përbashkëta institucionale.	- Njësitë e qeverisjes vendore financiarisht të dobëta; - Mungesa e financimit për trajnimin e administratës së Pushtetit Lokal për të rritur mundësinë e politikë-bërjes dhe kapacitetet zbatuese; - Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave rajonale përkatëse.

FORCIMI I KËRKIMIT SHKENCOR, ZHVILLIMI TEKNOLOGJIK, INOVACIONI DHE TIK	- Prania e universiteteve publike dhe private në zonën e programit; - Rritja e përqindjes së popullsisë që përdor në mënyrë aktive teknologjinë TIK.	- Kërkimet dhe praktikat novatore të universiteteve dhe operatorëve të tjerë në zonën e programit, të varfra; - Depërtimi modest në internet; - Arsimimi i dobët kompjuterik; - Teknologjia e informacionit dhe komunikimit e përdorur nga ana e universiteteve, shkollave dhe bizneseve, e dobët.	- Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve ndërkufitare të TIK; - Investimet në TIK dhe programet e kërkimit dhe zhvillimit që do të përshtaten me nevojat e zhvillimit të sektorit privat; - Forcimi i kërkimit shkencor, teknologjik dhe novatore në zonën e programit; - Programet e shkëmbimit të studentëve.	- Mungesa e strategjive kombëtare për promovimin e TIK, kërkimin shkencor & zhvillimin; - Burime financiare të kufizuara për kërkimin shkencor dhe zhvillimin; - Interesi i pamjaftueshëm i sektorit privat për zhvillimin teknologjik dhe modernizimin e proceseve të prodhimit.

Marrëveshja e Financimit IPA II, Programet Vjetore të Veprimit BNK – Shtojca II- Kushtet e Përgjithshme v. 3.1 Shtator 2018

SHTOJCA II
KUSHTET E PËRGJITHSHME

Përmbajtja

SHTOJCA II – KUSHTET E PËRGJITHSHME 1
Pjesa e parë: Dispozita të përgjithshme
Neni 1 – Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues
Neni 2 – Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta
Neni 3 – Kërkesat e raportimit
Neni 4 – Vizibiliteti dhe komunikimi 3
Neni 5 – Të drejtat e pronësisë intelektuale
Neni 6 – Pranueshmëria e shpenzimeve
Pjesa e dytë: Dispozitat e zbatueshme të menaxhimit të tërthortë nga përfituesi i IPA-së II
Neni 7 – Parime të përgjithshme
Neni 8 – Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve 4
Neni 8 – Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi
Neni 9 – Kontrollet paraprake mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet paraprake të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga Komisioni
Neni 10 – Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostot e njohura
Neni 11 – Dispozita për pagesat e bëra nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti
Kontraktues
Neni 12 – Ndërprerja e pagesave
Neni 13 – Kthimi i fondeve
Pjesa e tretë: Dispozitat përfundimtare
Neni 14 – Konsultimi ndërmjet përfituesve të IPA II dhe Komisionit
Neni 15 – Amendimi i kësaj marrëveshjeje financimi
Neni 16 – Pezullimi i kësaj marrëveshjeje financimi

Neni 17 – Përfundimi i kësaj marrëveshjeje financimi
Neni 18 – Rregullimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Periudha e ekzekutimit, periudha e zbatimit operacional dhe afati kontraktues

1. Periudha e ekzekutimit është periudha gjatë së cilës zbatohet Marrëveshja e Financimit dhe përfshin periudhën operative të zbatimit, si dhe një fazë të mbylljes. Kohëzgjatja e periudhës së ekzekutimit është e përcaktuar në nenin 2(1) të Kushteve të Veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Periudha e zbatimit operacional është periudha në të cilën kanë përfunduar të gjitha aktivitetet operative të mbuluara nga prokurimi dhe kontratat e grantit të Programit të Veprimit. Kohëzgjatja e kësaj periudhe është përcaktuar në nenin 2(2) për Kushtet e Veçanta dhe do të fillojë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi;

3. Periudha operacionale e zbatimit dhe ekzekutimit duhet të respektohet nga Autoriteti Kontraktues në mbyllje dhe zbatim të prokurimit dhe kontratave të granteve, në kuadër të kësaj marrëveshjeje financiare.

4. Kostot që lidhen me projektet e këtij Programi Veprimi do të jenë të pranueshme për financimin e BE-së vetëm nëse janë kryer gjatë periudhës së zbatimit operativ.

5. Prokurimet, kontratat e grantit dhe marrëveshjet e kontributit do të përfundojnë maksimumi brenda tre vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes Financiare, përveç:

a) amendimeve në kontratat e prokurimeve, kontratat e granteve dhe marreveshjet e kontributeve tashmë të lidhura;

b) kur kontratat individuale të prokurimit përfundojnë pas një ndërprerjeje të parakohshme të kontratës ekzistuese të prokurimit;

c) kontratave që lidhen me auditimin dhe vlerësimin, të cilat mund të jenë të nënshkruara pas zbatimit operacional;

d) ndryshimi i subjektit të ngarkuar zbatimin e detyrave.

6. Kur një kontratë granti ose prokurimi nuk ka sjellë asnjë pagesë brenda dy viteve nga nënshkrimi i saj, do të ndërpritet automatikisht dhe fondet e saj do të bllokohen, me përjashtim të çështjeve gjyqësore pranë gjykatave ose në organet e arbitrazhit.

Neni 2
Përfituesit e IPA II dhe detyrat e tyre të përbashkëta

1. Siç parashikohet në nenin 76(3)Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë ngushtë dhe duhet të përmbushin bashkërisht në veçanti funksionet e mëposhtme dhe të marrin përsipër përgjegjësitë e mëposhtme:

a) përgatisin programet e bashkëpunimit ndërkufitar në përputhje me nenin 68 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse ose rishikimet e tyre;

b) sigurojnë pjesëmarrjen në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit (KPM), mbledhje dhe takime të tjera dypalëshe;

c) emërojnë përfaqësuesin e tyre në KPM;

d) krijojnë Sekretariatin e Përbashkët Teknik (SPT) dhe sigurohen që ajo të ketë stafin e duhur;

e) përgatisin dhe zbatojnë vendimet strategjike të KPM;

f) mbështesin punën e KPM-së dhe sigurojnë informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e veta, në veçanti të dhënat që lidhen me ecurinë e programit operativ në arritjen e objektivave

specifikë dhe synimeve për secilin nga prioritet tematike të përcaktuara në programin e bashkëpunimit ndërkufitar;

g) krijojnë një sistem për të mbledhur informacion të besueshëm mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

h) hartojnë raportet vjetore dhe finale të zbatimit siç janë përmendur në nenin 80 të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në përputhje me nenin 3;

i) të përgatisin dhe të zbatojnë një plan koherent për komunikim dhe vizibilitet;

j) të hartojnë një plan vjetor të punës për Sekretariatin e Përbashkët Teknik, të miratuar nga KPM-ja.

2. Me qëllim zbatimin e nenit 25 të Marrëveshjes Kuadër mbi Mbrojtjen e të Dhënave, të dhënat personale do të jenë:

- përpunuar në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;
- të mbledhura për qëllime të specifikuara, të qarta dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen më tej në atë mënyrë që është e papajtueshme me ato qëllime;
- të përshtatshme, të rëndësishme dhe të kufizuara në çka është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat përpunohen;
- të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara;
- përpunuar në atë mënyrë që garantojnë sigurinë e duhur të të dhënave personale dhe
- të mbajtura në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave jo më gjatë sesa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale.

Të dhënat personale të përfshira në dokumente që duhen mbajtur nga përfituesi i IPA II, në përputhje me nenin 8.5, duhet të fshihen pasi të kenë përfunduar afatet e përcaktuara në nenin 8.5.

Neni 3

Kërkesat e raportimit

1. Për qëllimet e kërkesave të raportimit të përcaktuara në nenin 80(1) të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse, strukturat operuese do të përdorin modelin e parashikuar në shtojcën III të kësaj Marrëveshje Financimi.

2. Për qëllim të kërkesave të përgjithshme të raportimit në Komision, të përcaktuara në nenin 58 të Marrëveshjes Kuadër dhe kërkesat specifike të raportimit nën menaxhimin e tërthortë të përcaktuara në nenin 59 (1) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse në raportin vjetor për zbatimin e asistencës IPA II, KKIPA (NIPAC) do të përdorë modelin e dhënë në Shtojcën IIIA të kësaj marrëveshjeje financimi.

3. Për qëllim të kërkesave specifike të raportimit sipas menaxhimit të tërthortë të përcaktuar në pikën "a", të nenit 59(2) të Marrëveshjes Kuadër mbi raportin vjetor financiar apo deklaratat, ZKA (NAO) si përfitues i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të përdorë modelin e parashikuar në Shtojcën IV të kësaj marrëveshjeje financimi.

4. Për qëllim të nenit 59 (4) të Marrëveshjes Kuadër, NIPAC (KKIPA) i përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i paraqesë Komisionit një raport përfundimtar mbi zbatimin e asistencës së IPA II të Programit të Veprimit jo më vonë se katër muaj pas disbursimit (pagesës) të fundit për kontraktuesit e saj ose përfituesit e granteve.

5. Për qëllim të nenit 59(6) të Marrëveshjes Kuadër, ZKA (NAO) i përfituesit IPA II ku është Autoriteti Kontraktues, do të sigurojë deri në datën 15 janar të vitit financiar vijues, në format elektronik, një kopje të të dhënave të mbajtura në sistemin e kontabilitetit, të krijuar sipas nenit 10(5). Kjo duhet të mbështetet nga një raport i nënshkruar i paauditуar përmbledhës financiar, në përputhje me pikën "c" të shtojcën IV.

Neni 4

Vizibiliteti dhe Komunikimi

1. Siç parashikohet në dispozitat e nenit 24(1), 76(3)(k), dhe nenit 78(8)(f) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II duhet të përgatisin një plan koherent të aktiviteteve të vizibilitetit dhe të komunikimit, të cilat do t'i paraqiten Komisionit për një marrëveshje, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje Financimi.

2. Këto aktivitete të vizibilitetit dhe komunikimit duhet të jenë në përputhje me Manualin e Komunikimeve dhe vizibilitetit për veprimet e jashtme të BE-së, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni, të cilat janë në fuqi në kohën e aktiviteteve.

Neni 5
Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. Kontratat e financuara sipas kësaj Marrëveshje Financimi, duhet të garantojnë që përfituesit e IPA II të fitojnë të gjitha të drejtat e nevojshme të pronësisë intelektuale në lidhje me teknologjinë e informacionit, studimet, skicat, planet, publicitetin dhe çdo material tjetër të përgatitur për qëllime të planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit.

2. Përfituesi IPA II ku ndodhet Autoriteti Kontraktues, do të garantojë që Komisioni ose personi i autorizuar nga Komisioni dhe vendi tjetër përfituesi IPA II, do të kenë qasje dhe të drejtën për të përdorur një material të tillë. Komisioni do ta përdorë një material të tillë vetëm për qëllimet e veta.

Neni 6
Pranueshmëria e shpenzimeve

1. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të pranueshme për financim sipas kësaj Marrëveshje Financimi:

a) borxhet dhe pagesat e shërbimit të borxhit (interesi);

b) provizionet për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen;

c) kostoja e deklaruar nga përfituesi/t dhe e financuar nga një veprim apo program pune që merr një grant nga Bashkimi;

d) humbjet e këmbimit valutor;

e) kreditë për palët e treta;

f) gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor.

2. Blerja e tokës që nuk është e ndërtuar dhe e tokës me ndërtim në shumën deri 10% të totalit të shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë, do të jetë e ligjshme/e pranueshme për financim sipas asistencës për bashkëpunim ndërkufitar IPA II, nëse është e justifikuar nga natyra e veprimit dhe të dhënat në shtojcën I.

PJESA E DYTË
DISPOZITAT E ZBATUESHME TË MENAXHIMIT TË TËRTHORTË NGA PËRFITUESI IPA II

Neni 7
Parime të përgjithshme

1. Qëllimi i pjesës së dytë është të vendosë rregullat për zbatimin e Programit të Veprimit nën menaxhimin e tërthortë dhe në veçanti rregullat që lidhen me detyrat që i janë besuar zbatimit të buxhetit, siç përshkruhet në Shtojcën I dhe për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni në kryerjen e këtyre detyrave.

2. Siç parashikohet në pikën "b" të nenit 76(3) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, përfituesit e IPA II, bashkërisht, duhet të përgatisin një marrëveshje dypalëshe dhe të sigurojnë zbatimin e saj.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoritet Kontraktues, do të bashkëpunojë me përfituesin e IPA II që është Autoritet Kontraktues, për të siguruar se detyrat në vijim janë plotësuar:

a) të kryejë ndjekjen operative dhe menaxhimin e operacioneve, siç parashikohet në pikën "b" të nenit 76(4) të Marrëveshjes Kuadër;

b) të kryejë verifikime në përputhje me nenin 76(5) të Marrëveshjes Kuadër;

c) të mbrojë interesin financiar të Bashkimit, siç parashikohet në nenin 51 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8

Procedurat e dhënies së prokurimit dhe granteve

1. Detyrat e përmendura në nenin 7(3) duhet të kryhen nga përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, në përputhje me procedurat dhe dokumentet standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e prokurimit dhe kontratave të granteve, në veprimet e jashtme, të cilat janë në fuqi në kohën e fillimit të procedurës në fjalë (PRAG), si dhe në përputhje me standardet e kërkuara të Vizibilitetit dhe Komunikimit, të përmendura në Nenin 4(2).

2. Në përputhje me nenin 18(2) të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni do të pajisë përfituesin e IPA-II që është Autoritet Kontraktues, me udhëzime të mëtejshme për përshtatjen e procedurave dhe dokumenteve standarde, të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe granteve në veprimet e jashtme, në rastin specifik të bashkëpunimit ndërkufitar.

3) Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të kryejë procedurat e prokurimit dhe dhënies së grantit, të lidhë kontratat që pasojnë dhe të sigurojë që të gjitha dokumentet përkatëse për gjurmët e auditimit janë në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje Financimi. Në zbatim të pjesës së dytë të kësaj Marrëveshjeje Financimi, çdo referencë për kontratat e granteve duhet të përfshijë gjithashtu kontratën e kontributit dhe çdo referencë për përfituesit e granteve do të përfshijë edhe organizatat që kanë nënshkruar marrëveshje kontributi.

4. Përfituesit e IPA II do të bashkëpunojnë plotësisht në ngritjen e komisioneve të vlerësimit, siç parashikohet në pikën "a" të nenit 76(4) i Marrëveshjes Kuadër përkatëse.

5. Përfituesi i IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të mbajë të gjitha dokumentet mbështetëse financiare dhe kontraktuale përkatëse, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financiare ose nga një datë më e hershme, në rast se procedurat e prokurimit, thirrjet për projekt propozime, ose procedurat e dhënies së granteve të drejtpërdrejta, kanë filluar para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje të Financimit:

a) Për procedurat e prokurimit në veçanti:

a) Njoftim i mëparshëm me dëshminë e publikimit të njoftimit të prokurimit dhe të çdo korrigjimi;

b) Caktimi i panelit të zgjedhur;

c) Raporti i listës së të përzgjedhurve (duke përfshirë anekset) dhe aplikimet;

d) Dëshmi e publikimit të njoftimit të listës së përzgjedhurve

e) Letra e kandidatëve jo-të përzgjedhur;

f) Ftesë për tender ose ekuivalente e saj;

g) Dosja e tenderit, duke përfshirë anekset, sqarime, procesverbalet e mbledhjeve, dëshmitë e publikimit;

h) Caktimi i komisionit të vlerësimit;

i) Raporti për hapjen e tenderave, duke përfshirë anekset;

j) Raporti i vlerësimit/negocimit, duke përfshirë anekset dhe ofertat e pranuara;[1]

[1] Eliminimi i ofertave të pasuksesshme pesë vjet pas mbylljes së procedurës së prokurimit.

k) Letra e njoftimit;

l) Shkresë për dorëzimin e kontratës;

m) Letrat për kandidatët e pasuksesshëm;

n) Dhënia /njoftimi i anulimit, përfshirë dëshminë e publikimit;

o) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë, raportet e zbatimit, dhe korrespondenca përkatëse.

b. Për thirrjet për propozime dhe dhënien e drejtpërdrejtë të granteve në veçanti:

a) Emërimi i komisionit të vlerësimit;

b) Raporti i hapjes dhe raporti administrativ, duke përfshirë shtojcat dhe aplikimet e marra;[1]

c) Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm, pas vlerësimit të koncept note;

d) Raporti i vlerësimit të koncept notes;

e) Raporti i vlerësimit të aplikimit të plotë ose raportit të negocimit me shtojcat përkatëse;

f) Kontrolli i pranueshmërisë dhe dokumentet e tjera shoqëruese;

g) Letrat për aplikantët e suksesshëm dhe të pasuksesshëm me listën e miratuar rezervë, pas vlerësimit të aplikimit të plotë;

h) Shkresa përcjellëse për dorëzimin e kontratës së grantit;

i) Dhënia/njoftimi i anulimit, me dëshmi të publikimit;

j) Kontratat e nënshkruara, ndryshimet, dispozitat shtesë dhe korrespondencat përkatëse.

Përveç kësaj, dokumentet financiare dhe kontraktuale të përmendura në paragrafin 5(a) dhe (b) të këtij neni, do të plotësohen nga të gjitha dokumentet e tjera shoqëruese përkatëse, siç kërkohen nga procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe të gjithë dokumentacionin përkatës në lidhje me pagesat, rikuperimin dhe shpenzimet operative, për shembull raportet e projektit dhe raportet e kontrolleve në vend, pranimi i furnizimeve dhe punëve, sigurimet dhe garancitë, raportet e inxhinierëve të mbikëqyrjes.

Të gjitha dokumentet përkatëse financiare dhe kontraktuale do të mbahen për të njëjtën kohëzgjatje, në përputhje me nenin 49 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 8a

Detyrimi për të informuar, sanksionet administrative dhe mosveprimi

1. Gjatë zbatimit të procedurave dhe dokumenteve standarde të përcaktuara dhe të publikuara nga Komisioni për dhënien e kontratave të prokurimit dhe grantit, përfituesi i IPA II do të sigurojë që asnjë kontratë e prokurimit ose grantit të financuar nga BE nuk i jepet një operatori ekonomik ose aplikanti për grante, nëse operatori ekonomik ose kërkuesi i grantit, personalisht ose një person me kompetenca të përfaqësimit, vendimmarrjes ose kontrollit mbi të, ndodhet në një nga situatat e përjashtimit të parashikuara në procedurat përkatëse dhe dokumentet standarde të Komisionit.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të informojë Komisionin, kur një kandidat, ofertues ose aplikant ndodhet në një situatë përjashtimi nga pjesëmarrja në procedurat e dhënies së prokurimit dhe grantit, ka kryer parregullsi dhe mashtrime ose është konstatuar në shkelje të rëndë të detyrimeve të tij kontraktuale.

3. Përfituesi IPA II që është Autoritet Kontraktues, do të marrë parasysh informacionin përfshirë në Sistemin e Zbulimit të Parakohshëm dhe të Përjashtimit (EDES) të Komisioni, kur nënshkruan kontrata të prokurimit dhe granteve. Aksesi në informacione mund të sigurohet përmes pikës/ve së ndërlidhjes ose nëpërmjet konsultimeve me mënyrat e mëposhtme: (Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin, nëpunësi i kontabilitetit të

[1] Eliminimi i aplikimeve të pasuksesshme tre vjet pas përfundimit të procedurës së grantit.

Komisionit, BRE2-13/505, B-1049 Bruksel, Belgjikë dhe me *email:* BUDG-C01-EXCL-DB@ec.europa.eu bashkë me adresën e Komisionit, të identifikuar në nenin 3 të Kushteve të veçanta).

4. Kur përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, është në dijeni për një situatë përjashtimi në zbatimin e detyrave të përshkruara në shtojcën I, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i vendosë një operatori ekonomik ose aplikuesi granti përjashtimin nga procedurat e ardhshme të prokurimeve dhe dhënies së granteve. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, gjithashtu mund të vendosë një penalitet financiar proporcional me vlerën e kontratës në fjalë. Përjashtimet dhe/ose penalitetet financiare do të vendosen pas një procedure për gjetjen dhe paraqitje e provave që siguron të drejtën e mbrojtjes së personit në fjalë. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, njofton Komisionin në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni.

5. Në lidhje me paragrafin 4 të këtij neni, përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, konsiderohet që ndodhet në një situatë mosveprimi, nëse nuk vendos përjashtim dhe/ose një penalitet financiar ndaj operatorit ekonomik ose kërkuesit të grantit.

6. Në rastin e mosveprimit, përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të njoftojë Komisionin për të shpjeguar arsyet për mosveprimin e tij. Komisioni ruan të drejtën për të përjashtuar një operator ekonomik ose një aplikues granti nga procedurat e ardhshme të financimit të BE-së dhe/ose të vendosë një penalitet financiar ndaj operatorit ekonomik ose kërkuesit të grantit ndërmjet 2% dhe 10% të vlerës totale të kontratës në fjalë.

Neni 9

Kontrollet *ex ante* mbi procedurat e granteve dhe prokurimeve dhe kontrollet *ex post* të kontratave dhe granteve që do të kryhen nga Komisioni

1. Komisioni mund të ushtrojë kontrolle paraprake *(ex ante)* për tenderimin e kontratave, hapjen e thirrjeve për propozime dhe dhënien e kontratave dhe granteve për fazat e mëposhtme të prokurimit ose dhënies së granteve:

a) për miratimin e njoftimeve të kontratës për prokurim, programet e punës për thirrjet për propozime dhe çdo korrigjim të tij;

b) për miratimin e dosjeve të tenderit dhe udhëzimeve për aplikantët për grante;

c) për miratimin e përbërjes së Komisioneve të Vlerësimit;

d) për miratimin e raporteve të vlerësimit dhe vendimet e dhënies së kontratës[1];

e) për miratimin e dosjeve të kontratës dhe shtesën e kontratës.

2. Lidhur me kontrollin paraprak, komisioni duhet të vendosë:

a) të kryejë kontrolle paraprake (*ex-ante)* për të gjitha dosjet, ose

b) të kryejë kontrolle paraprake *(ex-ante)* në përzgjedhjen e këtyre dosjeve ose

c) të heqë dorë plotësisht nga kontrollet paraprake *(ex-ante).*

3. Nëse Komisioni vendos për të kryer kontrolle paraprake *(ex-ante)* në përputhje me paragrafin 2, shkronjat (a) ose (b) të këtij neni, ai duhet të informojë përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktuespër dosjet e përzgjedhura për kontroll. . Përfituesi i IPA II do të japë të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se një dosje është përzgjedhur për kontroll paraprak maksimumi në kohën e dorëzimit të njoftimit të kontratës ose programit të punës për publikim.

4. Komisioni mund të vendosë për të kryer kontrolle të mëpasshme (*ex-post),* duke përfshirë auditimet dhe kontrollet në vend, në çdo kohë, për kontrtat ose grantet e dhëna nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues që rrjedhin nga kjo Marrëveshje Financimi. Përfituesi i IPA II do të të vërë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për Komisionin, pasi të informohet se kjo dosje është përzgjedhur për kontroll të mëpasshëm (*ex*

[1] Për kontratat e shërbimit këta hapa përfshijnë kontrollet paraprake në lidhje me miratimin e listës së përzgjedhur.

post). Komisioni mund të autorizojë një person ose njësi ekonomike për të kryer kontrolle *ex post* në emër të tij.

Neni 10

Llogaritë bankare, sistemet e kontabilitetit dhe kostoja e njohur

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Financimi, Fondi Kombëtar dhe struktura operative e përfituesit të IPA II që është Autoriteti Kontraktues për Programin e Veprimit, duhet të hapë të paktën një llogari bankare në Euro. Teprica përgjithshme bankare për Programin e Veprimit do të jetë shuma e tepricave në të gjitha llogaritë bankare të Programit të Veprimit, të mbajtura nga Fondi Kombëtar dhe të gjitha strukturat pjesëmarrëse që operojnë tek përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

2. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të përgatisë dhe dorëzojë në Komision planet e parashikimit të disbursimit për kohëzgjatjen e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit. Këto parashikime duhet të përditësohen për raportin vjetor financiar të përmendur në nenin 3(2) dhe për çdo kërkesë për fonde. Parashikimet do të bazohen në një analizë të dokumentuar dhe të detajuar (duke përfshirë kontraktimet e planifikuara dhe dhe pagesat e planifikuara për kontrata për dymbëdhjetë muajt në vijim), të cilat do të jenë në dispozicion të Komisionit në bazë të kërkesës.

3. Plani fillestar i parashikimit të disbursimit duhet të përmbajë përmbledhjen e parashikimit vjetor të disbursimit për të gjithë periudhën e zbatimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për dymbëdhjetë muajt e parë të Programit të Veprimit. Planet e mëvonshme duhet të përmbajnë përmbledhjen vjetore të parashikimeve të disbursimit për bilancin e periudhës së zbatimit të Programit të Veprimit dhe parashikimet mujore të disbursimit për katërmbëdhjetë muajt në vijim.

4. Përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, është i detyruar të krijojë dhe mirëmbajë një sistem të kontabilitetit në përputhje me pikën 2(3)(b) të shtojcës A të Marrëveshjes Kuadër, i cili do të mbajë të paktën informacionin për kontratat që menaxhohen nën Programin e Veprimit të treguar në shtojcën V.

5. Kostot e njohura në sistemin e kontabilitetit të mbajtur siç parashikohet në seksionin 4 të këtij neni, duhet të jenë kryer, paguar dhe pranuar dhe të korrespondojë me kostot aktuale të provuara nga dokumentet mbështetëse dhe të përdoren kur është e përshtatshme, për të nisur parafinancimin e paguar nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues sipas kontratave lokale.

6. Kostot e njohura në sistemin e kontabilitetit do të shfrytëzohet nga Komisioni për nevojat e tij gjatë provizionimit të njohjes së kostove, gjatë zbatimit të Programit të Veprimit (duke përfshirë autorizimin e parafinancimit që i paguhet përfituesit të IPA II i cili është Autoriteti Kontraktues) për procesin e miratimit për pagesat, autorizimin përfundimtar të procedurës së llogarive në fund të Programit të Veprimit, praktikat vjetore të ndërprera dhe çdo zbatim tjetër të menaxhimit dhe të vlerësimit të performancës.

7. Përfituesi i IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, do t'i sigurojë Komisionit raportet në vijim:

a) Raportin Përmbledhës – siç është përcaktuar në nenin 3(5);

b) Raportet vjetore siç janë përcaktuar në paragrafët 2 deri 4 të nenit 3;

c) Kërkesa për raportet e fondeve, siç përmenden në nenin 11.

Neni 11

Dispozita për pagesat e kryera nga Komisioni për përfituesit IPA II që është Autoriteti Kontraktues

1. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet të paraqesë parashikimin e tij fillestar të disbursimit (pagesës) për Programin e Veprimit, të përgatitur në përputhje me nenin 10 (2), me kërkesën e parë për pagesë të parafinancuar. Pagesa e parë e parafinancimit do të bëhet për 100% të pagesës së parashikuar për vitin e parë të planit të parashikuar për disbursim.

2. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, do të paraqesë kërkesa të vazhdueshme të pagesës së parafinancimit kur vlera e tepricës së përgjithshme bankare për Programin e Veprimit bie nën vlerën e pagesës së parashikuar për pesë muajt në vazhdim të Programit të Veprimit.

3. Çdo kërkesë për parafinancim shtesë do të mbështetet nga dokumentet e mëposhtme:

a) Një deklaratë përmbledhëse të të gjitha pagesave të kryera për Programin e Veprimit;

b) Tepricat bankare për Programin e Veprimit në datën e përcaktuar të kërkesës;

c) Një parashikim të pagesave për Programin e Veprimit për katërmbëdhjetë muajt në vazhdim në datën e përcaktuar të kërkesës.

4. Përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, mund të kërkojë për çdo parafinancim pasues, shumën e totalit të disbursimeve të parashikimit për katërmbëdhjetë muaj, pas datës së përcaktuar të kërkesës, përveç balancës referuar në nenin 3(b) të këtij neni në datën e përcaktuar të kërkesës edhe fonde të rritura nga ndonjë shumë e financuar nga përfituesi IPA II sipas paragrafit 5 të këtij neni dhe që nuk është rimbursuar ende.

Komisioni gëzon të drejtën për të reduktuar çdo pagesë pasuese të parafinancimit, nëse tepricat totale bankare të mbajtura nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues në këtë program dhe në të gjitha programet e tjera të IPA I apo IPA II që menaxhohen nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, tejkalon parashikimin e disbursimit për katërmbëdhjetë muajt e ardhshëm.

5. Në rastet kur pagesa është reduktuar sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, duhet ta financojë programin nga burimet e veta, deri në shumën e reduktimit. Përfituesi i IPA II që është autoriteti kontraktues, më pas mund të kërkojë rimbursimin e këtij financimi, si pjesë e kërkesës së ardhshme për fonde të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Komisioni ka të drejtë për të rikuperuar balancat e tepërta bankare, të cilat kanë mbetur të papërdorura për më shumë se dymbëdhjetë muaj. Para se të ushtrojë këtë të drejtë, Komisioni e fton përfituesin e IPA II që është Autoriteti Kontraktues, për të dhënë arsyet e vonesës në disbursimin e fondeve dhe të demonstrojë nevojën për to në vazhdim gjatë dy muajve të ardhshëm.

7. Interesi i gjeneruar nga llogaritë bankare të përdorura për këtë Program nuk njihet nga Komisioni.

8. Sipas nenit 33(4) të Marrëveshjes Kuadër, kur ndërprerja e afatit për kërkesën për pagesë tejkalon dy muaj, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë një vendim nga Komisioni, nëse ndërprerja e afatit duhet vazhdojë.

9. Pasqyra financiare përfundimtare e përmendur në nenin 37(2) të Marrëveshjes Kuadër do të dorëzohet nga NAO (ZKA) jo më vonë se 16 muaj pas përfundimit të periudhës së zbatimit operacional.

Neni 12

Ndërprerja e pagesave

1. Pa cenuar pezullimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshjeje Financimi përkatësisht sipas neneve 16 dhe 17 dhe në zbatim të nenit 39 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të ndërpresë pagesat pjesërisht ose plotësisht, në qoftë se:

a) Komisioni ka vendosur ose paraqet shqetësime serioze, pasi përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka bërë gabime të konsiderueshme, ka parregullsi apo mashtrime që vënë

në dyshim ligjshmërinë ose rregullsinë e transaksioneve në fjalë, në implementimin e Programit të Veprimit, ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare;

b) Komisioni ka vendosur ose paraqet shqetësime serioze, nëse përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues ka kryer gabime sistemike ose të përsëritura, ose ka parregullsi, mashtrime apo shkelje të detyrimeve në këtë ose në të tjera Marrëveshje Financimi, me kusht që ato gabime, parregullsi, mashtrime, ose shkelje të detyrimeve të kenë ndikim material në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Financiare apo vënë në dyshim besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të përfituesit të IPA II ose ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve bazë.

Neni 13
Kthimi i fondeve

1. Përveç rasteve të përmendura në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër, Komisioni mund të rimarrë fondet nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, siç parashikohet në Rregulloren Financiare, veçanërisht në rast se:

a) Komisioni vlerëson se objektivat e Programit të Veprimit të përcaktuara në Shtojcën I nuk janë arritur;

b) shpenzimet janë të papranueshme;

c) shpenzimet janë shkaktuar si rezultat i gabimeve, parregullsive, mashtrimeve apo shkeljeve të detyrimeve në zbatimin e Programit të Veprimit, në veçanti në procedurën e prokurimit dhe dhënies së granteve.

2. Në përputhje me legjislacionin kombëtar, përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues do të rimarrë kontributin e Bashkimit që i paguhet përfituesit të IPA II i cili është Autoriteti Kontraktues nga marrësit të cilët ndodhen në një prej situatave të përcaktuara në paragrafin 1 pika b) ose c) të këtij neni ose të referuara në nenin 41 të Marrëveshjes Kuadër. Fakti se përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues nuk ka sukses në kthimin e të gjithë ose një pjese të fondeve nuk do ta pengojë Komisionin për rikuperimin e fondeve nga përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues.

3. Përfituesi i IPA II që nuk është Autoriteti Kontraktues, do të bëjë përpjekje maksimale për të mbështetur përfituesin e IPA-II që është Autoriteti Kontraktues, në rikuperimin e fondeve, kur përfituesi është i vendosur në territorin e tij. Marrëveshja për rikuperimin do të parashikohet në marrëveshjen dypalëshe që do të lidhet në përputhje me nenin 69 të Marrëveshjeve Kuadër përkatëse.

4. Shumat e paguara padrejtësisht apo të kthyera nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues, shumat e garancive financiare, performancës dhe parafinancimit, të paraqitura në bazë të procedurave të prokurimit dhe dhënies së granteve, shumat nga gjobat e vendosura nga përfituesi IPA II që është Autoriteti Kontraktues për kandidatët, ofertuesit, aplikantët, kontraktuesit ose përfituesit e granteve, të paguara për përfituesit e IPA II që është Autoriteti Kontraktues, ose do të ripërdoren për Programin e Veprimit, ose do t'i kthehen Komisionit.

PJESA E TRETË
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14
Konsultime ndërmjet përfituesve të IPA II dhe Komisionit

1. Përfituesit e IPA II dhe Komisioni do të konsultohen me njëri tjetrin para se të krijojnë mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin ose interpretimin e mëtejshëm të kësaj Marrëveshjeje Financimi, në përputhje me nenin 18 të këtyre Kushteve të Përgjithshme.

2. Kur Komisioni vihet në dijeni për problemet në kryerjen e procedurave që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshje Financimi, ai duhet të krijojë të gjitha kontaktet e nevojshme me përfituesit e IPA II për të korrigjuar situatën dhe ndërmarrë hapat e nevojshëm.

3. Konsultimi mund të çojë në një ndryshim, në pezullimin ose përfundimin e kësaj Marrëveshje Financimi.

4. Komisioni do të informojë rregullisht përfituesit e IPA II për zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në shtojcën I, të cilat nuk përfshihen në pjesën e dytë të këtyre kushteve të përgjithshme.

Neni 15

Ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Çdo amendim i kësaj Marrëveshje Financimi duhet të bëhet me shkrim, duke përfshirë dhe shkëmbimin e shkresave.

2. Nëse përfituesit e IPA II, kërkojnë një amendim, kërkesa duhet t'i paraqitet bashkërisht Komisionit të paktën gjashtë muaj para se ndryshimi që kërkohet të hyjë në fuqi.

3. Komisioni mund të amendojë *dokumentet model* në shtojcën III, IIIA, IV dhe V, pa nevojën e një amendimi të kësaj Marrëveshje Financimi. Përfituesit e IPA II do të informohen me shkrim për çdo amendim të tillë dhe për hyrjen e tij në fuqi.

Neni 16

Pezullimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshje Financimi mund të pezullohet në rastet e mëposhtme:

a) nëse ndonjë përfitues IPA II shkel një detyrim sipas kësaj Marrëveshje Financimi.

b) nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues shkel ndonjë detyrim të përcaktuar në bazë të proçedurave dhe dokumenteve standarde të përmendura në nenin 18(2) të Marrëveshjes Kuadër përkatëse, pa cenuar dispozitat e nenit 8(2);

c) nëse përfituesi i IPA II që është Autoriteti Kontraktues, nuk i plotëson kërkesat për zbatimin e detyrave të besuara të buxhetit;

d) nëse përfituesit e IPA II nuk i përmbushin bashkërisht funksionet dhe përgjegjësitë e përmendura në nenin 2 (1) dhe kur është e mundur edhe menaxhimin e tërthortë sipas nenit 7(3);

e) Nëse ndonjë përfitues i IPA II vendos të pezullojë ose ndërpresë procesin e aderimit në BE;

f) Nëse ndonjë përfitues i IPA II shkel një detyrim në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe sundimin e ligjit, si dhe në raste të rënda të korrupsionit ose nëse përfituesi IPA II është fajtor për sjellje të rëndë profesionale të provuar me ndonjë mënyrë të justifikuar. Shkelje e rëndë profesionale nënkupton një nga sa më poshtë:

- shkelje e ligjeve ose rregulloreve në fuqi ose e standardeve etike të profesionit të cilit i përket një person ose subjekt; ose

- çdo sjellje e gabuar e një personi ose subjekti që ka ndikim në kredibilitetin e tij profesional, kur sjellja e tillë nënkupton qëllimin e gabuar ose neglizhencën e rëndë.

g) Në rastet e forcave madhore, siç përcaktohet më poshtë. "Forcë madhore" do të thotë çdo situatë e paparashikueshme dhe e jashtëzakonshme ose ngjarje përtej kontrollit të palëve, e cila pengon secilën prej tyre në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tyre, gjë që nuk i atribuohet gabimit ose neglizhencës nga ana e tyre (ose pjesës së kontraktuesve të tyre, agjentëve ose të punësuarve) dhe vërteton pakapërcyeshmërinë e situatës, pavarësisht se janë bërë përpjekjet e duhura. Defektet në pajisje ose materiale, ose vonesat e tyre të mundshme, mosmarrëveshjet e punës, grevat ose vështirësitë financiare nuk mund të përdoren si forcë madhore. Një palë nuk duhet të konsiderohet si shkelëse e detyrimeve të saj, nëse është penguar nga përmbushja e tyre për shkak të një force madhore për të cilën pala tjetër është informuar siç duhet. Një palë që

përballet me një forcë madhore duhet ta informojë palën tjetër pa vonesë, duke deklaruar natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektet e parashikueshme të problemit, dhe të marrë çdo masë për të minimizuar dëmet e mundshme.

Asnjëra prej palëve nuk do të konsiderohet përgjegjëse për shkelje të detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshje Financimi, nëse është penguar nga përmbushja e tyre nga forca madhore, me kusht që ajo palë të marrë masa për të minimizuar dëmtimet e mundshme.

2. Komisioni mund ta pezullojë këtë Marrëveshje Financimi pa njoftim paraprak.

3. Komisioni mund të marrë masat e duhura parandaluese para se të bëhet pezullimi.

4. Kur pezullimi është njoftuar, duhet të tregohen pasojat për prokurimet dhe kontratat e granteve dhe marrëveshjeve të kontributit që janë në vazhdim dhe për këto kontrata, duhet të tregohet marrëveshjet e kontributit që duhen nënshkruar.

5. Pezullimi i kësaj Marrëveshje Financimi nuk e cenon ndërprerjen e kësaj Marrëveshje Financimi nga Komisioni, në përputhje me nenin 17.

6. Palët do të rifillojnë zbatimin e Marrëveshjes së Financimit sapo kushtet ta lejojnë, me miratimin paraprak me shkrim të Komisionit. Kjo nuk cenon asnjë amendim të kësaj Marrëveshje Financimi që mund të jetë i nevojshme për të përshtatur Programin e Veprimit me kushtet e reja zbatuese, duke përfshirë, nëse është e mundur, zgjatjen e periudhës së zbatimit ose përfundimin e kësaj Marrëveshje Financimi në përputhje me nenin 17.

Neni 17

Përfundimi i kësaj Marrëveshje Financimi

1. Nëse çështjet të cilat çuan në pezullimin e Marrëveshjes së Financimit nuk janë zgjidhur brenda një periudhe maksimale 180-ditore, secila palë mund ta përfundojë Marrëveshjen e Financimit me njoftim 30 ditë para.

2. Kur ndërprerja është njoftuar, duhet të tregohen pasoja e prokurimeve dhe kontratave të granteve në vazhdim dhe kontratat ose grantet e tilla që duhen nënshkruar.

3. Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje Financimi nuk do të përjashtojë mundësinë e Komisionit që të kryejë korrigjime financiare në përputhje me nenet 43 dhe 44 të Marrëveshjes Kuadër.

Neni 18

Rregullimet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me Marrëveshjen e Financimit që nuk mund të zgjidhet brenda një periudhe gjashtëmujore nga konsultimet midis palëve, të parashikuar në nenin 14, mund të zgjidhet nga arbitrazhi me kërkesën e njërës prej palëve.

2. Secila palë do të caktojë një arbitër brenda 30 ditëve nga data e kërkesës për arbitrazh. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit (Hagë) të caktojë një arbitër të dytë. Të dy arbitrat, nga ana e tyre, caktojnë një arbitër të tretë brenda 30 ditëve. Nëse kjo nuk arrihet, secila palë mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit të caktojë arbitrin e tretë.

3. Përveç kur arbitrat vendosin ndryshe, do të zbatohen procedurat e parashikuara në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, rregullat opsionale për Arbitrazhin që përfshijnë organizatat ndërkombëtare dhe shtetet. Vendimet e arbitrave merren me shumicë brenda një periudhe tremujore.

4. Secila palë do të jetë e detyruar të marrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimit të arbitrave.

SHTOJCA III A

MODELI I RAPORTIMIT VJETOR

Periudha e mbuluar nga raporti:
1.1.20XX–31.12.20XX

Raport i lëshuar më XX.XX.20XX

Raport vjetor mbi zbatimin e asistencës IPA II nën menaxhim e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga [vendi] të paraqitur nga Koordinatori Kombëtar i IPA-së

I. Përmbledhje ekzekutive

1. Referencë e objektivave të Dokumenteve Strategjikë të Vendit dhe një pasqyrë e shkurtër e sfidave të sektorëve

2. Përfshirja në programim

3. Marrëdhëniet me Komisionin Evropian.

4. Problemet që hasen në përmbushjen e kushteve të nevojshme për zbatimin dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë, në lidhje me masat e marra/të planifikuara, rekomandimet për veprime të mëtejshme.

5. Çështje të rëndësishme që rrjedhin nga pjesëmarrja e përfituesit të IPA II në komitetin monitorues të IPA-së dhe në komisionet sektoriale të monitorimit (duke përfshirë Komitetin e Përbashkët të Monitorimit për BNK-në), nëse ka.

6. Përfshirja në veprimet shumëvendëshe dhe çdo çështje që ka lidhje me to.

7. Aktivitete monitorimi dhe vlerësimi, mësimet kryesore që janë nxjerrë dhe ndjekja e rekomandimeve.

8. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.

9. Koordinimi i donatorëve

Në rastet e menaxhimit të tërthortë, përmbledhja ekzekutive duhet të përmbajë, gjithashtu:

10. Zbatimin gjithëpërfshirës të asistencës së IPA-së nën menaxhim e tërthortë (maksimumi një faqe).

11. Problemet kryesore horizontale të hasura në zbatimin e asistencës së IPA-së dhe masat përkatëse të marra/planifikuara (maksimumi gjysmë faqe).

12. Rekomandimet për veprime të mëtejshme (maksimumi gjysmë faqe).

13. Auditimet – gjetjet kryesore, rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

II. Informacion sipas sektorëve

Titulli i sektorit[1]: [*Transporti*]

Pjesa përshkruese: përmbledhje mbi sektorin, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:

1. Përfshirja në programim;

2. Përmbledhje e rezultateve të arritura drejt një qasjeje të sektorit me të drejta të plota (d.m.th. objektivat e arritur sipas treguesve të sektorit në dokumentin e planifikimit të sektorit);

3. Koordinimi me instrumente të tjera dhe/ose donatorë/IFI-të brenda sektorit;

4. Ndikimi i veprimeve të IPA II brenda sektorit mbi zhvillimin e kapaciteteve përkatëse kombëtare administrative në atë sektor, në planifikimin strategjik dhe buxhetimin.

Nën menaxhim e tërthortë duhet të përfshihet dhe informacioni i mëposhtëm:

5. Struktura/t operuese dhe ndryshimet që kanë lidhje me to, nëse ka: [*Ministria e Transportit];*

6. Informacion mbi zbatimin e programeve në atë sektor;

7. Arritjet kryesore në atë sektor;

8. Çdo problem i rëndësishëm që haset gjatë zbatimit të detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat e marra/planifikuara në vijim;

9. Rekomandime për veprime të mëtejshme;

[1] Sipas sektorëve në dokumentet strategjike indikativë.

10. Aktivitetet monitoruese dhe vlerësuese të kryera, auditimet – gjetjet kryesore dhe mësimet e nxjerra, rekomandimet, ndjekja dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra.

Titulli i sektorit: Bashkëpunimi ndërkufitar[1]

1. Përfshirja në programim, sipas rastit.

2. Progresi i bërë në zbatimin e Programit Ndërkufitar dhe në veçanti në arritjen e objektivave specifikë, sipas prioriteteve tematike (duke përfshirë edhe elemente sasiore dhe cilësore që tregojnë progres në lidhje me objektivat).

3. Një përmbledhje e problemeve të hasura në zbatimin e programit të BNK-së dhe çdo veprim korrigjues i ndërmarrë, si dhe rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese.

4. Monitorimi, duke përfshirë edhe marrëveshjet për mbledhjen e të dhënave dhe kur është e zbatueshme dhe aktivitete vlerësimi.

5. Aktivitetet mbi komunikimin dhe vizibilitetin.

6. Koordinimi me vendin partner.

Nën menaxhim të tërthortë duhet të përfshihet edhe informacioni i mëposhtëm:

1. Struktura operuese ekzistuese dhe ndryshimet që kanë lidhje me të, nëse ka.

2. Çdo problem i rëndësishëm që haset në zbatimin e detyrave të besuara, p.sh. vonesat në kontraktim dhe masat pasuese të ndërmarra/planifikuara.

3. Rekomandime për veprime të mëtejshme

4. Auditimet e kryera – gjetjet kryesore dhe rekomandimet, si dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

[1] Për bashkëpunimin ndërkufitar kërkohet raportim specifik.

II a. Treguesit e performancës në sektorin [*p.sh. transporti*] që mbulon menaxhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

Treguesit[1] për program

Marrëveshja e Financimit /Referenca e Programit[3]	Treguesi për sektor [*Transporti*]	Burimi	Baza	Komponentët kryesorë (2017)	Objektivi (2020)	Vlera (2014[2])
2014 Programi i vendit	*Reduktimi i kohës mesatare të udhëtimit për udhëtarët ndërmjet qendrave kryesore urbane nga lloji i transportit*					
2014-20xx Programi shumëvjeçar	*Kosto të reduktuara transporti për njësi produkti*					

[1] Këto duhet të jenë kryesisht rezultati, si dhe treguesit përkatës të zgjedhur të produktit

[2] Numri i kolonave duhet të përshtatet për të gjitha vitet, nga viti 2014 deri në vitin e periudhës së raportimit. Vlerat duhet të jenë kumulative.

3 Ai duhet të jetë në përputhje me mënyrën e programimit (vjetore, shumëvjeçare me ose pa detyra të ndara), si dhe me raportin e NAO-s.

II b. Përmbledhje në nivel veprimi për sektorin [*p.sh. transportin*]

Marrëveshja e Financimit/Referenca e Programit	Projekti	Situata/Progresi për projekte të veçanta (p.sh. Termat e Referencës në përgatitjen për shpalljen e tenderit, kontraktimin, zbatimin, përfundimin)	Arritjet kryesore dhe vlerësimi i tyre	Probleme kryesore të hasura në zbatimin e detyrave të besuara dhe masat e marra/të planifikuara për kapërcimin e tyre	Zhvillimet që ndikojnë në zbatimin në të ardhmen	Rekomandime për veprime të mëtejshme korrigjuese
[2014 Programi i vendit]	*Elektrifikimi i linjës hekurudhore nga xxx në kufi me xxx*	*P.sh., Kontratë Shërbimi për përgatitjen e Termave të Referencës për punimet që kontrata është nënshkruar dhe po zbatohet, tender për kontratën e punimeve që do të fillojnë tremujorin e dytë të vitit 2015*		*P.sh., Kontrata e Shërbimit për përgatitjen e Termave të Referencës për punime që kontrata është vonuar, meqë procedura e negocimit dështoi dhe duhet të ri shpallet*	*P.sh., ndryshimi i ligjit të vendit, si dhe qasja me dhe zbatimi i paketës së katërt të hekurudhave*	

Nën menaxhim e tërthortë duhet të sigurohen dhe Shtojcat e mëposhtme:

Shtojca 1

Përmbledhje mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit (duke përfshirë ndryshimet në strukturën institucionale) (maksimumi një faqe).

Aktivitetet mbi transparencën, vizibilitetin, informacionin dhe komunikimin, në përputhje me MK (maksimumi një faqe)

Shtojca 2

Histori suksesi (Shënim. ky seksion mund të përdoret për raportin vjetor të asistencës financiare, i cili përgatitet nga Komisioni Evropian).

Shtojca 3

Plani vjetor i prokurimit

Shtojca e mëposhtme duhet të sigurohet si për menaxhimin e drejtpërdrejtë, ashtu dhe për atë të tërthortë:

Shtojca 4

Udhërrëfyesi i qasjes sektoriale – arritjet (duke theksuar nëse objektivat e planifikuar janë përmbushur ose jo).

SHTOJCA III
RAPORTI VJETOR I ZBATIMIT - MARRËVESHJA E FINANCIMIT IPA II BNK
Versioni janar 2018

MODEL
Raporti Vjetor i Zbatimit: <Viti>

Bashkëpunimi Ndërkufitar ndërmjet përfituesve të vendeve IPA II
(neni 80 i Marrëveshjes Kuadër)

Tabela e Përmbajtjes
Fjalori i akronimeve
1. Identifikimi
2. Pasqyrë e zbatimit të programit ndërkufitar
2.1 Analiza e progresit dhe arritjeve
2.2 Progresi i bërë në zbatimin e programit ndërkufitar
2.2.1 Analiza sasiore
2.2.2 Analiza cilësore
2.3 Informacion i detajuar mbi ekzekutimin financiar të programit ndërkufitar
2.4 Informacion mbi hapat e ndërmarrë nga struktura operuese dhe/ose nga komiteti përbashkët i monitorimit për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit
2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi
2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese
2.5 Vizibiliteti dhe publiciteti
2.6 Përdorimi i asistencës teknike
2.7 Ndryshimet në kontekstin e zbatimit të programit ndërkufitar
2.8 Ndërveprimet me sektorët e tjerë, politikat apo instrumentet
2.9 Historitë e suksesit

Fjalori i akronimeve
<…>

1. Identifikimi

PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR	Titulli i Programit: Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar <vendi A> – < vendi B>
	<Përfitimet/alokimet për vitin 20XX-20XX: <shuma, duke përfshirë Kontratën e Shërbimit të Asistencës Teknike (K.SH.A.T.) >
RAPORTI VJETOR MBI ZBATIMIN	Viti i Raportimit <nga 1 janari 20XX deri më 31 dhjetor 20XX >
	Përgatitur nga: <struktura operuese, vendi X> < struktura operuese, vendi Y>
	Data e shqyrtimit të raportit vjetor nga Komiteti i Përbashkët Monitorues: <data dhe lloji i procedurës së miratimit, p.sh. mbledhje apo me shkrim>
	Zona e lejueshme e Programit: <.....>

Baza ligjore: Neni 80 i Marrëveshjes Kuadër IPA II

SHTOJCA III
RAPORTI VJETOR I ZBATIMIT - MARRËVESHJA E FINANCIMIT IPA II BNK
Versioni janar 2018

2. Përmbledhje e zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

2.1 Arritjet dhe analiza e progresit

<*Përmbledhje e zbatimit të programit gjatë periudhës së mbuluar, të tilla si:*

1. Progresi me thirrjet për propozime:

- Numri i thirrjeve të planifikuara për t'u shpallur deri në fund të periudhës së programimit dhe kalendari i tyre;
- Situata e thirrjeve për propozime (numri i thirrjeve për propozime të hapura dhe në cilën datë, numri i thirrjeve për propozime të mbyllura dhe në cilën datë, kohëzgjatja e procesit të vlerësimit - kohëzgjatja totale dhe për secilin hap etj.);
- Analiza e procesit të vlerësimit (numri i aplikimeve të marra sipas llojit të përfituesit dhe vendit, numri i aplikimeve të refuzuara në secilën fazë të procesit të vlerësimit, arsyet më të zakonshme të refuzimit, lista e aplikimeve të refuzuara (shihni modelin e tabelës më poshtë);
- Lista e kontratave të nënshkruara (shihni modelin e tabelës më poshtë)
- Eventet e organizuara për ngritjen e kapaciteteve për aplikantët e ardhshëm dhe për përfituesit e granteve (numri i eventeve, numri i pjesëmarrësve sipas llojit të eventit për secilin vend, numri i kërkesave për informacion nga përfituesit e granteve të adresuara etj).
- Numri i takimeve të mbajtura dhe rezultateve të stafit të sekretariatit të përbashkët teknik dhe strukturave operuese; numri i takimeve të komitetit të përbashkët të monitorimit dhe rezultatet; numri i takimeve të strukturave operuese dhe rezultatet.>.

2. Progresi me projektet strategjike;

<N.q.s. është e zbatueshme, duke përfshirë gjithashtu informacion mbi rishikimin e programit 2014 -2020 ose mbi programimin e 2021- 2027.>

<Modeli i tabelës për kontratat BNK të nënshkruara dhe në zbatim gjatë periudhës raportuese:

Tabela nr. : XX> Lista e aplikimeve ndërkufitare të marra – të miratuara/ të refuzuara

Numri i thirrjes për propozime	*Prioriteti tematik*	*Titulli*	*Emri, lloji dhe vendi i origjinës i koordinatorit dhe partnerëve të përfshirë*	*Shuma e kërkuar e grantit të BE-së*	*Kontrolli administrativ (PO/JO)*	*Vlerësimi teknik* **(PO/JO)**	*E miratuar* **(PO/JO)**	*Arsyet e refuzimit*

Tabela nr. : XX> Lista e kontratave të nënshkruara ndërkufitare dhe nën zbatim

Prioriteti tematik: <...>						
Titulli dhe numri i kontratave	**Emri, lloji dhe vendi i origjinës së koordinatorit dhe partnerëve të përfshirë**	**Informacion i shkurtër i projektit**	**Data e fillimit dhe mbarimit**	**Kostoja totale e lejueshme dhe vlera e grantit të BE-së**	**Arritjet kryesore deri më sot**	**Komente >**

2.2 Progresi i realizuar gjatë zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

<Prezantim shumë i shkurtër i prioriteteve tematike dhe objektivave specifikë të Programit BNK, së bashku me një përmbledhje të progresit të bërë në zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe në veçanti të arritjeve lidhur me objektivat specifikë për çdo prioritet tematik (si edhe për prioritetin e AT-së), duke përfshirë elemente cilësore dhe sasiore, të cilat do të tregojnë progresin e realizuar lidhur me objektivat>.

2.2.1 Analiza sasiore

<Informacion mbi progresin e realizuar gjatë zbatimit të programit, duke pasqyruar dhe të dhëna sasiore, kur është e mundur, si dhe duke përdorur objektivat dhe indikatorët e përfshirë në program dhe në projekte.

Analiza e arritjeve të matura nga produktet, rezultatet dhe ndikimi, si dhe treguesit fizikë dhe financiarë. Treguesit do të ndahen sipas gjinisë, kur është e mundur.

Nëse shifrat (të dhënat) nuk janë ende të disponueshme, duhet siguruar informacion se kur do të jenë të disponueshme dhe kur do të përfshihen në raportin vjetor të zbatimit. Përveç kësaj, informacioni mund të paraqitet grafikisht.

<Modeli i tabelës së indikatorëve (rezultate, produkte dhe ndikimi), me një shembull për secilin prioritet të programit, objektivi specifik dhe rezultati:

Tabela nr.: XX Të dhënat e grumbulluara në nivel programi, bazuar në informacionin e mbledhur prej projekteve

Prioriteti tematik <…> **Objektivi specifik <…>** **Rezultati <…>**											
Emri dhe tipi[1]	**Përkufizimi**	**Baza**		**Arritjet**				**Synimi**		**Burimi i të dhënave**	**Mbledhja e të dhënave dhe shpeshtësia**
		Vlera	**Viti**	**Vlera**	**Viti**	**Vlera**	**Viti**	**Vlera**	**Viti**		
% e	**% e të**									**Shërbimi i**	**Përfituesit**

[1] Çdo indikator duhet të identifikohet si tregues ndikimi, rezultati ose produkti

studentëve të punësuar	**rinjve/rejave që kanë mbaruar arsimin e nivelit të dytë dhe punësohen brenda një viti pas përfundimit të shkollimit**	**50%**	**2017**	**60%**	**2019**	**65%**	**2021**	**70%**	**2023**	**statistikave të punësimit publik**	**e granteve Raport tremujor**

Analiza cilësore

<Analizë cilësore e progresit (përparimet konceptuale dhe përsosja e ndërhyrjeve) të realizuar gjatë zbatimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë analizën e ndikimit të programit në zonën e tij, me një diferencim të qëllimit gjeografik (shpërndarja harmonike/përqendrimi) dhe diferencim të zonave (rurale/urbane).

Shpjegoni sesi programi ka kontribuar ose do të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënies ndërkufitare, si dhe se si mund ta matim apo demonstrojmë atë.

Shpjegoni sesi strukturat operuese dhe strukturat e ndërmjetme të ngritura gjurmojnë këto elemente të përmirësimit që ndodhin gjatë zbatimit të programit, për shembull, për ngritjen dhe funskionalitetin e sistemit të mbledhjes së të dhënave (për qëllime statistikore dhe administrative).

Për analiza cilësore, strukturat e programit duhet të bëjnë përpjekje për të siguruar informacion mbi pikëpamjet, mendimet ose vëzhgimet e publikut. Këto të dhëna mblidhen kryesisht nga vlerësimet, vizitat studimore, intervistat, takimet, grupet e fokusuara, anketave etj. Në përfundim, shtjelloni se si çështjet e ndërlidhura (veçanërisht ato që janë të rëndësishme për politikën e kohezionit: mundësi të barabarta, zhvillim të qëndrueshëm dhe luftë kundër diskriminimit) zhvillohen gjatë hartimit të thirrjeve për propozime dhe zbatimit të kontratave të granteve.>

Informacione të hollësishme rreth ekzekutimit financiar të programit të bashkëpunimit ndërkufitar

– Informacion i detajuar mbi kontraktimin dhe nën menaxhimin e tërthortë, disbursimin e alokimeve vjetore për secilin prioritet tematik dhe tip grant kontrate, duke përfshirë dhe partnerët e projekteve (bashkëpërfituesit)

– Analiza e faktorëve të mëposhtëm:

- Statusi financiar

- Informacion mbi bashkëfinancimin

- Faktorët që kanë penguar dhe / ose vonuar zbatimin financiar

- Faktorët që kanë pasur ndikim pozitiv në zbatimin financiar

Tabelë model mbi ekzekutimin financiar të kontratave të BNK-së gjatë zbatimit të periudhës raportuese:

<Tabela nr. XX>

	Prioriteti tematik: **<..>**					
Numri i kontratës	**Emri, tipi dhe vendi i origjinës i koordinatorëve dhe partnerëve**	**Dita e fillimit/mbarimit**	**Vlera e parashikuar e kostove të lejuara dhe vlera e grantit të BE-së**	**Vlera e akumuluar e pagesave**	**Përqindja e pagesave të ekzekutuara[1]**	**Komente**

2.4 Informacion mbi hapat e ndërmarrë nga strukturat operuese dhe/ose Komiteti i Përbashkët Monitorues për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit:

2.4.1 Monitorimi dhe vlerësimi

[1] (Vlerë kumulative e pagesave/vlera e grantit të BE-së) x 100

<Masat monitoruese të ndërmarra nga struktura operuese ose nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit, duke përfshirë marrëveshjet e mbledhjes së të dhënave, rishikimet e raporteve të grant kontratave, gjetjet dhe zbatimin e rekomandimeve të vizitave monitoruese.

Në programet të cilat kanë menaxhim të tërthortë, përgatitja, ekzekutimi, gjetjet, rekomandimet dhe zbatimi i rekomandimeve të ndërmarra nga struktura operuese ku ndodhet Autoriteti kontraktues (neni 57 MK). Në programet e zbatuara nën menaxhim të tërthortë, rekomandimet dhe zbatimi i rekomandimeve të ndërmarra prej Komisionit.>

2.4.2 Problemet e hasura dhe veprimet korrigjuese

<Përmbledhje e problemeve të rëndësishme të hasura gjatë zbatimit të programit, si dhe i masave rregulluese të ndërmarra.

Rekomandimet për veprime (të tjera) rregulluese.>

2.5 Vizibiliteti dhe promovimi

<Masat e ndërmarra për të garantuar vizibilitetin dhe publicitetin e programit (plani i vizibilitetit, shihni nenin 78 të MK-së), duke përfshirë materiale promovuese, reklama në masmedia, shembuj nga praktikat më të mira që theksojnë aktivitetet më të rëndësishme të seminareve, konferencave, tryezave të përbashkëta, forume, ditës së Bashkëpunimit Evropian dhe panaireve të projekteve, mbajtjes së një baze të dhënash me aplikantët e ardhshëm, faqes së internetit të programit etj.>

2.6 Shfrytëzimi i Asistencës Teknike

<Sqarime të detajuara mbi përdorimin e fondeve të asistencës teknike dhe çdo problemi serioz të hasur gjatë zbatimit të buxhetit të AT-së. Si përfundim, një analizë e rezultateve dhe indikatorëve të ndikimit të kësaj kontrate të asistencës teknike duhet të prezantohet në të njëjtën mënyrë si seksioni 2.2.1 më lart.>

2.7 Ndryshimet në kuadër të zbatimit të programit ndërkufitar (nëse ka)

<Nëse është e zbatueshme, përshkrimi i çdo elementi, i cili edhe pse nuk rrjedh drejtpërdrejt nga asistenca e programit, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e tij (p.sh. ndryshimet legjislative, ndryshimet e rëndësishme në socio-ekonomi etj.). >

2.8 Sinergjia me politikat ose instrumentet e tjera të sektorit

<Një përmbledhje e koordinimit dhe koherencës aktuale të programit me shtetet e tjera anëtare të BE-së dhe me programet ose iniciativat kombëtare. Koordinim dhe koherenca e programit me politikat e Komunitetit. Komplementariteti me instrumentet e tjera financiare të asistencës ndërkombëtare.>

2.9 Histori suksesi

<Shpjegoni në lidhje me rezultatet e arritura me një ose mundësisht dy shembuj të grant kontratave, periudha e zbatimit të të cilave ka mbaruar gjatë periudhës raportuese dhe e cila mund të konsiderohet si histori suksesi:

Dimensioni real i BNK-së (ju lutem tregoni se cili përkufizim i BNK-së është përdorur për të vlerësuar projektpropozimet, siç tregohet në udhëzimet përkatëse për aplikuesit: a) "Zbatimi i përbashkët i aktiviteteve nga partnerët që rezultojnë në intensifikimin e lidhjeve ndërkufitare dhe partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare dhe heqjen e pengesave ndërkufitare për zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik "ose b) " zbatimin e përbashkët të aktiviteteve nga partnerët që rezultojnë në intensifikimin e lidhjeve ndërkufitare dhe partneriteteve të qëndrueshme ndërkufitare ose heqjen e pengesave ndërkufitare për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë socio-ekonomike).

Ndikimi real i BNK-së: fqinjësi më e mirë dhe përfitim për njerëzit nga të dyja anët në një mënyrë që një "projekt kombëtar" nuk do të kishte arritur.

Inovacioni: sipas fushës, partnerëve të përfshirë dhe aktiviteteve e metodave të zbatuara.

Efikasiteti: rezultatet e arritura në kohë dhe në përputhje me buxhetin e planifikuar.

Përhapja e duhur: vizibiliteti, replikueshmëria, shumëfishimi dhe efekti i shpërndarjes.

Perspektiva të mira të qëndrueshmërisë: përfitimet e mundshme pas kohëzgjatjes së projektit dhe partneritet afatgjatë. >

<Historitë mund të kenë strukturën e mëposhtme:
Fjali e gjetur që përmbledh suksesin e projektit
Titulli i projektit
Prioriteti tematik
Vendndodhja: Bashkitë sipas vendit
Tipi i partnerëve të projektit
Vlera e buxhetit (duke përshirë grantin e BE-së)
Problematikat
Objektivat e arritur (duke përfshirë deklaratat e partnerëve)
Rezultatet kryesore
Aktivitetet kryesore
Afatet kohore
Faqe interneti
Detajet e kontakteve të partnerëve BNK

SHTOJCA IV(a)
RAPORTI FINANCIAR VJETOR - BUXHETI TOTAL

Raporti Financiar i Përfituesit IPA II (*)

Referenca e Programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i Programit			Aktivitetet e kontratës lokale																								Kontributi i bllokuar				Rubrera Bankare (Kontributi I BE)			Parashikimi i disbursimeve (BE)	
					Shuma totale e kontraktuar			Kontraktuar %			Shuma totale e kthyer në përfituesin të Programit			Të kthyera %			Shuma totale e disbursuar			Disbursuar %			Kostot totale të njohura			Kostot %			Totali I Parafinancimit			Parafinancimi %			Gabi met	Pamjaftu eshme	Mash trime	Pa kone ksht	Të tulli	Totali i bashkë të ard %	Totali i paisë licuar I disbur simit euajt	Të mund t e i paisë licuar I disbur simit euajt	Të bashkë ta I progra mit
1	2	3			4			5			6			7			8			9			10			11			12			13			14	15	16	17	18	19	20	21	22
		3a	3b	3c	4a	4b	4c	5a	5b	5c	6a	6b	6c	7a	7b	7c	8a	8b	8c	9a	9b	9c	10a	10b	10c	11a	11b	11c	12a	12b	12c	13a	13b	13c									
								4a/3a *100%	4b/3b *100%	4c/3c *100%				6a/4a *100%	6b/4b *100%	6c/4c *100%				9a/4a *100%	9b/4b *100%	9c/4c *100%				11a/4a *100%	11b/4b *100%	11c/4c *100%				12a/4a *100%	12b/4b *100%	12c/4c *100%						10/3a *100%			21/3a *100%
		Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera	Kontributi BE	Kontributi Kombëtar	Burime të tjera									
NP2010	2010/123-456																																									
ENK AAJ BB 2010																																										

(*) 15 Shkurt

SHTOJCA IV(b)
RAPORTIMI VJETOR FINANCIAR – KONTRIBUTI I BE PËR PROGRAMIN

Raporti Financiar i vendit përfitues IPA II (*)

Referenca e Programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i kontributit të BE për Programin	Aktivitetet e kontratave lokale									
			Totali I shumës së kontraktuar	Kontraktimi në %	Shuma totale të fondeve të papërdorura në mbyllje	Fondet e papërdorura %	Totali I fondeve të disbursuara	Disbursimet %	Shuma e kostove të njohura	Kostot %	Shuma e parafinancimit	Parafinancimi %
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
				4/3*100%		6/4*100%		8/4*100%		10/4*100%		12/4*100%
NP2010	2010/123-456											
Nën- programi												
Projekti												

(*) 15 shkurt

SHTOJCA IV (c)
RAPORTI VJETOR I FINANCIMIT - KONTRIBUTI I THJESHTUAR I KONSOLIDUAR I BE-së

Raporti Financiar i vendit përfitues IPA II (*)

Referenca e Programit	Numri i kontratës së Marrëveshjes së Financimit	Buxheti i kontributit të BE-së për Programin	Aktivitetet e kontratave lokale					
			Totali i shumës së kontraktuar	Shuma totale të fondeve të papërdorura në mbyllje	Totali i fondeve të disbursuara	Shuma e kostove të njohura	Shuma e parafinancimit	Totali
1	2	3	4	5	6	7	8	9
NP2010	2010/123-456							

(*) 15 Janar

ANNEX IV (d)
PARASHIKIMI I PAGESAVE

Referenca e Programit	Parashikimi i disbursimeve të planifikuara (Shtoni vite sipas nevojës)																
	Parashikimi I disbursimeve mujore (12 muaj për parafinancimin/14 muaj për pagesat e mëvonshme)														**Totali Viti 1**	**Viti 2**	**Viti 3**
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14			
NP2010															0		
CBC AA/BB 2010															0		

SHTOJCA V E KËSAJ MARRËVESHJE FINANCIMI
SPECIFIKIME MINIMALE TË SISTEMIT TË KONTABILITETIT ME BAZË AKRUALE/SHTIMI

Sistemi i kontabilitetit të përfituesit të IPA II duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

1. Të reflektojë strukturën organizative të caktuar për sistemet e kontrollit të brendshëm të përshtatur për kryerjen e detyrave. Në mënyrë të veçantë, para se të autorizohet një veprim, duhet të verifikohen të gjitha aspektet (si operative dhe financiare) e veprimit nga anëtarët e tjerë të stafit, përveç atij që e ka nisur veprimin. Personi që merret me verifikimin nuk mund të jetë në varësi të atij që e ka nisur transaksionin.

2. Të përfshijë një gjurmë auditimi për të gjitha transaksionet dhe ndryshimet.

3. Të ketë siguri të mjaftueshme fizike dhe elektronike, duke përfshirë sistemet e rikuperimit dhe të ruajtjes së një kopje rezervë/mbështetjes.

4. Sistemi i kontabilitetit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm për kontratat lokale që menaxhohen nën secilin program:

a) Referencën e Kontratës;

b) Vlerën e kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

c) Datat e nënshkrimit të kontratës (nga të dyja palët);

d) Datën e fillimit të zbatimit të kontratës;

Kjo është përveç datës së nënshkrimit të kontratës dhe mund të jetë e ndryshme nga ajo, si në rastet kur data e fillimit të punimeve të kontratës jepet pas nënshkrimit të kontratës nëpërmjet një Urdhri Administrativ.

e) Datën e përfundimit të zbatimit të kontratës, duke përfshirë çdo ndryshim;

Kjo është data e fundit kur mund të këtë kosto të pranueshme. Kjo nuk përfshin asnjë periudhë garancie ose kohën e lejuar për përgatitjen e raportit nga kontraktuesi.

f) Totali i paguar (me lekë në dorë) nga kontrata;

g) Parafinancimi i paguar sipas kontratës;

Njohje e hollësishme dhe regjistrim në bilancin e kërkuar sipas kontratës së parafinancimit.

h) Kosto e njohur - e drejtpërdrejtë (sipas kontratës);

Njohje e hollësishme e kostos si një detyrim për shpenzimet e vitit. Disa pagesa do të mbulojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shpenzimet e kryera. Nuk përfshihet ndonjë parafinancim. Këto mund të jenë pagesa përfundimtare, kur parafinancimi është hequr tashmë ose pagesa të ndërmjetme kur parafinancimi është hequr ose kur kontrata nuk përfshin sigurimin e parafinancimit.

i) Kosto e njohur – e tërthortë (sipas kontratës);

Njohje e hollësishme e kostos si një detyrim për shpenzimet e vitit. Disa fatura apo detyrime kostoje, të paraqitura nga një përfitues i grantit ose kontraktues, do të lidhen me kostot që mbulohen nga parafinancimi i paguar më herët gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes ose kontratës së grantit. Në këto raste, pagesa e bërë do të jetë më e vogël sesa kostoja e raportuar. Ajo mund të jetë dhe zero, nëse e gjithë kostoja është e mbuluar me parafinancim (sigurisht do të jetë zero në qoftë se kostot e raportuara janë të pamjaftueshme për të thithur parafinancimin dhe lëshohet një urdhër rivlerësimi për bilancin e papërdorur të parafinancimit). Në të gjitha këto raste, sistemi gjatë përcaktimit të shumës për t'u paguar, duhet të regjistrojë vlerën e plotë të kostos së pranueshme të raportuar si shpenzime për vitin dhe të reduktojë nga bilanci i parafinancimit koston e kompensuar nga parafinancimi.

j) Kthimi i fondeve të papërdorura për të ulur parafinancimin (sipas kontratë);

Njohja e reduktimit të fondeve të parafinancimit në bilanc pas kthimit të një parafinancimi të papërdorur.

k) Kthimi i fondeve të papërdorura për të ulur koston (sipas kontratës);

Kur një kthim fondesh bëhet kundrejt një kostoje të pranuar më parë – ndoshta pas një hetimi për mashtrim. Në raste të tilla, shpenzimet e regjistruara për vitin duhet të reduktohen në qoftë se kostoja është pranuar në të njëjtin vit si rikuperimi pasues; ose të ardhurat duhet të regjistrohen kur kostoja është pranuar, në një vit para tij të kthimit të fondeve.

l. Data e faturës së furnizuesit për çdo faturë, ose dokument tjetër i shoqëruar nga një raport financiar që paraqet shpenzimet e njohura;

m) Informacion mbi kontekstin e kthimit të fondeve të kostove të papranueshme dhe kthimeve të fondeve.